

Instituti  
për  
politikë  
evropiane.  
Shkup

Raporte tematike të projektit  
„Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë (JUDGMENT)“

**PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT DHE KOMPETENCËS:  
PASQYRË E CILËSISË, EFIKASITETIT DHE KOMPETENCËS SË GJYQTARËVE DHE GJYKATAVE**

**BASHKËPUNIMI GJYQËSOR LIDHUR ME QASJEN E LIRË DERI TE INFORMACIONET,  
ZBATIMIN E EKZEKUTIMIT NDËRKUFITAR DHE PROCEDURËN NDËRKUFITARE TË FALIMENTIMIT,  
TRANSFERIMIT DHE BASHKIMIT**

**MBËSHTETJA E ZAK: PËRMIRËSIMI I KORNIZËS LIQJORE PËR ZGJIDHJEN ALTERNATIVE  
TË KONTESTEVE DHE MUNDËSIMI I BASHKËPUNIMIT JURIDIK E INSTITUCIONAL  
ME SISTEMIN GJYQËSOR DHE SISTEMIN E EKZEKUTIMIT**

---

Shkup, Dhjetor 2016

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Pikëpamjet e shprehura ktu në asnjë mënyrë nuk pasqyrojnë mendimin zyrtar të Këshillit për Bashkëpunimit Rajonal.

**Botues:**

Instituti për politik europiane (EPI) - Shkup

**Redaktorë:**

Dr. Malinka Ristevska Jordanova  
Ardita Abazi Imeri

**Redakcion profesional:**

Dr. Ljubica Karamandi

**Autorë:**

*PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT DHE KOMPETENCËS: PASQYRË E CILËSISË, EFIKASITETIT DHE KOMPETENCËS SË GJYQATARËVE DHE GJYKATAVE*

Aleksandra Bogdanovska  
Aleksandar Nikolov

*BASHKËPUNIMI GJYQËSOR LIDHUR ME QASJEN E LIRË DERI TE INFORMACIONET, ZBATIMIN E EKZEKUTIMIT NDËRKUFITAR DHE PROCEDURËN NDËRKUFITARE TË FALIMENTIMIT, TRANSFERIMIT DHE BASHKIMIT*

Verica Hadzivasileva Markovska  
Dejan Kostovski

*MBËSHTETJA E ZAK: PËRMIRËSIMI I KORNIZËS LIGJORE PËR ZGJIDHJEN ALTERNATIVE TË KONTESTEVE DHE MUNDËSIMI I BASHKËPUNIMIT JURIDIK E INSTITUCIONAL ME SISTEMIN GJYQËSOR DHE SISTEMIN E EKZEKUTIMIT*

Ilija Manasiev  
Ljupco Sotirovski  
Roza Aleksova

**Përkthimi:**

Poliglot Plus

**Përpunimi teknik:**

Vladimir Gjorgjevski

**Shtypjes:**

Printline

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

347.96/.98(497.7)"2016"(047)

RAPORTE tematike të projektit "Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë [JuDGMeNT]" / [autorë Aleksandra Bogdanovska ... и др.]

; redaktorë Malinka Ristevska Jordanova, Ardita Abazi Imeri]. -

Shkup : Instituti për politik europiane (EPI), 2017. - 62 стр. : табели ; 25 см

Фусноти кон текстот. - Автори: Aleksandra Bogdanovska, Aleksandar

Nikolov, Verica Hadzivasileva Markovska, Dejan Kostovski, Ilija


Manasiev, Ljupco Sotirovski, Roza Aleksova

ISBN 978-608-4702-28-3

1. Bogdanovska, Aleksandra [автор]

а) Судство - Реформи - Македонија - 2016 - Извештаи

COBISS.MK-ID 102620682



Instituti  
për  
politikë  
evropiane.  
Shkup

Raporti tematik i Projektit  
„Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë (JUDGMeNT)“

# PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT DHE KOMPETENCËS: PASQYRË E CILËSISË, EFIKASITETIT DHE KOMPETENCËS SË GJYQTARËVE DHE GJYKATAVE

---

Shkup, Dhjetor 2016

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Pikëpamjet e shprehura ktu në asnjë mënyrë nuk pasqyrojnë mendimin zyrtar të Këshillit për Bashkëpunimit Rajonal.

Përmbajtje:

- 03.** 1.Shënime hyrëse për Strategjinë e EJL 2020: Vendet e punës dhe perspektiva evropiane
- 04.** 2.Standardet evropiane dhe korniza juridike vendore
- 07.** 3.Praktika në Republikën e Maqedonisë
- 07.** 3.1 Cilësia
- 10.** 3.2 Efikasiteti
- 14.** 3.3 Kompetenca
- 15.** 4.Konkluzione
- 17.** 5.REKOMANDIME
- 19.** ANEKSI 1

# 1\* Shënime hyrëse për Strategjinë e EJL 2020: Vendet e punës dhe perspektiva evropiane

“Strategjia e Evropës Juglindore 2020: Vendet e punës dhe perspektiva evropiane” synon drejt përmirësimit të kushteve të jetës në rajon dhe fokusimin ndaj çështjeve të konkurrencës dhe zhvillimit. Strategjia u miratua në vitin 2013, ndërsa procesin e zhvillimit, miratimit dhe zbatimit të së njëjtës e koordinon Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (KRB). Pikërisht përforsimi i bashkëpunimit rajonal është njëri nga kushtet e progresit në procesin e anëtarësimit të shteteve të rajonit në Bashkimin Evropian.

Strategjia është përqendruar mbi katër shtylla të zhvillimit të ndërlidhura midis tyre, prej të cilave shtylla “Qeverisja për rritje” ka tre dimensione: Shërbime publike efektive, Parandalimi i korrupsionit dhe Drejtësi. Në fushën e Drejtësisë janë identifikuar tre prioritetet, në mesin e të cilëve edhe “Përmirësimi i efikasitetit dhe kompetencës: Pasqyrë e cilësisë, efikasitetit dhe kompetencës së gjyqtarëve dhe gjykatave.”

Strategjia e thekson nevojën për rritjen e impenjimeve nga ana e të gjitha institucioneve të përfshira (ministri, qendra gjyqësore trajnimi ose akademi, universitete), në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në drejtim të përmirësimit të këtyre parametrevë. Në rastin e Maqedonisë i adresohen: Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor, Këshillit Buxhetor Gjyqësor por edhe organeve siç është Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë të cilët janë faktorët më të rëndësishëm për sigurimin e cilësisë së gjyqësorit në përgjithësi, por edhe të cilësive individuale dhe kompetencës së gjyqtarëve.

Natyra ambicione e Strategjisë EJL 2020 mundëson përfshirjen e më shumë subjekteve në procesin e zbatimit të së njëjtës. Ajo shërbeu si bazë për sektorin civil që të ushtroj monitorim disamujor mbi punën e një pjese të institucioneve të involvuara dhe në vazhdimësi ta hulumtoj përmirësimin e cilësisë, efikasitetit dhe kompetencës së gjykatave. Raportet e përpiluara mujore, si dhe ky Raport tematik përmbajnë fakte të cilat ofrojnë një pasqyrë të qartë për gjendjen momentale dhe rekomandimet të cilat në të ardhmen do të duhej të respektohen dhe zbatohen.

Metodologjia e hartimit të Raportit tematik kryesisht mbështetet mbi analizën juridike dhe komparative të kornizës ligjore për jurisprudencën dhe mbi raportet relevante mujore dhe vjetore. Si plotësim të hulumtimit nga zyra, u siguruan të dhëna nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe nga Agjencia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Në kuadër të Projektit, u vendosën indikatorë sipas të cilëve mund të monitorohet zhvillimi në këtë fushë (Aneksi 1).

Në procesin e anëtarësimit, Bashkimi Evropian i përfshin çështjet që kanë të bëjnë me gjyqësorin në komponentët politikë të Kriteve të Kopenhagës, si dhe në Kapitullin 23 – Jurisprudenca dhe Të Drejtat Themelore. Krahas nenit 47 të Kartës së të Drejtave Fundamentale të BE, në të drejtën e BE nuk ekzistojnë dispozita të cilat i rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me statusin e gjyqësorit kombëtar. Ky është rezultat i parimit të respektimit të autonomisë kombëtare nga ana e Unionit në rregullimin e strukturës institucionale vendore.

Pavarësia e gjyqësorit në Maqedoni është rregulluar në nivelin më të lartë – me Kushtetutë. Në përputhje me nenin 8, ndarja e pushtetit shtetëror është specifikuar si njëra nga vlerat themeltare të rendit kushtetues, ndërsa neni 98 përcakton se pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat, të cilat janë të pavarura dhe të mëvetësishme. Neni 99 përcakton se gjyqtari nuk mund të transferohet kundër vullnetit të tij, ndërkaq bashkë me Amendamentin XXVI i rregullon kushtet e ndërprerjes së funksionit të gjyqtarit dhe shkarkimin.

Pavarësia e gjyqësorit në Maqedoni është rregulluar në nivelin më të lartë – me Kushtetutë. Në përputhje me nenin 8, ndarja e pushtetit shtetëror është specifikuar si njëra nga vlerat themeltare të rendit kushtetues, ndërsa neni 98 përcakton se pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat, të cilat janë të pavarura dhe të mëvetësishme. Neni 99 përcakton se gjyqtari nuk mund të transferohet kundër vullnetit të tij, ndërkaq bashkë me Amendamentin XXVI i rregullon kushtet e ndërprerjes së funksionit të gjyqtarit dhe shkarkimin.<sup>1</sup>

Zgjedhja dhe shkarkimi i gjyqtarëve, gjyqtarëve – porotë dhe kryetarëve të gjykatave është në kompetencë ekskluzive të Këshillit Gjyqësor dhe bazohen në kriterë objektive të parashikuara me Ligjin për gjykata. Është diskutabile që për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës vlejnjë kushtet e njëjta si edhe për zgjedhjen e gjyqtarit, me përjashtim të dispozitës se në dy vitet e fundit duhet të jetë vlerësuar me notë më të lartë pozitive dhe të ketë numër më të madh të pikëve në krahasim me personat e paraqitur të tjerë. Kushtet e përcaktuara në këtë mënyrë nuk krijojnë mundësi që të vlerësohen aftësitë menaxheriale të kandidatëve për kryetar të gjykatës – element kyç për kryerjen me sukses të këtij funksioni.

Sa u përket Standardeve Evropiane, që kanë të bëjnë me procedurën disiplinore, suspendimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve, në esencë është bërë harmonizimi i kornizës juridike vendore. Kushtetuta, Ligji

<sup>1</sup>Ligji për gjykata është bazë mbi të cilën ndërtohet pushteti gjyqësor dhe njëherësh i rregullon kompetencat e gjykatave, kompetencën organizative, territoriale dhe reale, llojet e gjykatave në Republikën e Maqedonisë, mënyrën e funksionimit, ushtrimit të funksionit gjyqësor, zgjedhjen e gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë, të drejtat dhe obligimet e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, si dhe ndërprerjen e funksionit, përgjegjësisë disiplinore dhe përgjegjësisë për shkak të ushtrimit joprofesional të funksionit të gjyqtarit. Ligji, në nivel bazik, e rregullon administratën gjyqësore, shërbimin gjyqësor dhe policinë gjyqësore, përkatësisht kompetencat e tyre kryesore në aspekt të ushtrimit të pushtetit gjyqësor.

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë e rregullon procedurën për zgjedhjen e Këshillit Gjyqësor, si dhe mënyrën e realizimit të funksioneve të tyre dhe mënyrën e punës dhe vendimarrjes. Pastaj, me Ligjin rregullohen edhe kompetencat e Këshillit Gjyqësor në mesin e të cilave të zgjedh dhe shkarkojë gjyqtarë dhe ta vlerësojë punën e tyre. Me Kushtetutën dhe Ligjin, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë përkufizohet si organ i pavarur dhe i mëvetësishëm i gjyqësorit, funksioni dhe qëllimi kryesor i të cilit është garantimi i pavarësisë dhe mëvetësisë së gjyqësorit. Mbledhjet e Këshillit, në të cilat shqyrtohen parashitjet dhe ankesat e qytetarëve dhe personave juridikë për punën e gjyqtarëve dhe gjykatave, janë publike.

Ligji për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë e rregullon themelimin, veprimtarinë, statusin dhe financimin e Akademisë. Pastaj, Ligji përmban dispozita për ligjëruesit dhe mentorët të cilët i realizojnë programet, trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm si veprimtari themelore të Akademisë, si dhe çështje të tjera të cilat kanë të bëjnë me pozitën dhe funksionimin e Akademisë. Akademia e bën pranimin dhe përsosjen profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm publikë, përsosjen e vazhdueshme profesionale dhe avancimin e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë tanimë të zgjedhur gjatë kryerjes së funksionit të tyre, si dhe përsosjen dhe trajnimin për kryerjen etike dhe profesionale të detyrave të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, në përputhje me ligjin dhe standardet e parimit ndërkombëtare.

Ligji për buxhetit gjyqësor e rregullon procedurën për përpilimin, përcaktimin dhe realizimin e buxhetit gjyqësor si dhe themelimin dhe punën e organit të veçantë në kuadër të gjyqësorit, Këshilli Buxhetor Gjyqësor, qëllimi i të cilit është të kujdeset për buxhetin gjyqësor, si pjesë e veçantë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe të sigurojë pavarësi financiare të gjykatave.

Ligji për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Hapjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarite rregullon themelimin e këtij organi dhe mënyrën e funksionimit dhe incimit të kërkesës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit.

Ligji për shërbimin gjyqësor i rregullon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësve gjyqësorë, sistemin e pagave dhe kompensimeve të pagave të nëpunësve gjyqësorë.

për gjykatat dhe Ligji për Këshillin Gjyqësor i përcaktojnë bazat e suspendimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve, me ç'rast përcaktohet se kjo mund të bëhet vetëm si pasojë e shkeljes më të rëndë disiplinore e cila e bën jo dinjitoz për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit dhe të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit.

Procedura e rregulluar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, i mundëson gjyqtarit i cili është objekt i procedurës disiplinore, të deklarohet lidhur me pretendimet kundër tij, si dhe të paraqes ankesë kundër vendimit.

Rregullimi përkatës i pjesës së përgjegjësive disiplinore të gjyqtarëve dhe përgjegjësive për ushtrimin joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit e imponuan nevojën për më shumë ndryshime ligjore. Njëra nga situatat kontestuese ishte kompetenca dhe cilësia e Këshillit Gjyqësor në gjithë procedurën, me ç'rast organi i njëjtë paraqitej edhe si organ i cili e ngre procedurën për përcaktimin e përgjegjësive të gjyqtarit edhe si organ i cili vendos për procedurën, me atë që anëtari sipas funksionit i Këshillit është Kryetari i Gjykatës Supreme dhe si organ i cili vendos sipas ankesës. Për tejkalimin e këtij problemi u miratua Ligji për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësive të Gjyqtarit.<sup>2</sup> Me këtë Ligj u parashikua të inkorporohet një organ i ri i cili do t'i hap procedurat e përcaktimit të fakteve, si dhe të ngre kërkesa për përcaktimin e përgjegjësive të gjyqtarit. Miratimi i Ligjit për Këshillin e Përcaktimit të Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësive të Gjyqtarit nuk rezultoi as si obligim dhe as si nevojë dhe shkas të parashikuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë si akti më i lartë juridik, dhe as nga ligjet e tjerë të cilët e rregullojnë këtë materie (Ligji për gjykatat, Ligji për Këshillin Gjyqësor).

Veçanërisht problematike ishte që ky Ligj u miratua me procedurë të shkurtuar, pa hulumtimet dhe analizat përkatëse. Për këtë shkak, janë të arsyeshme kritikimet se organi i konstituuar me këtë akt normativ nuk është kushtetues, veçanërisht nëse merret parasysh neni 99, si dhe Amendamenti XXVIII dhe Amendamenti XXIX i Kushtetutës, sipas të cilëve Këshilli Gjyqësor është organ unik, i pavarur dhe i mëvetësishëm i cili e siguron dhe garanton pavarësinë dhe mëvetësinë e pushtetit gjyqësor dhe njëherësh është organi i vetëm kompetent që të vendos për përgjegjësinë e gjyqtarëve. Për dallim nga Këshilli Gjyqësor, Këshilli për Përcaktimin e Fakteve nuk është parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.<sup>3</sup> Në qoftë se më problematike është mundësia e parashikuar që Këshilli për Përcaktimin e Fakteve ta hedhë poshtë iniciativën për ngritjen e procedurës, me çka edhe faktikisht përjashtohet Këshilli Gjyqësor nga vet procedura, ndërsa Këshilli për Përcaktimin e Fakteve imponohet si organ paralel i cili i ndan ose i posedon kompetencat e ngjashme me ato të Këshillit Gjyqësor.<sup>4</sup>

Kontestues është neni 6 i Ligjit për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësive të Gjyqtarit sipas së cilit si anëtarë të Këshillit zgjidhen gjyqtarë të pensionuar, prokurorë publikë, profesorë universitarë dhe juristë, meqë dispozita e këtillë nuk është në drejtim të përcaktimit të kriterëve cilësorë për zgjedhjen, dhe së këtejmi jo vetëm që paraqitet si e panevojshme, por është edhe bazë për diskriminim në bazë të moshës. Anëtarët e Këshillit për Përcaktimin e Fakteve i zgjedhin gjyqtarët e të gjitha gjykatave në Maqedoni në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe të fshehta.<sup>5</sup> Dispozitat përfundimtare të këtij Ligji, më saktësisht neni 52 parashikon se zgjedhjen e parë të anëtarëve të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve do ta bëjë Komisioni i formuar nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë. Dispozita e këtillë është në kundërshtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor si dhe me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, meqë Ligji për Këshillin për Përcaktimin e

<sup>2</sup>Ibid.

<sup>3</sup><http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspk>

<sup>4</sup>Neni 40 i Ligjit për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Hapjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësive të Gjykatës, "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 20/15

<sup>5</sup>Neni 16 ibid

Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit ia imponon Këshillit Gjyqësor kompetencën jashtë kompetencave të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, aq më shumë se zgjedhjen e bën Komisioni i formuar nga Këshilli Gjyqësor.

Vet procedura e përcaktimit të përgjegjësisë së gjyqtarit, parashikimi i përgjegjësisë disiplinore dhe të përgjegjësisë për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit janë mjaft konfuzë dhe të shpërndarë në tre ligje të ndryshëm (Ligji për Këshillin Gjyqësor, Ligji për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit dhe Ligji për gjykata). Vërejtjet e këtilla, mes tjerash, janë specifikuar edhe në Raportin e Komisionit të Venecias ku konstatohet se bazat e përgjegjësisë së gjyqtarëve janë konfuzë dhe të relativizuara, ndërsa procedura është komplikuar pa nevojë dhe lë hapësirë për mbivendosjen e procedurave.<sup>6</sup>

Ekziston edhe pasaktësi në Ligjin për Këshillin Gjyqësor në lidhje me përcaktimin se çka nënkuptohet me ushtrim joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit. Me fjalë të tjera, nëse pandërgjegjshmëria mund të ndërlidhet me lëshime lidhur me çështjet procesuale gjatë veprimit, ose me shkelje të vetëdijshme të dispozitave ligjore dhe realizim të dobisë së paligjshme, mospërcaktimi i ushtrimit joprofesional të funksionit mund të jetë edhe bazë për interpretimin e gjerë të këtij nocioni, si dhe për presione mbi gjyqtarët. Nga ana tjetër, do të ishte më e logjikshme nëse ligji përcakton procedurë të vetme për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore, ndërsa me të njëjtën të përfshihen edhe rastet e ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit, me gradacion përkatës të sanksioneve të parashikuara.

Si problem ekzistues në legjisllacionin e Maqedonisë paraqitet miratimi i ligjeve me procedurë të shkurtuar,<sup>7</sup> kështu që, edhe Ligji për Akademinë, me ndryshimet dhe plotësimet e tij, u miratua pa debat adekuat profesional, debat publik ose me përfshirje tjetër të ekspertëve ose të grupeve të interesuara gjatë miratimit të tij. Pikërisht për shkak të praktikës së këtillë paraqiten edhe kritika të tjera që kanë të bëjnë me Ligjin, siç është kriteri për regjistrim në Akademi, me ç'rast ligjvënësi i jep rëndësi të madhe mesatares së fakultetit të kandidatëve, me çka vendoset kriteri, ndërkaq njohuria e kandidatit për atë se kur e ka kryer fakultetin vlerësohet më shumë ose njësoj si edhe njohuritë e tij të cilat i ka fituar pas kryerjes së fakultetit, ndërsa gjatë punës së tij. Në drejtim të mospasjes nevojë të një dispozite të këtillë janë edhe ndryshimet ligjore nga data 31.12.2015, me ç'rast u ndryshuan kushtet e pranimit, përkatësisht ishte parashikuar mesatarja e notës së studimeve prej më së paku 7, stazhi i punës prej më së paku 5 vjet në punë juridike pas provimit të dhënë të jurisprudencës në gjykatë ose në prokurori publike si punonjës gjyqësor ose si punonjës i Prokurorisë Publike ose avokat, dhe njëkohësisht është parashikuar që trajnimi të zhvillohet në një fazë, përkatësisht trajnim teorik nëntëmujor.<sup>8</sup> Ky ndryshim, gjithashtu parashikon se përvojën, të cilën duhet ta posedoj kandidati duhet ta ketë fituar si nëpunës gjyqësor, si nëpunës i Prokurorisë Publike ose si avokat e që nënkupton edhe një kusht kufizues. Përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor sugjerojnë se dispozita e këtillë është me qëllim që të sigurohet që kandidatët të kenë përvojë të drejtpërdrejt nga puna në gjykatë. Megjithatë, si moment më diskutabil janë ndryshimet e sërishme në procedurë të shkurtuar dhe kufizimi i tyre kohor të ndryshimeve paraprahe prej një viti, e që shkon në favor të jotransparencës së motiveve për shkak të të cilave bëhen ndryshimet e këtilla dhe lë dyshime për veprime arbitrare dhe korruptive.<sup>9</sup>

<sup>6</sup>[http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2015\)042-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2015)042-e)

<sup>7</sup><http://vistinomer.mk/sobraniski-trend-nad-60-otsto-od-zakonite-po-skratena-postapka-1/>

<sup>8</sup>Ibid.

<sup>9</sup>Neni 4 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 231/15



Në vitin 2011, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë e prezantoi Metodologjinë statistikore gjyqësore si instrument metodologjik për grumbullimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave statistikore. Metodologjia u zhvillua në bazë të udhëzuesve të statistikave gjyqësore (GOJUST) të Komisionit Evropian për efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), në kuadër të Këshillit të Evropës. Zbatimi i saj duhet të sigurojë të dhëna konsistente dhe komparative statistikore dhe indikatorë për monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të gjykatave. Metodologjia specifikon 11 indikatorë për analizën dhe monitorimin e të arriturave gjyqësore, të cilat gjykatat e kanë për detyrë t'i grumbullojnë, përpunojnë dhe publikojnë, megjithatë një gjë e këtillë nuk ndodhë. Në mënyrë plotësuese, Metodologjia parashikon se institucionet shkencore dhe hulumtuese mund të kenë qasje të drejtpërdrejtë deri te të dhënat dhe analizat e përpunuara statistikore, e që gjithashtu akoma nuk është implementuar. Këta dy faktorë e bëjnë mjaftë të vështirë monitorimin e pavarur të indikatorëve gjyqësorë në Maqedoni. Megjithatë, në vazhdim janë bërë përpjekje që të krijohet një pasqyrë e gjendjes lidhur me cilësinë, efikasitetin dhe kompetencën në bazë të të dhënave deri te të cilat pati sukses të arrijë ekipi hulumtues.

## 3.1\* Cilësia

Sipas të ashtuquajturit Raporti i Rajnhard Pribe,<sup>10</sup> anëtarët e Këshillit Gjyqësor doemos duhet të zgjidhen ekskluzivisht nga radhët e gjyqtarëve më profesionistë dhe nga juristët më të shquar dhe më me përvojë në vend, ndërsa në praktikë duhet të zhvillohet testim i qartë dhe i parashikueshëm në lidhje me domethënien e nocionit ligjor “jurist i shquar”. Rekomandimet e këtilla kanë të bëjnë me zbulimet e proceseve të pazarllëqeve politike lidhur me përbërjen e Këshillit. Disa, si dispozitë kontestuese të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, e theksojnë nenin 6 sipas së cilit si anëtar për nga funksioni të Këshillit janë Kryetari i Gjykatës Sperme dhe Ministri i Drejtësisë.<sup>11</sup> Imponimi ligjor i anëtarëve sipas funksionit në një organ, i cili duhet të jetë garant për pavarësinë e gjyqësorit, vetvetiu lë hapësirë për dyshime sa i përket pavarësisë së këtij institucioni. Pastaj, edhe pse Ministri i Drejtësisë si anëtar për nga funksioni nuk ka të drejtë vote në Këshill, vet prezenca e tij dhe ndikimin joformal të cilin e posedon mund të jetë pengesë në funksionimin dhe vendimmarrjen e lirë të Këshillit Gjyqësor.

Sa u përket kritereve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe zbatimit të tyre në praktikë, mund të vërehet tendenca e cila prevalon edhe në ligjet e tjerë të cilët i rregullojnë kriteret e zgjedhjes së anëtarëve në organ të pushtetit gjyqësor – përdorimi i nocionit “jurist i shquar”.<sup>12</sup> Deri në ndryshimet ligjore, në shkurt të vitit 2015, nuk kishte dispozitë e cila e përcaktonte nocionin “jurist i shquar”, dhe as ndonjë akt tjetër normativ me të cilin rregullohen këto kritere, kështu që domethënia e këtij nocioni interpretohej lirshëm nga ana e organit i cili e bën zgjedhjen, me çka në praktikë hasnim mendime të ndryshme për atë se çka do të thotë ky nocion. Neni 2 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor<sup>13</sup> pjesërisht e ripërcaktoi kriterin e këtillë me çka kushtet imponojnë që për anëtar të Këshillit të mund të paraqitet personi jurist i diplomuar me më së paku 15 vjet përvojë pune në profesionin juridik pas provimit të dhënë të jurisprudencës, i cili gjatë ushtrimit të profesionit juridik është shquar me punë shkencore dhe profesionale ose me veprimin e tij publik.<sup>14</sup>

<sup>10</sup> Rekomandime të Grupit të Ekspertëve me Përvojë për çështje sistemore për Sundimin e së drejtës lidhur me monitorimin e komunikimeve të publikuara në pranverën e vitit 2015.

<sup>11</sup> Ibid.

<sup>12</sup> Neni 26, ibid.

<sup>13</sup> “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 20/2015.

<sup>14</sup> Me datë 13.10.2016 në bazë të formulimit të këtillë, Kuvendi miratoi vendim me të cilin Vllade Bogojevski është zgjedhur për anëtar të Këshillit. Sipas biografisë së tij,

Pastaj, në publikun maqedonas u imponua pyetja se sa Këshilli Gjyqësor është i lirë nga influenza politike e pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës gjatë zgjedhjes së kuadrove dhe realizimit të kompetencave të besuara dhe në ç'masë është besimi i qytetarëve ndaj këtij organi. Raporti i Pribe apostrofon se Këshilli Gjyqësor duhet t'i kryej detyrat e veta pa kurrfarë ndikimesh të drejtpërdrejta ose të tërthorta dhe të jetë proaktiv në mbrojtje të gjyqtarëve kundërt ndërhyrjes dhe sulmeve të cilat e prekin pavarësinë e tyre. Pasi që në tetor të vitit 2016 Prokuroria Speciale Publike thërriti pesë gjyqtarë nga Gjykata Administrative, në cilësinë e personave të pandehur në lidhje me vendime të miratuara gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, Këshilli Gjyqësor reagoi se e njëjta bën presion të drejtpërdrejt dhe e rrënon pavarësinë e gjyqësorit, në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe të drejtat ndërkombëtare. Këshilli Gjyqësor, si organ i pavarur, e shprehu mendimin e tij se Prokuroria Speciale Publike ndërhyr në punët e gjyqtarëve dhe e cenon autoritetin dhe dinjitetin e gjyqtarëve, dhe së këtejmi u manifestua gatishmëria për luftë pa kompromis kundër atyre të cilët ndërhyjnë në punët e gjykatave. Sipas kësaj, u hap çështja e dëgjimit të gjyqtarit, përkatësisht Kryetari i Këshillit Gjyqësor theksoi se gjyqtari nuk mund të ndiqet për punën e tij të gjyqtarit dhe njëherësh mori qëndrim se askush nuk ka të drejtë ta marr guximin të thërrasë në seancë dëgjimore gjyqtarin për aktgjykimin e tij duke e pasur parasysh nenin 65 të Ligjit për gjykata.<sup>15</sup>

Prokuroria Speciale Publike deklarimet e këtilla i interpretoi si ndikim për zvarritjen e procedurave të caktuara parahetimore të cilat çojnë deri në pengimin e hetimit dhe në pamundësimin e ngritjes së procedurave gjyqësore kundër personave për të cilët ka dyshime se kanë kryer vepra të rënda penale. Megjithatë, nga ana tjetër, thuaja se mungojnë rastet kur gjyqtarët i janë drejtuar Këshillit Gjyqësor që Këshilli t'u ofroj mbrojtje nga presionet dhe ndikimet. Kjo e vë në dukje faktin se janë të rralla rastet e presioneve dhe ndikimeve ose të faktit se gjyqtarët nuk e shohin Këshillin si institucion i cili mund t'ju sigurojë mbrojtje efektive.

Edhe pse Ligji për gjykata përcakton kritere objektive për zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve, gjyqtarëve – porotë dhe kryetarëve të gjykatave, e që duhet të siguroj kompetencë, cilësi, pavarësi dhe paanshmëri përkatëse gjatë punës, Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë në vitin 2016 konstatoi se sistemi i zgjedhjes dhe avancimit akoma është pamjaftueshëm transparent dhe se nuk janë ndërmarrë hapa në mënyrë që të sigurohet depolitizimi në përputhje me “Prioritetet Urgjente të Reformave”. Në vitin 2015 Këshilli Gjyqësor zgjodhi 20 kryetarë të gjykatave, me zvarritje të konsiderueshme kohore, ndërsa në muajin shtator të vitit 2016 u zgjodhën 7 gjyqtarë në gjykatat themelore (të gjithë nga Akademia), 11 gjyqtarë në gjykatat e apelit, 2 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë Administrative dhe 5 gjyqtarë në Gjykatën Supreme (të gjithë me përvojë gjyqësore).<sup>16</sup>

Me rëndësi të veçantë është të theksohet se aktet normative aktuale lënë mundësi të hapur që gjyqtari të sanksionohet në bazë të numrit të vendimeve të cilat janë ndryshuar nga ana e gjykatës më të lartë, e që e nënkupton cenimin e imunitetit gjyqësor i cili garanton se gjyqtari nuk mund të thirret në përgjegjësi për shkak të mendimit të tij gjatë vendimmarrjes. Dispozita e këtillë pasqyron edhe një këndvështrim problematik të ligjvënësit dhe propozuesit të ligjeve, sipas së cilit gjykatat më të larta duhet vetëm ti konfirmojnë vendimet e gjykatave më të ulëta.

Në Raportin për Maqedoninë nga viti 2016, Komisioni Evropian nënvizon se sistemi i ri profesional për vlerësim me fokus mbi vlerësimin e kompetencave themelore të gjyqtarëve akoma nuk është inkorporuar, me çka sistemi akoma është i fokusuar mbi kriteret kuantitative, dhe sipas kësaj, në këtë fushë, nuk është

<sup>15</sup>Neni 65 i Ligjit për gjykata parashikon:

(1) Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit gëzojnë imunitet.

(2) Gjyqtari nuk mund të thirret në përgjegjësi penale për mendimin e shprehur dhe vendimmarrjen gjatë miratimit të vendimit.

(3) Gjyqtari nuk mund të paraburgoset pa aprovimin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, përveç nëse është hasur në kryerjen e veprës penale për të cilën përcaktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej më së paku pesë vjet.

(4) Për heqjen e imunitetit të gjyqtarëve vendos Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë.

Procedura për vendosjen e heqjes së imunitetit të gjyqtarit është urgjente.

<sup>16</sup>Raporti për Maqedoninë i Komisionit Evropian, 2016.

vepruar sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe Komisionit të Venecias. Madje edhe ato kritere, të cilat janë përcaktuar përcaktuar si kualitative, bazohen mbi statistikë pa e imponuar të merren parasysh dallimet të cilat paraqiten nga një rast gjyqësor në një rast tjetër gjyqësor.<sup>17</sup> Sipas përfaqësuesve të Këshillit Gjyqësor, gjatë vlerësimit të gjyqtarëve megjithatë, mbahet llogari që të merren parasysh dallimet e këtilla, përfshirë këtu edhe shkaqet e shfuqizimit, përkatësisht modifikimit të vendimeve nga ana e instancave më të larta gjyqësore. Deri diku në këtë drejtim ndihmon edhe dispozita e Ligjit për gjykata<sup>18</sup> sipas së cilës gjatë vlerësimit të gjyqtarit, Komisioni, i përbërë nga Kryetari i gjykatës në të cilën gjyqtari që vlerësohet e ushtron funksionin e gjyqtarit dhe dy gjyqtarë të tjerë, jep mendim. Ekziston praktikë që edhe gjyqtari i cili vlerësohet të parashtrojë komente ndaj mendimit të këtillë.

---

<sup>17</sup>Neni 98 - neni 115 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e RM" numër 60/2006, 150/10, 100/11, 20/15 dhe 61/15.

<sup>18</sup>Neni 126

## 3.2\* Efikasiteti

KMe konstantimin se në muajin nëntor të vitit 2015 Këshilli Gjyqësor miratoi vendim për reduktimin e numrit të gjyqtarëve nga 740 në 636 pa i vlerësuar nevojat dhe ndikimin, Komisioni Evropian, në Raportin e fundit për Progresin, vlerëson se mungon një strategji gjithëpërfshirëse për menaxhimin me resurset njerëzore në gjyqësor. Në fillim të vitit 2016 në pushtetin gjyqësor ka pasur përafërsisht 2500 nëpunës administrativë dhe gjyqësorë, e që është rritje për 5% në krahasim me fundin e vitit 2014.<sup>19</sup> Edhe krahas rritjes së këtyllë, Këshilli Gjyqësor vlerëson se ka mungesë të kuadrit udhëheqës, profesionistë dhe administrativ-technik.<sup>20</sup> Tek vendet e ish-Jugosllavisë, përfshirë këtu edhe Maqedoninë, numri i gjyqtarëve dhe i personelit gjyqësor për 100 000 qytetarë është në masë të konsiderueshme më të lartë nga mesatarja evropiane.<sup>21</sup> Sa i përket strukturës gjinore, në instancë të parë dhe të dytë, në përqindje më shumë janë të përfaqësuar femrat gjyqtare, ndërsa në Gjykatën Supreme dhe në mesin e kryetarëve të gjykatave më shumë janë të përfaqësuar meshkujt.<sup>22</sup> Dy të tretën e administratës gjyqësore e përbëjnë femrat.<sup>23</sup>

Komisioni shpreh shqetësime për atë se buxheti i gjykatave për vitin 2016 në masë të konsiderueshme është më i ulët nga mesatarja evropiane për kokë banori.<sup>24</sup> Me fjalë të tjera, buxheti për vitin 2016 për të gjitha gjykatat, me përjashtim të Gjykatës Kushtetuese, është rritur në masë të papërfillshme në krahasim me planin buxhetor për vitin 2015 dhe është në lartësi prej rreth 30 milionë euro.<sup>25</sup> Kjo i bie përafërsisht 15 euro për kokë banori, ndërsa mesatarja evropiane është rreth 36 euro.<sup>26</sup> Maqedonia ka shpenzime për gjykatat për kokë banori të cilat janë më të ulëta nga çdo vend – anëtar i BE, ndërsa në Ballkanin Perëndimor vetëm Shqipëria ka shpenzime më të ulëta për kokë banori.<sup>27</sup> Nga ana tjetër, sipas pjesëmarrjes së shpenzimeve publike për gjykatat në bruto prodhimin vendor, Maqedonia është në mesin e gjashtë vendeve të para në Evropë, ndërsa këto janë ish-republikat Jugosllave.<sup>28</sup> Buxheti i Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë për vitin 2016 është përafërsisht 670 000 euro<sup>29</sup> – e që është rritje për 15% në krahasim me buxhetin e planifikuar të Akademisë për vitin 2015. Megjithatë, mbetet përshtypja se bëhet fjalë për shumë të vogël në krahasim me nevojat e trajnimit. Konfirmim për këtë është numri i madh i seminareve dhe trajnimeve të cilët realizohen me ndihmën e donatorëve të huaj.

Krahas faktit që nga aspekti formal funksionon Këshilli Buxhetor Gjyqësor, në praktikë i njëjti është i detyruar t'i pranoj kufizimet e imponuara nga Ministria e Financave, të cilat nuk i respektojnë shumat e përcaktuara ligjore të dedikuara për shpenzime publike në sistemin gjyqësor. Këshilli Buxhetor Gjyqësor në të kaluarën ka bërë përpjekje ta përcaktojë çmimin e kostos së lëndëve në bazë të të cilës mund të bëhet projeksioni vjetor i nevojave buxhetore dhe vëllimi i planifikuar i punës së gjyqësorit, megjithatë në zbatim praktik i këtij koncepti është ballafaquar me pengesë për shkak të nivelit të ndryshëm të ekipimit kadrovik të gjykatave të veçanta dhe mbingarkimit me lëndë.

Gjykatat maqedonase në vitin 2015 kanë zgjidhur 2% më shumë lëndë në krahasim me prurjet e lëndëve të reja brenda atij viti dhe me këtë e kanë zvogëluar numrin e lëndëve të pazgjidhura.<sup>30</sup> Përjashtim nga tendenca e këtyllë është Gjykata e Lartë Administrative, gjykatat e apelit dhe Gjykata Supreme tek të cilat brenda vitit është rritur numri i lëndëve të pazgjidhura. Vetëm tek gjykatat themelore është zvogëluar numri i ditëve të nevojshme për zgjidhjen e lëndëve të pazgjidhura, mirëpo për shkak të numrit të madh të

<sup>19</sup> Raporti për punën e Këshillit Gjyqësor për vitin 2015

<sup>20</sup> Ibid.

<sup>21</sup> Ibid.

<sup>22</sup> Të dhëna për vitin 2014; European judicial systems: Efficiency and quality of justice, CEPEJ, 2016.

<sup>23</sup> Raporti për punën e Këshillit Gjyqësor për vitin 2015.

<sup>24</sup> Raporti për Maqedoninë i Komisionit Evropian, 2016

<sup>25</sup> Ndryshimi dhe plotësimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016.

<sup>26</sup> Të dhëna për vitin 2014; European judicial systems: Efficiency and quality of justice, CEPEJ, 2016.

<sup>27</sup> Increasing the efficiency of Macedonia's and Montenegro's justice system: Introducing an innovative EU monitoring and evaluation mechanism in the sphere of administrative law, Association Zenith, 2014.

<sup>28</sup> Të dhëna për vitin 2014; European judicial systems: Efficiency and quality of justice, CEPEJ, 2016.

<sup>29</sup> Ndryshimi dhe plotësimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016.

lëndëve tek gjykatat themelore, kjo ka rezultuar me zvogëlimin e kohës për zgjidhjen në përgjithësi të lëndëve të gjyqësorit.

Pritet përkeqësimi i indikatorëve të efikasitetit në vitin 2016 për shkak të grevës së administratës gjyqësore, e që e vuri në pikëpyetje funksionimin e gjykatave. Mundësia që greva të pengohet nuk u përjashtua, nëse palët e prekura pajtoheshin që të arrijnë marrëveshje.<sup>31</sup> Për shkak të pakënaqësisë nga Ligji për shërbimin gjyqësor, administrata gjyqësore u hodh në grevë plotë 58 ditë, nga muaji maj deri në shtator të vitit 2016, përmes bllokimit të punës së gjykatave. Revolta tek administrata gjyqësore u intensifikua pas vendimit për rritjen e pagave të gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve të prokurorive publike. Gjatë kohës së grevës një pjesë e gjykatave punonin me kapacitete minimale, u ndërmorën vetëm procedurat në të cilat është përcaktuar masa kohore dhe procedurat me element të huaj, ndërsa për shkak të mospasjes së kushteve, si dhe për shkak të intensitetit të grevës, padi dhe ankesa thuaja se asnjëherë nuk u pranuan. Në përputhje me Ligjin, sindikata mori qëndrim se në afatin e parashikuar nga 15 korriku i vitit 2016 greva do të pezullohet, ndërsa nëse nuk arrijnë marrëveshje do të vazhdohet me intensitet të rritur. Marrëveshje nuk u arrit, u bënë vetëm disa përpjekje që greva të vazhdojë, megjithatë e njëjta për një kohë të shkurtër u ndërpre plotësisht pa u plotësuar kërkesa për pagesë, siç është parashikuar me gjyqtarët, prokurorët publikë dhe nëpunësit në prokuroritë publike. Ndodhitë, në atë periudhë, mes tjerash, vënë në dukje se në vend të negociatave mbi nëpunësit gjyqësor janë bërë presione nga ana e Këshillit Buxhetor Gjyqësor dhe nga Kryetari i Këshillit Gjyqësor,<sup>32</sup> e që është e palejueshme për Këshillin Gjyqësor si organ i pavarur dhe i mëvetësishëm i gjyqësorit dhe e vë në dukje jotransparencën gjatë punës së të njëjtit.

Koalicioni “Të Gjithë për Gjykim të Drejtë” në shtator të vitit 2016 monitoroi 14 lëndë. Edhe pse bëhet fjalë për një numër të pakonsiderueshëm të seancave të monitoruara gjyqësore në vitin 2015, statistikat tregojnë se nuk ka dallim të madh midis vitit 2015 dhe 2016 në lidhje me shtyrjen e seancave gjyqësore – dallime ka vetëm sa u përket aktgjykimeve të miratuara. Një numër i madh i aktgjykimeve dhe aktvendimeve për miratimin e propozimit në vitin 2016 janë aprovuar jashtë seancës gjyqësore, e që është një indikator dhe lë përshtypje se edhe krahas numrit të vogël të seancave të zhvilluara gjyqësore, seancat e tjera nuk zhvillohen dhe më së shpeshti menjëherë miratohet aktvendim për aprovimin e propozimit meqë gjykata nuk ka kapacitete të ballafaqohet me të njëjtat.

Gjatë muajit shtator të vitit 2015 gjithsej u monitoruan 40 seanca në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup, prej të cilave u shtynë 28, edhe në këtë rast motivi më i shpeshtë është mungesa e njëjës nga palët. Në shtator të vitit 2016, u monitoruan vetëm dy seanca më pak nga muaji i njëjtë në vitin 2015, përkatësisht 38 seanca, nga të cilat 19 u shtynë. Shkaku më i shpeshtë për shtyrjen e seancave është mungesa e njëjës nga palët ose mospasja e qasjes në organet e ndjekjes, si dhe mospasja e kushteve që

<sup>30</sup> Përloqaritet mbi bazë të raporteve vjetore të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2014 dhe vitin 2015

Gjykatat	Shkalla e zgjidhjes së lëndëve në vitin 2015 <sup>30</sup>	Lëndë të pazgjidhura në fund të vitit 2015	Koha e zgjidhjes së lëndëve të pazgjidhura (ditë) <sup>30</sup>	
			2014	2015
			Gjykata Supreme	98%
Gjykata e Lartë Administrative	81%	1 095	8	88
Gjykata Administrative	106%	9 872	193	219
Gjykatat e apelit	95%	9 404	66	88
Gjykatat themelore	103%	109 700	97	84
<b>GJITHSEJ</b>	<b>102%</b>	<b>131 873</b>	<b>98</b>	<b>89</b>

<sup>31</sup> Analiza e të dhënave nga procedurat e monitoruara gjyqësore në vitin 2015, Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë”.

<sup>32</sup> Këshilli Buxhetor Gjyqësor vendosi që paga e nëpunësve gjyqësor për muajin maj të vitit 2016 të paguhet e plotë, ndërsa mbajtja e pagës, në përputhje me nenin 77 të Ligjit për shërbim gjyqësor të realizohet me pagesën e pagës për muajin qershor të vitit 2016. Sipas sekretarit të përgjithshëm të sindikatës së punëtorëve të administratës, organet e jurisprudencës dhe shoqatat e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, kjo ishte vetëm një përpjekje për ta thyer grevën e administratës gjyqësore dhe për ta hequr vëmendjen e problemeve të nëpunësve gjyqësorë. Këshilli Buxhetor Gjyqësor (KBGJ) deri të punësuarit në gjykata dërgoi njoftim në të cilin thotë se në mënyrë kolektive do t'u ulen pagat për 40% për ata muaj në të cilët administrata gjyqësore ka qenë në grevë. Ky vendim i KBGJ vjen disa ditë pas aktvendimit të parë në të cilin u kërkua nga kryetarët e gjykatave të përpilojnë aktvendime me paga më të ulëta për 60% për të punësuarit të cilët dy muaj ishin në grevë duke kërkuar paga më të larta.

personat e paraburgosur të shoqërohen deri në gjykatë. Kjo e vë në dukje faktin se një pjesë e madhe e angazhimit i cili rezulton me aktgjykim të drejtë është pikërisht i njerëzve të cilët janë grupuar në kategorinë e përgjithshme “shërbimi gjyqësor”, i përfshirë me Ligjin në fjalë, i cili është diskutabil dhe i papranueshëm për shërbimin gjyqësor.

Gjyqtarët dhe ekspertët e tjerë juridikë janë dakord se vazhdon praktika që të miratohen vendime të ndryshme për situata të njëjta juridike, ndërsa vendimet gjyqësore shpeshherë kanë arsye të jopërkatese. Është me rëndësi të theksohet dhe veçanërisht shqetëson puna e Gjykatës Administrative e cila nuk vendos në mënyrë meritore kundër aktvendimeve të organeve shtetërore dhe refuzon të miratojë vendime përfundimtare, përmes së cilave do të mbrohen të drejtat e qytetarëve. Në këtë mënyrë lëndët kthehen mbrapshtë para organeve shtetërore të cilat miratojnë vendime të njëjta, duke mos i respektuar qëndrimet e Gjykatës Administrative, me ç'rast cenohet e drejta e gjykimit në afat të arsyeshëm. E drejta e gjykimit në afat të arsyeshëm cenohet edhe nga gjykatat themelore edhe nga gjykatat e apelit, veçanërisht përmes zvarritjes së publikimit të aktgjykimeve. Është avancuar sistemi elektronik për kërkimin e vendimeve gjyqësore. Nuk respektohet afati për përpilim prej 15 ditësh, llogaritur nga përfundimi i seancës kryesore, ndërsa është vërejtur edhe rasti i tejkalimit të afatit prej 60 ditësh për lëndë më komplekse. Është e nevojshme, madje edhe e domosdoshme, organet administrative t'i zbatojnë vendimet gjyqësore në afat të arsyeshëm. Me qëllim të arritjes së efektit të plotë nga vendimet, ata duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme të parashikuara me ligj dhe njëkohësisht duhet të shqyrtohen të gjitha politikat rregullatore dhe opsionet që i kanë në dispozicion për zgjedhjen e zgjidhjes përkatëse lidhur me çështjet kyç, siç është aksesit dhe internetit, dhe e marrin parasysh kontekstin nacional, si për shembull nivelin e besueshmërisë së publikut dhe masat e nevojshme që të arrihet harmonizimi me standardet e BE.

Sa i përket Ligjit të ri për procedurë penale,<sup>33</sup> danalizat e deritanishme flasin se i njëjti nuk zbatohet plotësisht. Në përputhje me zgjidhjet e Ligjit për procedurë penale e drejtë themelore dhe detyrim i Prokurorit Publik është t'i ndjekë kryerësit e veprave penale, për të cilët ndjekja ndërmerret sipas detyrës zyrtare, megjithatë Prokurori Publik shpeshherë vihet në rolin e palës dhe të gjyqtarit, kështu që një numër i madh i gjyqtarëve theksojnë se megjithatë, në fund barrën dhe obligimet i kanë ata.

Ekzistojnë pengesa serioze për ekzekutimin efektiv dhe adekuat të vendimeve gjyqësore në fushën civile, administrative dhe penale. Procedurat civile dhe administrative janë komplekse dhe të shtrenjta për ekzekutim, ndërsa tek rastet penale ekzistojnë kushte joadekuate nëpër burgje dhe tolerancë në ekzekutimin e dënimeve për shkak të mospasjes së kushteve që gjyqësori t'i zhvillojë plotësisht procedurat penale.

Byroja për Përfaqësim e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut bëri përpjekje të konsiderueshme për ekzekutimin e shpejtë të aktgjykimeve, me ç'rast numri i aktgjykimeve të cilat akoma nuk janë ekzekutuar u reduktua për më shumë se gjysmën edhe atë në 56.<sup>34</sup>

Gjendja sa i përket besueshmërisë së gjyqësorit mund të prezantohet me rankimin e Maqedonisë sipas indikatorëve relevantë global. Një indikator i këtilillë është perceptimi i pavarësisë së gjyqësorit. Raporti global i konkurrencës për vitin 2016-2017 i Forumit Ekonomik Botëror e rankon Maqedoninë në pjesën e poshtme të kësaj Liste (në vendin e 106 nga 136 shtete).<sup>35</sup> Maqedonia në këtë shkallë ka rezultat

<sup>33</sup>“Gazeta Zyrtare e RM” numër 150. Ligji i ri LPP ofron zgjidhje ndryshe sa i përket punës së prokurorisë publike ku ligjvënësi procedurën e përgjithshme paratimore dhe hetimore ia ka besuar dhe ia ka dhënë në kompetencë prokurorit publik, e që do të thotë se puna e deritanishme e gjyqtarëve hetimor në pjesën e hetimit kalon në duart e prokurorit publik dhe ai e udhëheq hetimin, me çka përforcohet roli i prokurorit publik në luftën kundër kryerësve të veprave penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare.

<sup>34</sup> Raporti për Maqedoninë i Komisionit Evropian, 2016.

<sup>35</sup> Forumi Ekonomik Botëror e përcakton vlerën e këtij indikator në bazë të anketës së zbatuar vjetore me liderët e sektorit afarist në nivel global, me ç'rast të anketuarit mund të përgjigjen në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit të shtetit në fjalë me notën midis 1 dhe 7. Nota 1 tregon se gjyqësori është nën ndikim të madh nga qeveria, qytetarët ose kompanitë, ndërsa nota 7 tregon se është plotësisht i pavarur.

prej 3,1, ndërsa mesatarja botërore është 4,19. Vitin e kaluar ky indikator ishte 3,3 që do të thotë se në Maqedoni ekziston tendenca e përkeqësimit të besimit ndaj gjyqësorit.

Si indikatorë i dytë në këtë fushë mund të theksohet “pavarësia e perceptuar në të drejtën civile” e Projektit Drejtësia Botërore, në kontekst të Raportit për indeksin e qeverisjes së të drejtës.<sup>36</sup> Maqedonia është rankuar në gjysmën e sipërme të kësaj tablele në nivel global (në vendin e 51 nga 113), ndërsa në nivel rajonal është në vendin e tretë nga 13 shtete të rajonit. Indeksi në këtë shkallë është 0,56 në lidhje me pavarësinë e të drejtës civile. Rezultati nga Raporti i vitit të kaluar për Maqedoninë është 0,57, ndërsa në nivel global është rankuar në vendin e 38 nga 102 shtete. Edhe ky indikator për Republikën e Maqedonisë shënon përkeqësim.

Me qëllim të funksionimit më të mirë dhe avancimit të sistemit të jurisprudencës, lidhur me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në sistemin gjyqësor, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë kanë lidhur “Protokoll për bashkëpunim për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave”. Protokollin është objekt i analizës së vazhdueshme për avancimin e bashkëpunimit, koordinimit dhe veprimit të përbashkët. Në këtë aspekt, më së paku një herë në vit, institucionet kanë takim për shkak të evaluimit, koordinimit dhe shkëmbimit të përvojave. Në këtë domen, është mjaft i rëndësishëm bashkëpunimi midis institucioneve meqë bëhet fjalë për problem kompleks dhe multidimensional i cili nënkupton më shumë veprime kompetente.

---

<sup>36</sup>Forumi Ekonomik Botëror e përcakton vlerën e këtij indikator në bazë të anketës së zbatuar vjetore me liderët e sektorit afarist në nivel global, me ç'rast të anketuarit mund të përgjigjen në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit të shtetit në fjalë me notën midis 1 dhe 7. Nota 1 tregon se gjyqësori është nën ndikim të madh nga qeveria, qytetarët ose kompanitë, ndërsa nota 7 tregon se është plotësisht i pavarur.

<sup>37</sup>Ky tregues bazohet në përgjigjet e popullatës së përgjithshme dhe të anketuarve të kualifikuar, ku mund të jepen përgjigje nga 0 deri në 1, me ç'rast 1 do të tregojë respektimin më të fuqishëm deri në sundimin e së drejtës.

## 3.3\* Kompetenca

Në vitin 2015, Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavel Shatev” siguroi 267 trajnime të vazhdueshme për 5 888 pjesëmarrës. Nga gjithsej 13 kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë nga gjenerata e pestë e cila me sukses e përfundoi trajnimin fillestar në shkurt të vitit 2016, 12 prej tyre tanimë janë të punësuar në gjykatat themelore dhe prokuroritë themelore publike. 37 kandidatë të ri janë regjistruar në trajnimin fillestar të Akademisë.<sup>37</sup>

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë më datë 30.08.2016 shpalli konkurs për pranimin e kandidatëve për trajnimin fillestar për shkak të plotësimit të numrit të nevojshëm të prokurorëve publikë, konform ndryshimeve dhe plotësimeve ligjore nga muaji dhjetor i vitit 2015. Në ndërkohë nuk ka informacione të aksesshme sa i përket procedurës së zgjedhjes së gjeneratës së gjashtë të kandidatëve për trajnimin fillestar,<sup>38</sup> me ç'rast akoma nuk është përpiluar rank-lista përfundimtare për shkak të procedurave ankimore të cilat zhvillohen në Gjykatën Administrative dhe në Gjykatën e Lartë Administrative.<sup>39</sup>

Atë që mund ta theksojmë si pozitive, ndërsa ka rëndësi të veçantë për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, si dhe për institucionet e tjera, janë pjesëmarrjet e realizuara në shumë konferenca dhe trajnime, me qëllim që të shqyrtohen praktikat dhe mundësitë më të mira për implementimin e tyre, me qëllim të funksionimit më të mirë dhe avancimit të sistemit të jurisprudencës. Trajnimi i vazhdueshëm është segmenti më gjithëpërfshirës i punës së Akademisë dhe përfshinë target grupe në tre programet kryesore për trajnim edhe atë: programin e përgjithshëm për trajnim të detyrueshëm të vazhdueshëm, programin e specializuar për trajnim të detyrueshëm të vazhdueshëm dhe programin e specializuar për trajnim vullnetar të vazhdueshëm. Gjatë muajit gusht të vitit 2016 u përpilua edhe plani i aktiviteteve në kuadër të trajnimit vullnetar të vazhdueshëm për nëpunësit gjyqësor dhe të prokurorive publike, si dhe plani i aktiviteteve në kuadër të trajnimit të detyrueshëm të vazhdueshëm për gjyqtarë, kryetarë të gjykatave dhe prokurorë publikë të prokurorive publike dhe që të dyja brenda periudhës shtator-dhjetor të vitit 2016.

Nevojitet që të përkushtohet vëmendje më e madhe mbi zhvillimin e të ashtuquajturave aftësi intelektuale,<sup>40</sup> duke e përfshirë etikën, integritetin dhe aftësitë e komunikimit – veçanërisht për kryetarët e gjykatave. Përveç kësaj, praktika dëshmon se gjyqtarët nuk posedojnë njohuri të mjaftueshme për të drejtën e BE, për mundësinë e zbatimit të tij të drejtpërdrejtë, si dhe për praktikën e Gjykatës Evropiane.

Nëse i bëjmë një vështrim bashkëpunimit me organizatat qytetare, mesa duket numri i organizatave qytetare të cilat bashkëpunojnë me Akademinë filloi të reduktohet. Akademia shpeshherë ka dëshirë të përfshihet plotësisht në aspektet e organizimit të projekteve të organizatave qytetare, të cilat më së shpeshti janë paracaktuar nga ana e donatorëve.

Disa konsiderojnë se rekrutimi i trajnuesve në Akademi nuk bëhet në mënyrë transparente, meqë disa herë gjyqtarë të njëjtë rekrutohen si trajnues. Mesa duket në strukturën organizative aktuale institucionale nuk ka hapësirë që organizata eksperte qytetare të ofrojë arsim të vazhdueshëm të gjyqtarëve. Madje edhe Dhoma Maqedonase e Avokatisë e ndërpreu sigurimin e trajnimeve për gjyqtarë. Gjyqtarëve u logariten si të detyrueshëm vetëm ato kurse të cilët ligjërohen në Akademi.<sup>41</sup>

<sup>37</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë për vitin 2016.

<sup>38</sup> <http://www.jpacademy.gov.mk/upload/PDF%20Files/Priracnik%20modul4.pdf>

<sup>39</sup> <http://www.osce.org/skopje/123941?download=true>

<sup>40</sup> Soft skills.

<sup>41</sup> <http://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2016/06/Macedonia-country-report-MKD.pdf>



Edhe krahas faktit që Akademisë i mungon personeli ndihmës, ajo në bashkëpunim me persona të jashtëm filloi me matjen e efikasitetit të trajnimeve dhe me analizën nëse të njëjtat rezultojnë me ndryshimet e sjelljes dhe veprimet të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.

## 4.\* Konkluzione

Republika e Maqedonisë ishte njëra nga vendet e para të rajonit e cila i filloi reformat në fushën e gjyqësorit në kontekstin e proceseve eurointegruese, përmes miratimit të Strategjisë për reformë të sistemit të jurisprudencës 2004–2007 dhe përmes miratimit të amendamenteve kushtetuese në këtë fushë. Më shumë se një dekadë, pas fillimit të këtyre reformave të rëndësishme, mund të konstatohet se korniza juridike në Republikën e Maqedonisë i inkorporoi thuaja se të gjitha standardet e rëndësishme ndërkombëtare për një gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm. Ekzistojnë segmente në kornizën juridike vendore tek të cilat ka hapësirë për përmirësim prej të cilave vetëm disa janë të karakterit esencial. Megjithatë, harmonizimi, para së gjithash, ka të bëjë me kornizën juridike dhe standardet vendore, por jo edhe me zbatimin e të njëjtave dhe me praktikën e gjykatave. Akoma janë të nevojshme angazhime plotësuese për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit dhe për sigurimin e kushteve për paanshmërinë e gjyqtarëve, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e drejtësisë dhe të lehtësohet qasja deri te drejtësia.

IRaportet e Komisionit Evropian vënë në dukje se nevojiten angazhime plotësuese për depolitizimin e gjyqësorit në përputhje me “Prioritetet Urgjente të Reformave”, si dhe për sigurimin e transparencës dhe objektivitetit të mëtutjeshëm në sistemin e zgjedhjes dhe avancimit. Krahas asaj që Këshilli Gjyqësor është formuar nga “gjyqtarët për gjyqtarë”, me përbërje që ia ofron shumicën e votave kastës së gjyqtarëve, në praktikë ndikimi i fushave të tjera të pushtetit konsiderohet si akoma i fuqishëm. Ekzistojnë raporte të përsëritura për drejtësi selektive dhe ndërhyrje politike tek disa lëndë të caktuara të profilit të lartë ose politikisht sensitive. Kjo i hedhë njollë edhe sistemit funksional gjyqësor.

Kushtet për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës nuk mundësojnë që në mënyrë përkatëse të vlerësohen aftësitë menaxheriale të kandidatëve për kryetarë të gjykatës. Në rregullimin e brendshëm juridik nuk është parashikuar mundësia që të paraqitet ankesë ndaj vendimit të Këshillit Gjyqësor për zgjedhjen e gjyqtarit. Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve e vë fokusin mbi kriteret kuantitative ndërsa më pak mbi kompetencat themelore të gjyqtarëve, ndërsa aktet normative lënë mundësi që gjyqtari të sanksionohet në bazë të numrit të vendimeve të ndryshuara nga ana e gjykatës më të lartë. Ushtimi joprofesional i funksionit si bazë për shkarkim mund të interpretohet gjerë e gjatë, meqë aktet normative nuk e bëjnë përcaktimin e tij më të saktë.

Aktet normative në fushën e gjyqësorit shpeshherë ndryshohen me procedurë të shkurtuar, pa analiza përkatëse, pa konsultime dhe debate publike. Internet-qasja në drejtësi dhe praktikën gjyqësore në parim është e aksesshme, por në praktikë është e paqëndrueshme.

Komisioni Evropian konstatoi se buxheti i gjykatave maqedonase për vitin 2016, në masë të konsiderueshme, është më i ulët nga mesatarja evropiane për kokë banori, ndërsa numri i gjyqtarëve dhe personelit gjyqësor për 100 000 qytetarë në masë të konsiderueshme është më i lartë nga mesatarja evropiane dhe sipas kësaj parashtrihen pyetjet për efikasitetin dhe shpërndarjen efikase të resurseve.<sup>42</sup> Përkrah faktit që formalisht funksionon Këshilli Buxhetor Gjyqësor, i njëjti në praktikë është i detyruar t'i

<sup>42</sup>Sipas lartësisë së shpenzimeve publike në sistemin gjyqësor, Maqedonia për kokë banori harxhon më pak se çdo vend tjetër anëtar i BE, megjithatë sipas pjesëmarrjes së shpenzimit të këtyre në bruto-prodhimin vendor, Maqedonia në vite të caktuara matet me pesë vendet e para në BE sipas konsumit publik në sistemin gjyqësor.

pranojë kufizimet e imponuara nga Ministria e Financave, të cilët nuk e respektojnë shumën e përcaktuar me ligj prej 0,8% nga bruto prodhimi vendor të dedikuar për shpenzime publike në sistemin e jurisprudencën.<sup>43</sup>

Monitorimi i procedurave gjyqësore edhe më tej e vë në dukje faktin se shkak më i shpeshtë për shtyrjen e procedurave është mos-shoqërimi i personave të paraburgosur dhe të dënuar, më së shpeshti për shkak të mospasjes së kushteve që të njëjtit të shoqërohen deri në gjykatë me qëllim që të gjykohen në mënyrë të drejtë, të ndershme dhe në afat të arsyeshëm.<sup>44</sup> Raporti i fundit i Komisionit Evropian për Maqedoninë e veçon si një sfidë të vazhdueshme sigurimin e konsistencës së aktgjyqimeve, edhe pse Gjykata Supreme vazhdoi me përpjekjet në këtë drejtim.

Indikatorët e pranuar ndërkombëtarë për perceptimet e publikut, më saktësisht të segmenteve të caktuara të publikut, vënë në dukje zvogëlimin e besimit ndaj gjyqësorit, përkatësisht mendimin e përkeqësuar për pavarësinë e gjyqësorit në Maqedoni.

Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë i nevojiten më shumë resurse financiare dhe kadrovike, në mënyrë që t'u përgjigjet nevojave të mëdha – përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me zhvillimin e të ashtuquajturave aftësi intelektuale,<sup>45</sup> si dhe nevojave për trajnime për të drejtën e BE dhe zbatimin e saj.

---

<sup>43</sup>Ligji për buxhetin gjyqësor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 60/2003, 37/2006, 138/2008, 145/2010.

<sup>44</sup>Konferenca përfundimtare për prezantimin e synimeve dhe arritjeve në kuadër të Projektit: "Ndërtimi i kapaciteteve të agjencive për zbatimin e Ligjit për trajtim adekuat të personave të paraburgosur dhe të dënuar", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i realizuar nga Këshilli i Evropës.

<sup>45</sup>Soft skills.

## 5.\* REKOMANDIME

Në bazë të konstatimit tanimë të prezantuar për nevojën e zbatimit të plotë të reformave esenciale, si prioritare i vëçojmë rekomandimet si vijojnë:

1. Të krijohen kushte për shoqërimin e personave të paraburgosur dhe të dënuar, me qëllim të respektimit të procedurave gjyqësore dhe për respektimin e afateve.

2. Në Ligjin për gjykata të parashikohet organi i cili do të jetë kompetent që gjyqtarëve t'u sigurojë qasje të lehtë deri te legjislacioni, marrëveshjet ndërkombëtare, praktika gjyqësore dhe ngjashëm.

3. Rishikim urgjent i bazave të buxhetit gjyqësor, me qëllim të përcaktimit dhe shpërndarjes së drejtë të mjeteve me respektimin më të madh të parimit të pavarësisë së gjyqësorit.<sup>46</sup>

4. Të bëhet vlerësimi i aspektit optimal të rrjetit ekzistues gjyqësor, si dhe aspektit optimal të numrit dhe llojit të nëpunësve gjyqësorë, si bazë për zbatimin e reformave të mëtutjeshme, së këtejmi duke siguruar qasjen e qytetarëve deri te drejtësia.

5. Është e domosdoshme të inkorporohet një sistem adekuat për trajnim dhe përsosje profesionale të nëpunësve administrativ dhe nëpunësve gjyqësorë.

6. Të avancohet statistika gjyqësore përmes përfshirjes së indikatorëve të parashikuar në EU Justice Scoreboard dhe qasja deri te e njëjta. Është e domosdoshme të sigurohet sistemi ACCMIS për gjykatat, me qëllim që të dhënat t'i përpunojnë në mënyrë më të mirë dhe njëherësh rregullisht të publikohen të dhëna të azhuruara statistikore, konform Metodologjisë së praktikës gjyqësore.

7. Ndryshimet e akteve normative në fushën e gjyqësorit duhet të bazohen në analiza paraprake dhe në konsulta të gjera me të gjitha palët e interesuara, si dhe në dialogun profesional.

8. Është i domosdoshëm bashkëpunimi konstruktiv dhe i qëndrueshëm i institucioneve gjyqësore me sektorin civil, me qëllim të zbatimit të përbashkët, monitorimit dhe vlerësimit të reformave esenciale sa i përket sundimit të së drejtës.

9. Organizatat qytetare me kapacitetet e tyre të kontribuojnë në procesin e zbatimit të trajnimeve për të drejtën e BE në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

10. Nevojitet vëmendje më e madhe t'i përkushtohet zhvillimit të të ashtuquajturave aftësi intelektuale<sup>47</sup> të gjyqtarëve, përfshirë këtu edhe etikën, integritetin dhe aftësitë e komunikimit.

11. Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë të instalojë sistem të përhershëm për monitorimin dhe evaluimin e trajnimeve të mbajtura, me qëllim që në mënyrë sistematike të monitorohet dhe avancohet suksesi dhe rezultatet e sistemit.

12. Të bëhet depolitizimi i gjyqësorit në praktikë, përkatësisht gjyqësori të ndahet nga ndikimet e pushtetit ekzekutiv dhe të partive politike, përfshirë këtu edhe zgjedhjen, avancimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve.

<sup>46</sup>Projeksioni për buxhetin e kërkuar gjyqësor, bashkë me projeksionet për vëllimin e projektuar të punës, duhet të publikohen para se të dërgohen në Ministrinë e Financave.

<sup>47</sup>Soft skills.

13. Të rishikohen kushtet për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës, me qëllim që të vlerësohet nëse në mënyrë përkatëse i stimulojnë kandidatët për kryetarë të gjykatës me aftësi të mira menaxheriale.

14. Të shqyrtohen mundësitë për inkorporimin e të drejtës së ankesës në rastet e zgjedhjes së gjyqtarëve dhe zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqësorit.

15. Të përmirësohet sistemi i vlerësimit të punës së gjyqtarëve, në mënyrë që të sigurohet bilanci adekuat midis aspekteve kualitative dhe kuantitative të punës. Në këtë aspekt, cilësia e gjyqtarëve të vlerësohet përmes analizës së aktgjykimeve.

16. Të ndërmerren aktivitete në drejtim të rritjes së pavarësisë dhe paanshmërisë së funksionit të gjyqtarit, integritetit të gjyqtarit dhe prokurorëve, si dhe rritjes së ndërgjegjësimit për rolin e tyre në shoqërinë maqedonase.


## ANEKSI 1:

Indikatorë të përcaktuar për monitorimin e progresit të prioritetit: *“Përmirësimi i efikasitetit dhe kompetencës: Pasqyrë e cilësisë, efikasitetit dhe kompetencës së gjyqtarëve dhe gjykatave.”*

Masa – instrument i Strategjisë së EIL 2020	Indikator	Të dhëna	Metoda e grumbullimit të informacionit	Rreziqet
Cilësia	Vlerësimi i Raportit të KE	Raport i KE	Pasqyra e dokumentacionit	Publikim i vonuar
	Respektimi i parimeve për gjykim të drejtë dhe të ndershëm	Monitorim nga vëzhgues të pavarur	Monitorimi	Mosekzistimi i informatave relevante, informacione të pamjaftueshme për dhënien e vlerësimit
	Përfaqësimi gjinor dhe i drejtë i gjyqtarëve	Raport i Këshillit Gjyqësor të RM: Raport i Avokatit të Popullit	Pasqyrë e dokumentacionit	Publikim i vonuar, mosekzistimi i informatave relevante
	Transferimi i gjyqtarëve nëpër gjykata dhe njësi gjyqësore;	Raport i Këshillit Gjyqësor të RM	Pasqyrë e dokumentacionit	Publikim i vonuar, mosekzistimi i informatave relevante
	Numri i gjyqtarëve të zgjedhur në gjykatat themelore dhe instancat më të larta;	Raport i Këshillit Gjyqësor të RM	Pasqyrë e dokumentacionit	Mospasje e qasjes në dokumente, mungesë e vullnetit për pjesëmarrje në intervista mosekzistimi i informatave relevante,
	Numri i gjyqtarëve të shkarkuar	Raport i Këshillit Gjyqësor të RM	Pasqyrë e dokumentacionit	Mospasje e qasjes në dokumente, mungesë e vullnetit për pjesëmarrje në intervista mosekzistimi i informatave relevante,
	Kriteret objektive dhe transparente për zgjedhje dhe karrierë të gjyqtarëve të bazuara në parimin e meritave, të zbatuara përmes procedurës transparente dhe të hapur	Dispozita ligjore dhe procedura për zgjedhjen e gjyqtarëve	Pasqyrë e dokumentacionit; pyetësor dhe anketa me palët e interesuara	Mosekzistimi i informatave relevante për rrjedhën e procedurave për zgjedhjen e gjyqtarëve

Masa - instrument i Strategjisë së EIL 2020	Indikatori	Të dhëna	Metoda e grumbullimit të informacionit	Rreziqet
Cilësia	Vlerësimi i Raportit të KE	Raport i KE	Pasqyra e dokumentacionit	Publikim i vonuar
	Kritere objektive dhe transparente për shkarkimin e gjyqtarëve, bazuar në parimin e objektivitetit dhe paanshmërisë.	Dispozita ligjore dhe procedura për zgjedhjen e gjyqtarëve	Pasqyrë e dokumentacionit, pyetësorë dhe anketa me palët e interesuara	Mosekzistimi i informatave relevante për rrjedhën e procedurave për shkarkimin e gjyqtarëve
	Ankesa të paraqitura lidhur me vendimet për zgjedhje dhe emërime	Raport i Këshillit Gjyqësor të RM	Pasqyrë e dokumentacionit	Mosekzistimi i informatave relevante
	Ankesa të paraqitura lidhur me vendimet për shkarkime			Mosekzistimi i informatave relevante
Efikasiteti	Vlerësimi i Raportit të KE	Raport i KE	Pasqyra e dokumentacionit	Publikim i vonuar
	Përmbushja e kërkesave buxhetore vjetore për gjyqësorin	Raport i KE, Raport i Këshillit Gjyqësor	Pasqyrë e dokumentacionit	Publikim i vonuar, mosekzistimi i informatave relevante
	Përmbushja e kërkesave buxhetore vjetore të AGJPP	Raport i KE, Raport i AGJPP	Pasqyrë e dokumentacionit	Publikim i vonuar, mosekzistimi i informatave relevante
	Plani për punësime të nevojshme në gjyqësor	Raport i Këshillit Gjyqësor të RM	Pasqyrë e dokumentacionit	Publikim i vonuar, mosekzistimi i informatave relevante
	Numri i lëndëve në gjykata	Raport i Këshillit Gjyqësor të RM	Pasqyrë e dokumentacionit	Publikim i vonua
	Kohëzgjatja mesatare e procedurës	Raport i Këshillit Gjyqësor të RM	Pasqyrë e dokumentacionit	Publikim i vonua
	Rritje e përqindjes së qytetarëve të cilët kanë besim në sistemin gjyqësor	Anketa	-Anketë e realizuar për matjen e kënaqësisë së shfrytëzuese të gjykatave	Njëanshmëri gjatë përgjigjeve

Masa - instrument i Strategjisë së EIL 2020	Indikatori	Të dhëna	Metoda e grumbullimit të informacionit	Rreziqet
	Publikimi i të gjitha aktgjykimeve gjyqësore në afate qartë të përcaktuara me ligj me sigurimin e mundësive të plota për kërkim dhe qasje të lehtësuar	Ueb faqet e gjykatave	Pasqyrë e ueb faqeve	Publikim i vonuar
	Ekzekutim i shpejtë i të gjitha aktgjykimeve të GJEDNJ kundër shtetit (veçanërisht përmes zhvillimit të masave praktike dhe efektive për çdo kategori të lëndëve).	Raport i Byrosë për Përfaqësimin e Shtetit para GJEDNJ	Pasqyrë e dokumentacionit	
Kompetenca	Vlerësimi i Raportit të KE	Raport i KE	Pasqyra e dokumentacionit	Publikim i vonuar
	Numri i trajnimeve të mbajtur nga	Raport i AGJPP	Pasqyrë e dokumentacionit	
	Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të trajnuar me trajnime plotësuese	Raport i AGJPP	Pasqyrë e dokumentacionit	
	Numri i dëgjuesve të trajnimit fillestar të AGJPP	Raport i AGJPP	Pasqyrë e dokumentacionit	
	Numri dhe cilësia e ligjëruesve në AGJPP	Raport i AGJPP	Pasqyrë e dokumentacionit	
	Kurikuli i zhvilluar – programi për trajnim dhe azhurnimi i tij në përputhje me dokumentet strategjike të shtetit	Raport i AGJPP	Pasqyrë e dokumentacionit	Mospasje qasje në informatat relevante



Instituti  
për  
politikë  
evropiane.  
Shkup

Raporti tematik i Projektit  
„Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë (JUDGMeNT)“

# BASHKËPUNIMI GJYQËSOR LIDHUR ME QASJEN E LIRË DERI TE INFORMACIONET, ZBATIMIN E EKZEKUTIMIT NDËRKUFITAR DHE PROCEDURËN NDËRKUFITARE TË FALIMENTIMIT, TRANSFERIMIT DHE BASHKIMIT

Shkup, Dhjetor 2016

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Pikëpamjet e shprehura ktu në asnjë mënyrë nuk pasqyrojnë mendimin zyrtar të Këshillit për Bashkëpunimit Rajonal.



Përmbajtje:

- 03.** Shënime hyrëse për Strategjinë e EJK 2020: Vendet e punës dhe perspektiva evropiane
- 04.** Korniza juridike e BE
- 06.** Korniza ligjore e Republikës së Maqedonisë
- 09.** Pasqyrë e gjendjeve të përfshira me prioritetin e dytë të Strategjisë për EJK 2020 në dimensionin Drejtësi – Bashkëpunimi gjyqësor lidhur me qasjen e lirë deri te informacionet, zbatimin e ekzekutimit ndërkufitar dhe procedurën ndërkufitare të falimentimit, transferimit dhe bashkimit
- 12.** Ngjarjet më të rëndësishme në këtë fushë në disa muaj të kaluar
- 16.** REKOMANDIME
- 17.** ANEKSI 1

# 1\* Shënime hyrëse për Strategjinë e EJL 2020: Vendet e punës dhe perspektiva evropiane

Strategjia e EJL 2020: *Vendet e punës dhe perspektiva evropiane* ka për qëllim përmirësimin e kushteve të jetës në rajon dhe kthimin e sërishëm në fokus të çështjeve të konkurrencës dhe zhvillimit. Strategjia u miratua në vitin 2013, ndërsa procesin e zhvillimit, miratimit dhe implementimit të të njëjtit e koordinon Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (KRB). Përforcimi i bashkëpunimit rajonal është parakusht për progres në procesin e anëtarësimit të shteteve të rajonit në Bashkimin Evropian.

Strategjia është përqendruar mbi 4 (katër) shtylla zhvillimore të ndërlidhura midis tyre, prej të cilave shtylla **Qeverisja për rritje** ka tre dimensione: Shërbime efektive publike, Parandalimi i korrupsionit dhe Drejtësia. Në fushën e *Drejtësisë* identifikohen tre prioritetet, në mesin e të cilëve **“Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor lidhur me qasjen e lirë deri te informacionet, zbatimin e ekzekutimit ndërkufitar dhe procedurën ndërkufitare të falimentimit, transferimit dhe bashkimit”**.

Strategjia e EJL 2020 thekson se në kuadër të Bashkimit Evropian, në kornizat e bashkëpunimit gjyqësor, janë parashikuar instrumente për shfrytëzimin ndërkufitar të shërbimeve gjyqësore dhe për qasjen e lirë deri te informacionet për shërbimet gjyqësore nacionale. Me ekzekutimin ndërkufitar, të drejtat dhe regjistrimet e firmave, si dhe procedurat ndërkufitare për falimentim, rriten transferimet dhe bashkimet dhe njëherësh, përforcohet tregu i përbashkët. Së këtejmi, shtetet e mbështesin lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve dhe investimeve, ekzekutimin ndërkufitar dhe themelimin e bizneseve.

Përveç kësaj, Strategjia e EJL 2020 e thekson nevojën e vendeve të rajonit që t'i rrisin përpjekjet e tyre në këtë drejtim dhe ta përforcojnë bashkëpunimin ndërkufitar edhe në pjesën e qasjes së lirë deri te informacionet për shërbimet gjyqësore, kornizën juridike për regjistrimin ndërkufitar të kompanive, për të drejta dhe mundësi për procedura ndërkufitare të falimentimit, si dhe për rregullat në rastet e transferimit dhe bashkimit ndërkufitar.

Është e pamohueshme lidhshmëria e qëllimeve të këtij dimensionit me Kapitujt negociues 23 dhe 24 dhe progresi në këtë pjesë padyshim se do të merren parasysh gjatë vlerësimit të progresit të vendeve në procesin e inkuadrimit në BE. Megjithatë, duhet të theksohet se bashkëpunimi ndërkufitar, përkatësisht rajonal, para së gjithash, është në interes të vendeve të rajonit në drejtim të krijimit të biznes klimës më të mirë, rritjes së vendeve të punës dhe në përgjithësi rritjes së prosperitetit të shoqërive tona.

Duke e pasur parasysh faktin se bashkëpunimi ndërkuftar kryhet përmes transponimit të zgjidhjeve të Bashkimit Evropian, të cilat doemos duhet të pranohen në procesin e përafrimit, është e dobishme që të njëjtat të theksohen. Baza ligjore për bashkëpunimin e jurisprudencës në Bashkimin Evropian është përfshirë në nenin 81 paragrafi 1 të tekstit të spastruar të Marrëveshjes për funksionimin e Bashkimit Evropian, Protokollin nr. 20 dhe 21 i Traktatit të Lisbonës.<sup>1</sup>

Në pjesën e përcaktimit të gjykatës kompetente, njihjen dhe ekzekutimin e aktgjykimeve dhe vendimeve në lëndët jashtëgjyqësore instrumenti kryesor është Urdhëresa e Këshillit nr. 44/2001 për kompetencën, njihjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në kontestet civile dhe tregtare.<sup>2</sup> Me këtë Urdhëresë krijohen kushte për harmonizimin e rregullave për konfliktin e kompetencave brenda shteteve-anëtare, si dhe të thjeshtëzohet dhe përshpejtohet njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të cilat janë miratuar në kontestet civile dhe tregtare.

Kjo Urdhëresë është plotësuar me Urdhëresën e Këshillit (EC) nr. 2201/2003 nga data 27 nëntor i vitit 2003 në lidhje me kompetencën, njihjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lëndët martesore dhe në lëndët e përgjegjësisë prindërore („Brussels IIa Regulation“).

Pastaj, në mënyrë që të lehtësohet arkëtimi ndërkombëtar i borxheve në lidhje me përkujdesjen, Këshilli e miratoi Urdhëresën nr. 4/2009 në të cilën në një instrument juridik i bashkoi të gjitha aktet e kompetencës gjyqësore, të drejtës meritore, njihjen dhe ekzekutimin e vendimeve, si dhe bashkëpunimin e organeve kompetente kombëtare.

Sa i përket procedurës ndërkufitare të falimentimit, me qëllim që ta përmirësojë dhe përshpejtojë procedurën e falimentimit, Këshilli miratoi Urdhëresë nr. 1346/2000. Për momentin kjo Urdhëresë rishikohet. Me Urdhëresën nr. 805 /2004 është inkorporuar Urdhri Evropian për ekzekutimin e kërkesave të pakontestueshme.

Qëllimi i Urdhëresës nr. 650/2012 së Parlamentit dhe Këshillit është shfuqizimi i të gjitha rekomandimeve me të cilat ballafaqohen qytetarët gjatë gëzimit të të drejtave të tyre që kanë të bëjnë me trashëgiminë ndërkombëtare. Sa i përket pjesës për përmirësimin e qasjes në kontestet ndërkombëtare, Këshilli e miratoi Direktivën nr. 2003/8/EC me të cilën përcaktohen rregullat e përbashkëta minimale për ndihmën e jurisprudencës. Qëllimi i kësaj Direktive është të garantohet një shkallë e caktuar e ndihmës juridike në kontestet ndërkufitare për çdo person i cili nuk posedon mjete të nevojshme.

Sa i përket lehtësimit të qasjes së shoqërive dhe qytetarëve evropian në drejtim të jurisprudencës si dhe ta bëjë më efikas, Bashkimi Evropian inkorporoi rregulla të përbashkëta të veprimit dhe përshpejtimit të zgjidhjes së kontesteve ndërkufitare në lidhje me kërkesa më pak të rëndësishme, si dhe kthimin ndërkufitar të kërkesave të pakontestueshme monetare për mbarë rajonin e Unionit. Bëhet fjalë për Urdhëresën (EC) nr. 861/2007 për inkorporimin e kontesteve evropiane me vlerë të vogël dhe për Urdhëresën (EC) nr. 1896/2006 për inkorporimin e urdhër-pagesës evropiane. Bëhet fjalë për procedura të cilat nuk janë të detyrueshme, sa u përket procedurave të parashikuara me legjislacionet kombëtare.

<sup>1</sup> Qëllimi i cili dëshirohet të arrihet me veprimin e BE në fushën e bashkëpunimit në lëndët civile, është si vijon:

· Të arrihet shkallë e lartë e sigurisë juridike të qytetarëve në marrëdhëniet ndërkufitare të rregulluara me ligjet civile

· Qytetarëve t'u garantohet qasje e thjeshtë dhe efikase deri te gjykatat të cilat veprojnë në lëndët civile për shkak të zgjidhjes së kontesteve ndërkufitare

· Të thjeshtëzohen instrumentet e bashkëpunimit ndërkufitar midis gjykatave kombëtare civile

· Të mbështetet edukimi i gjyqtarëve dhe nëpunësve gjyqësor

<sup>2</sup> (Council Regulation (EC) No 44/2001 of 22 December 2000 on jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in civil and commercial matters ('Brussels I Regulation'))

Me Direktivën nr. 2008/52/EC përcaktohen rregulla të përbashkëta për aspekte të caktuara për ndërmjetësim në lëndët civile dhe tregtare, me qëllim të rritjes së sigurisë juridike, si dhe stimulimit të shfrytëzimit të ndërmjetësimit në zgjidhjen e kontesteve.

Jo më pak i rëndësishëm është instrumenti për bashkëpunim ndërkufitar midis institucioneve të jurisprudencës në kontestet civile. Me Urdhëresën (EC) nr. 1393/2007 me qëllim që të thjeshtëzohet dhe shpejtohet dërgesa e dokumenteve gjyqësore dhe jogjyqësore në shtetet-anëtare dhe me këtë të arrihet efikasiteti dhe shpejtësia e procedurave gjyqësore. Këshilli e miratoi edhe Urdhëresën (EC) nr. 1206/2001 me qëllim që të thjeshtëzohet dhe përshpejtohet bashkëpunimi midis gjykatave të vendeve-anëtare për sigurimin e provave në lëndët civile dhe tregtare.

Me Vendimin e Këshillit nr. 2001/470/EC u vendos Rjeti Evropian i Jurisprudencës në lëndët civile dhe tregtare. Vendimi nr. 2001/470/EC u ndryshua me Vendimin nr. 568/2009/EC me qëllim që të zgjerohet dhe përforcohet roli i Rjetit Evropian të Jurisprudencës në kontestet civile dhe tregtare. Me këtë vendim Rjeti është i hapur edhe për përfaqësuesit e shoqatave, përfaqësuesit e profesionit juridik, veçanërisht për Dhomën e avokatëve, juristëve, noterëve dhe përmbaruesve.

Përveç kësaj, duhet të theksohet se ekziston edhe një instrument për thjeshtëzimin e bashkëpunimit në lëndët civile, dhe ky është zhvillimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në administratën e jurisprudencës. Bëhet fjalë për një projekt i cili ka filluar në vitin 2007 dhe është shndërruar në strategji evropiane në rajonin e e-jurisprudencës. Instrumentet e e-jurisprudencës janë: vendosja e portalit evropian të e-jurisprudencës, ndërlidhja e ndërsjellë të evidencave penale në nivel evropian, përdorimi më i madh i video-konferencave gjatë procedurave gjyqësore, përkthimi automatik, formularët e rjetit dinamik, si dhe baza evropiane e përkthyesve dhe interpretuesve gjyqësor. Gjithashtu, edhe pasqyra vjetore e situatës në juridiksionin e jurisprudencës së Bashkimit Evropian është një mekanizëm informativ i Komisionit për ndihmën e BE dhe shteteve-anëtare për arritjen e përbërjes më cilësore të jurisprudencës përmes mundësimit të të dhënave objektive, të sakta dhe komparative për cilësinë dhe efikasitetin e sistemit të jurisprudencës të të gjitha shteteve-anëtare.

Sa u përket procedurave të falimentimit, në Evropë aktualisht është në fuqi Rregullorja e Bashkimit Evropian për procedurat në rastet e insolvencës 1346/2000. Në të vërtetë bëhet fjalë për njëën nga rregulloret më të plota të së drejtës ndërkombëtare të insolvencës. Kjo Rregullore hyri në fuqi më 31 maj 2002 dhe pati influencë të madhe mbi kuadrin ligjor të falimentimit, si dhe mbi shtetet të cilat e fituan statutin e kandidatit për inkuadrim në BE. Sa u përket vendeve të Evropës Juglindore, një kontribut të madh për stimulimin e këtij bashkëpunimi pritet të ofroj formimi i Rjetit të Institucioneve për trajnimin e gjyqtarëve në Evropën Juglindore, i cili u formua në muajin prill të vitit 2016, ndërsa Këshilli Rajonal për Bashkëpunim e mori rolin kryesor në kuadër të Rjetit për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Qendra e Informacioneve për takime, punëtori dhe seminare rajonale për trajnimin e përfaqësuesve të institucioneve të jurisprudencës.

# 3\* Korniza ligjore e Republikës së Maqedonisë

Veprimi i gjykatave gjatë zbatimit të procedurave ndërkuftare për falimentim, transferim dhe bashkim, si dhe për çështje tjera të rëndësishme për zhvillimin ndërkuftar të biznesit është rregulluar me ligjet e Republikës së Maqedonisë. Ligjet bazikë të cilët e rregullojnë këtë materie janë: Ligji për shoqëri tregtare,<sup>3</sup> Ligji për transferim e shoqëri tregtare,<sup>4</sup> Ligji për falimentim, Ligji për përmbarrim dhe aktet nënligjore të cilat burojnë nga të njëjtit.

Nga analiza e kornizës ligjore për falimentim në Republikën e Maqedonisë mund të konkludojmë se ekziston kornizë ligjore për falimentimin ndërkuftar, me ç'rast e njëjta është plotësisht e harmonizuar me Urdhëresën e Bashkimit Evropian.<sup>5</sup>

Në Ligjin për falimentim i cili në Republikën e Maqedonisë aktualisht është në fuqi është parashikuar kapitulli i veçantë me titull Falimentimi ndërkombëtar. Në këtë pjesë të Ligjit janë parashikuar rregullat nga e ashtuquajtura e Drejta ndërkombëtare<sup>6</sup> e cila është njëra nga fushat më komplekse dhe më të vështira juridike që në vetvete përfshinë më shumë veprime të ndryshme procesuale, materiale dhe veprime juridike në kolizion.<sup>7</sup>

<sup>3</sup>Ligji për shoqëritë tregtare i rregullon çështjet e bashkimit, bashkëngjitjes dhe ndarjes së shoqërive. Ligji nuk bën dallime midis shoqërive me kapital vendor dhe të huaj. Nëse shoqëria funksionon në Republikën e Maqedonisë ajo duhet të themelohet konform Ligjit për shoqëri tregtare dhe ta respektojë legjislacionin e atij vendi. Këto dispozita janë emblematike dhe miqësore ndaj bizneseve të cilët funksionojnë në Republikën e Maqedonisë.

<sup>4</sup>Transferimi i shoqëri tregtare në Republikën e Maqedonisë rregullohet me Ligjin për transferimin e shoqëri tregtare ("Gazeta Zyrtare e RM numër 69/13, 188/13, 166/14, 154/15 dhe 23/16). Me këtë Ligj rregullohet mënyra, kushtet dhe procedurat e transferimit të shoqërive aksionare, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në procedurën e transferimit dhe mbikëqyrja mbi zbatimin e procedurës së transferimit të shoqërive aksionare. Dispozitat e Ligjit zbatohen ndaj letrave me vlerë të cilat listohen në bursën e autorizuar të letrave me vlerë të lëshuara nga shoqëritë aksionare me obligime të veçanta për raportime, konform Ligjit për letra me vlerë, ndërsa nuk zbatohen gjatë blerjes së aksioneve në pronësi të Republikës së Maqedonisë. Esenca e Ligjit është në dispozitës se asnjë person, i vetë ose bashkë me persona me të cilët vepron bashkërisht, nuk guxon të fitojë më shumë se 25% të letrave me vlerë me të drejtë vote të lëshuara nga një shoqëri e caktuar aksionare pa dhënë ofertë paraprake për transferim. Ofertuesi në ofertë obligohet se do t'i blejë të gjitha aksionet e shoqërisë brenda një periudhe të caktuar dhe sipas çmimit të caktuar i cili nuk guxon të jetë më i ulët nga çmimi më i lartë sipas të cilit transferuesi tanimë ka blerë aksione në 12 muajt e fundit para njoftimit për qëllimin e transferimit, ose më të ulët nga çmimi mesatar i arritur në një bursë të autorizuar, ose në lartësinë e vlerës së çmuar të letrave me vlerë të përcaktuara nga ana e vlerësuesit të autorizuar. Synimi i ligjit është të mbrohen aksionarët jodominant dhe ata mund t'i shesin aksionet e tyre në shoqërinë e cila transferohet, me çmim identik të atij sipas të cilit është transferuar pjesa shumica e aksioneve ndonjë shoqërie. Përveç kësaj, qëllimi i këtij ligji është të përcaktohet procedura konform të cilës do të zbatohet transferimi dhe sipas së cilës të gjitha palët e interesuara do të informohen dhe do të mund ta japin mendimin e tyre në lidhje me transferimin. Sa i përket qëllimit të tij për transferim Transferuesi e njofton Komisionin e Letrave me Vlerë, organin administrues të shoqërisë, Bursën e autorizuar dhe Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndërsa qëllimin e publikon menjëherë pas njoftimit, përkatësisht pas dhënies së pëlqimit nga Komisioni i Letrave me Vlerë. Njoftohen edhe të punësuarit. Në ofertën përcaktohet edhe numri i aksioneve të cilat janë të nevojshme të blihen në mënyrë që të llogaritet se oferta për transferim është e suksesshme. Në afat prej 10 ditëve nga publikimi i ofertës për transferim, organi i administrimit të shoqërisë duhet të ofroj mendim në lidhje me ofertën për transferim. Në këtë mendim mund të përfshihen edhe qëndrimet e të punësuarve, nëse ekzistojnë të këllillë. Afati i vlefshmërisë së ofertës së transferimit është 60 ditë nga publikimi. Brenda këtyre 60 ditëve ka mundësi të ketë oferta konkurrenca nga më shumë ofertues. Suksesi ose mospuksesi i ofertë përcaktohet pas skadimit të afatit të vlefshmërisë së ofertës. Ligji e përcakton mënyrën dhe procedurën e kalimit të aksioneve të shitura tek Transferuesi. Komisioni i Letrave me Vlerë e kontrollon rrjedhën dhe zbatimin e procedurës së transferimit. Ligji nuk ka dispozita të veçanta për transferimin ndërkuftar, megjithatë, duke e pasur parasysh faktin se ofertues mund të jetë çdo person fizik ose juridik, vendor ose i huaj, të gjithë ata janë të barazuar me dispozitat e këtij ligji që të marrin pjesë të barabartë në procesin e transferimit të shoqërive.

<sup>5</sup>Për dallim nga legjislacioni paraprak, me Ligjin për falimentim nga viti 2006 i miratuar në Republikën e Maqedonisë, falimentimi ndërkombëtar ligjvënës i ka përkushtuar vëmendje më të madhe dhe janë përcaktuar më shumë dispozita me të cilat në mënyrë të detajuar trajtohet kjo procedurë në krahasim me legjislacionin e deriatëherëshëm, ndërkra q nën ndikimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian, si dhe të UNCITRAL (United Nations Commission on International Trade Law), model i ligjit për insolvencën ndërkuftare. Së këtejmi, qëllimi i këtij modeli të ligjit i cili i lë hapësirë shtetit tërësisht ta transponojnë ose të ndryshojnë ndonjë dispozitë nuk është ta harmonizojë të drejtën e falimentimit të shteteve. Qëllimi është shumë më i kufizuar dhe më i fokusuar, para së gjithash në drejtim të stimulimit të bashkëpunimit midis gjykatave dhe organeve të tjera të shteteve në rastin e falimentimit ndërkuftar, realizimi i sigurisë më të madhe juridike për tregti dhe investime, administrimi i ndershëm dhe efikas në rastin e falimentimit ndërkuftar, si dhe mbrojtja e interesave të të gjithë kreditorëve dhe personave të tjerë të interesuar, duke e përfshirë edhe debitorin, mbrojtjen dhe maksimizimin e vlerës së pronës së debitorit, si dhe lehtësimi dhe shpëtimi i shoqërive problematike financiare me mbrojtjen e investimeve dhe vendeve të punës.

<sup>6</sup>Në ndërtimin dhe zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare insolvente punuan më shumë institucione në mesin e të cilëve edhe Këshilli i Evropës në kuadër të të cilëve u miratua Konventa Evropiane për Aspektet e Caktuara Ndërkombëtare të Falimentimit nga data 09.06.1990. Këtë Konventë e nënshkroi Belgjika, Gjermania, Franca, Greqia, Italia, Luksemburgu dhe Qipro. Kjo Konventë u ratifikua vetëm nga Qipro dhe nuk ka hyrë në fuqi. Në vitin 1995, pesëmbëdhjetë vende-anëtare të BE e nënshkruan tekstin e Konventës Evropiane për Procedura Insolvente e cila asnjëherë nuk hyri në fuqi. Pastaj, Fondi Ndërkombëtar Monetar edhe atë Njësisë e tij juridike në vitin 1999 hartoi një dokument të quajtur Orderly and Effective Insolvency Procedures. Banka Botërore në vitin 2001 e hartoi Principles and Guidelines for Effective Insolvency and Creditor Right Systems i cili u dedikua vendeve në zhvillim si ndihmë gjatë përpillimit të legjislacionit të tyre të falimentimit dhe sistemit bankar. Në vitin 2005 u hartua drafti i reviduar. Në vitin 1988 seksioni për të drejtën ekonomike pranë Shoqatës Ndërkombëtare të Avokatëve International Bar Association hartoi Model International Insolvency Cooperation Act (MIICA) shoqata e njëjtë e hartoi edhe Cross-Border Insolvency Concordat. American Law Institute në vitin 2000 e hartoi dokumentin Principles of Cooperation in Transnational Insolvency Cases Among the Members of the North American Free Trade Agreement. Ky dokument përmban rekomandime të cilat nuk janë detyrime për një bashkëpunim më të afërt të shteteve të NAFTA të cilat e përfaqësojnë SHBA, Kanadanë dhe Meksikonë në fushën e të drejtës ndërkombëtare të falimentimit.

Karakteristikë e të drejtës sonë insolvente është rregullimi i çështjes së njohjes së vendimit të huaj gjyqësor.<sup>8</sup> Në Ligjin për falimentim, dispozita e cila e rregullon njohjen e vendimit gjyqësor të huaj e vë në dukje zbatimin e rregullave të përgjithshme të së drejtës në Republikën e Maqedonisë të cilat kanë të bëjnë me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore. Kjo çështje është rregulluar me Ligjin për të drejtën ndërkombëtare private.<sup>9</sup> Vendimi i huaj gjyqësor barazohet me vendimin e gjykatës së Republikës së Maqedonisë dhe prodhon veprim juridik në Republikën e Maqedonisë vetëm nëse e aprovon gjykata e Republikës së Maqedonisë.<sup>10</sup>

Gjyqtari i falimentimit është ai i cili duhet të vendos për aprovimin e vendimit të huaj gjyqësor, si dhe për hapjen e procedurës së falimentimit, ndërsa gjykatat kompetente të cilat duhet të vendosin për propozimin e paraqitur për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor në bazë të të cilit ndaj debitorit të falimentimit jashtë vendit është hapur procedurë falimentimi, janë gjykatat me kompetencë të zgjeruar. Propozim për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj, përkatësisht vendim nga një organ tjetër kompetent për hapjen e procedurës së falimentimit mund të paraqesë drejtori i huaj i falimentimit dhe kreditorët e debitorit të falimentimit.<sup>11</sup> Nëse njihet aktvendimi për hapjen e procedurës së falimentimit atëherë konsiderohet se është hapur procedurë falimentimi mbi pronën e debitorit të falimentimit në Republikën e Maqedonisë.

### Sa i përket ekzekutimit të aktgjykimeve të huaja në Republikën e Maqedonisë në kontestet civile dhe kontestet tregtare, fillimisht nevojitet ato ta kalojnë fazën e njohjes sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin

<sup>7</sup>Përndryshe, historiku i procedurës së falimentimit me elementë të huaj fillon me atë që një numër i caktuar i shteteve e kanë pranuar parimim e territorialitetit. Sipas këtij parimi procedurës së falimentimit të hapur në një shtet tjetër nuk duhet t'i njihen pasojat juridike në shtete të tjera. Ky parim me vite të tëra ka funksionuar në skenën juridike, kështu që shumë shtete në legjislacionin e tyre të falimentimit fare nuk i kanë trajtuar dispozitat e falimentimit ndërkombëtar. Përveç tjerash duhet të theksohet se baza e nënkuptimit të së drejtës së këllillë të parimit të territorialitetit është në atë që vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit paraqet akt të sovranitetit të shtetit i cili e ka hapur procedurën e falimentimit dhe së këtejmi, pasojat juridike të atij vendimi nuk mund të vlejnjë jashtë kufijve të atij shteti. Mes tjerash, parimi i territorialitetit në vetvete e ndërthen edhe një dimension tjetër, i cili korrespondon me mbrojtjen e kreditorëve vendor nga mangësitë, përkatësisht të metat e procedurës së falimentimit e cila është hapur në një shtet të huaj. Deri në njohjen e vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit mund të vinte vetëm në kuadër të marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale ndërkombëtare vetëm nëse është garantuar njohja e ndërsjellë e procedurave të falimentimit midis shteteve anëtare të asaj marrëveshje.

<sup>8</sup>Në të drejtën ndërkombëtare insolvente ekzistojnë dy sisteme të njohjes së vendimeve të huaja për hapjen e procedurës së falimentimit. Njëri sistem parashikon njohje automatike (ex lege) të vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit. Ky sistem i njohjes është parashikuar me Rregulloren e Bashkimit Evropian. Sistemi i dytë i njohjes së vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit është përbushja e supozimeve të përcaktuara me ligj në mënyrë që të njihet vendimi i huaj për hapjen e procedurës së falimentimit, ndërsa të cilat shqyrtohen në procedurë të veçantë formale. Për këtë sistem është përcaktuar edhe e drejta maqedonase.

<sup>9</sup>Me vendim të huaj gjyqësor konsiderohet vendimi i gjykatës së një shteti të huaj. Përndryshe, objekt i njohjes mund të jetë jo vetëm vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit i miratuar nga një gjykatë e huaj por edhe vendimet të cilat janë miratuar në kuadër të procedurës së hapur të falimentimit, me qëllim që procedura e falimentimit të zbatohet dhe përfundohet. Një vendim i këllillë mund të jetë edhe vendimi i miratuar nga ana e gjykatës së huaj për shkarkimin e drejtorit të huaj të falimentimit, vendimi për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të bordit të kreditorëve, vendimi për miratimin e planit të propozuar për riorganizim dhe ngjashëm. Gjithashtu, objekt i njohjes mund të jenë edhe vendimet e miratuara jashtë procedurës së falimentimit, të cilat janë në korrelacion të ngushtë me procedurën e hapur të falimentimit dhe kanë të bëjnë me masën e falimentimit dhe përbushjen e kërkesave të kreditorëve. Kështu që objekt i njohjes mund të jenë vendimet e miratuara nga ana e gjykatës kontestimore me të cilin përcaktohet kërkesa e caktuar e kreditorit, vendimi i gjykatës në lidhje me padinë e paraqitur për përgjeshtrimin e veprimeve juridike të debitorit të falimentimit si dhe vendimi i gjykatës kontestimore që ka të bëjë me ndonjë marrëveshje të lidhur para hapjes së procedurës së falimentimit.

Krahas vendimeve të cilat janë miratuar gjatë procedurës së hapur të falimentimit, objekt i përgjeshtrimit mund të jenë edhe vendimet e miratuara në procedurën paraprake në të cilat bëjnë pjesë vendimi për përcaktimin e masave të sigurimit.

<sup>10</sup>Procedura e njohjes së vendimit të huaj gjyqësor fillon me paraqitjen e propozimit. Gjykata me kompetencë territoriale e cila duhet të vendos për propozimin sa i përket njohjes së vendimit të huaj gjyqësor është gjykata në territorin e të cilës gjendet filiali i debitorit të falimentimit në Republikën e Maqedonisë. Në rast se debitorit i falimentimit nuk ka themeluar filial, kompetencë territoriale do të ketë gjykata në rajonin e të cilës gjendet prona ose një pjesë e pronës në pronësi të debitorit të falimentimit mbi të cilën kërkohet të hapet procedura e falimentimit.

Nëse debitorit i falimentimit ka më shumë filiale në territorin e gjykatave të ndryshme ose prona gjendet në territorin e më shumë gjykatave, kompetencë territoriale do të ketë gjykata të cilës fillimisht i është paraqitur propozimi për njohjen e vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit. Rregulli i tretë që ka të bëjë me përcaktimin e kompetencës territoriale të gjykatës e cila duhet të vendos për propozimin e paraqitur për njohjen e vendimit të huaj ka të bëjë me rastin kur prona përbëhet nga kërkesa. Në këtë rast gjykata me kompetencë territoriale që të vendos sipas propozimit për njohjen e vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit është gjykata në territorin e të cilës debitorët e falimentimit kanë seli të tyre, përkatësisht vendqëndrim.

Së këtejmi, vendimi gjyqësor i huaj nuk do të njihet nëse: vendimi i huaj gjyqësor nuk do të bashkëngjitet në original ose e kopje e vërtetuar bashkë me vërtetimin nga gjykata kompetente e huaj, përkatësisht nga një organ tjetër për plotfuqishmërinë e vendimit sipas së drejtës së shtetit në të cilin është miratuar; nëse nuk paraqitet përkrthim i vërtetuar të vendimit të huaj gjyqësor në gjuhën e cila është në përdorim zyrtar në atë gjykatë, nëse origjinali i vendimit të huaj gjyqësor ose kopja e tij e vërtetuar nuk janë përpiluar në gjuhën e cila është në përdorim zyrtar në atë gjykatë të e cila hapet procedura për njohjen e atij vendimi; nuk do të paraqitet edhe vërtetim për ekzekutim e vendimit sipas së drejtës së shtetit në të cilin është miratuar, nëse me kërkesën për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor kërkohet edhe njohja e aspektit ekzekutiv të tij, paraqitësi i kërkesës për njohjen e atij vendimi të huaj gjyqësor; nëse njëra nga palët dëshmon se për shkak të parregullshmërive të procedurës, nuk mund t'i shfaq instrumentet e veta të mbrojtjes; nëse njëra nga palët dëshmon se thirrja, padia ose aktvendimi me të cilin është hapur procedura nuk janë paraqitur në mënyrë të parashikuar me të drejtën e shtetit në të cilin është miratuar vendimi, përkatësisht fare nuk ka pasur përpjekje për dërgesën e këllillë, përveç nëse në ndonjë mënyrë është përfshirë në diskutimin për çështjen kryesore në procedurën e shkallës së parë; nëse në çështjen në fjalë ekziston kompetencë e jashtëzakonshme e gjykatës ose të organit tjetër në Republikën e Maqedonisë; nëse për çështjen e njëjtë gjykata ose ndonjë organ tjetër i Republikës së Maqedonisë ka miratuar vendim të plotfuqishëm ose nëse në Republikën e Maqedonisë është njohur ndonjë vendim tjetër i huaj gjyqësor që është miratuar në lidhje me çështjen e njëjtë; nëse veprimi i njohjes së tij është në kundërshtim me rendin publik të Republikës së Maqedonisë/Republic of Macedonia made a final decision or if in the Republic of Macedonia another foreign court decision concerning the same matter is recognized; if the action for its recognition is contrary to the public order of the Republic of Macedonia

për të drejtën ndërkombëtare private ose në përputhje me marrëveshjet për ndihmë juridike me shtetet me të cilat janë lidhur marrëveshjet në fjalë. Pas përfundimit të kësaj procedure gjyqësore të njëjtat mund të jenë objekt i ekzekutimit konform Ligjit për përmbarrim. Përndryshe, në këtë Ligj nuk janë përfshirë dispozita për ekzekutim ndërkufitar.

---

<sup>11</sup>Në mënyrë që gjykata kompetente të veprojë sipas propozimit të paraqitur për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor si ndaj një propozimi të rregullt bashkë me atë duhet të paraqiten edhe provat si vijojnë: vendimi i huaj gjyqësor në origjinal ose kopje e vërtetuar e vendimit me përkthimin në gjuhën maqedonase i vërtetuar nga përkthyesi i autorizuar; vërtetim nga gjykata e huaj kompetente përkatësisht e organit për aspektin e ekzekutimit të vendimit; regjistrim të pronës së njohur të debitorit të falimentimit në Republikën e Maqedonisë dhe regjistrim të kreditorëve të tij me prova përkatëse. Supozime të cilat në mënyrë kumulative duhet të plotësohen për njohjen e vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit janë: vendimi të jetë miratuar nga gjykata, përkatësisht organi, i cili sipas të drejtës së Republikës së Maqedonisë është kompetent për zgjidhjen e lëndëve me elemente ndërkombëtare; Me fjalë të tjera, nuk do të njihet vendimi i gjykatës së huaj në rast se ekziston kompetencë e jashtëzakonshme e gjykatës në Republikën e Maqedonisë. Vendimi të jetë i ekzekutueshëm sipas të drejtës së shtetit në të cilin është miratuar, madje edhe nëse nuk është i plotfuqishëm; njohja e vendimit të mos jetë në kundërshtim me rendin publik të Republikës së Maqedonisë; të ekzistoj ndërvarësi, përkatësisht reciprocitet.

# 4\* Pasqyrë e gjendjeve të përfshira me prioritetin e dytë të Strategjisë për EJL 2020 në dimensionin Drejtësi Bashkëpunimi gjyqësor lidhur me qasjen e lirë deri te informacionet, zbatimin e ekzekutimit ndërkufitar dhe procedurën ndërkufitare të falimentimit, transferimit dhe bashkimit

Në Republikën e Maqedonisë si palë drejtpërdrejtë të interesuara në prioritetin “Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor lidhur me qasjen e lirë deri te informacionet, zbatimin e procedurave ndërkufitare dhe procedurës ndërkufitare të falimentimit, transferimit dhe bashkimit” janë identifikuar: gjykatat themelore dhe të apelit, Regjistri Qendror i RM, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme, Komisioni i Letrave me Vlerë, Banka Popullore e RM, Dhoma e Avokatisë, si dhe dhomat e përmbauesve, noterëve, drejtorëve të falimentimit dhe dhomat ekonomike në Republikën e Maqedonisë.

Nga ana tjetër, për fat të keq, nuk ekzistojnë organizata qytetare të cilat në mënyrë të strukturuar e monitorojnë zbatimin në këtë fushë. Nuk konstatuam se ekziston qasje e strukturuar për monitorimin e indikatorit kryesor të cilin e vendos Strategjia e EJL 2020, ndërsa kjo ka të bëjë me rritjen e indikatorit të efektivitetit të Qeverisë, i cili rezulton nga Indekset e qeverisjes së Bankës Botërore (World Bank Governance Index). Sipas këtij indeksi, indeksi i qeverisjes së Republikës së Maqedonisë, si dhe i të gjitha vendeve të EJL, shënon rritje të butë thuaja se për çdo vit nga viti 2010 e këndej, megjithatë ky progres është mjaft i ngadalshëm dhe nuk ofron shumë optimizëm se do të arrihet qëllimi i dëshiruar prej 2,9 deri në vitin 2020.<sup>12</sup>

Aspekte të caktuara të kësaj fushe monitorohen në mënyrë sporadike, në mënyrë josistemike, vetëm nëse mbivendosen interesat e disa nga organizatat qytetare ose politike me ndonjë aktivitet të ndërlidhur me falimentimet ndërkombëtare, me transferimet dhe bashkimet ndërkombëtare. Së këtejmi, në Republikën e Maqedonisë, për shembull, janë vërejtur aktivitete të Organizatës së Konsumatorëve të Maqedonisë por edhe të Organizatës Politike “Levica”. Ata i monitorojnë dukuritë e aktiviteteve të këtyre ngjarjeve afariste ndërkombëtare dhe nëse paraqitet diçka që i prek interesat, synimet, parimet dhe qëndrimet për shkak të të cilave ata janë formuar, atëherë ata ndërmarrin aktivitete. Fitohet përshtypje se mbrojtja e interesave dhe të drejtave, gjatë zbatimit të aktiviteteve afariste dhe investuese, nuk realizohet në mënyrë përkatëse. Nga aspekti formal – juridik, zbatimi ndërkombëtar i falimentimeve, transferimeve dhe bashkimeve rregullohet me ligje përkatëse në Republikën e Maqedonisë, të cilët në nivel të konsiderueshëm janë harmonizuar me legjislacionin evropian. Por, në lidhje me atë se sa dhe si zbatohen ato nuk kemi analiza profesionale, kështu që njohuritë për të njëjtat bazohen mbi raste të veçanta të cilat u aktualizuan në publik.

Sa i përket bashkëpunimit gjyqësor lidhur me qasjen e lirë deri te informacionet për zbatimin e ekzekutimit ndërkufitar, zbatimin e procedurës së falimentimit me element të huaj dhe transferimet e

<sup>12</sup>Fluktacioni i indikatorit për Efektivitetin e qeverisë sipas World Bank Governance Index në shkallën prej 0-5

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	2.23	2.30	2.33	2.18	2.43	2.53
BeH	1.77	1.74	2.05	2.07	2.03	1.96
Kroacia	3.13	3.06	3.21	3.20	3.19	3.01
Kosova	1.89	2.00	2.12	2.10	2.18	2.08
MAQEDONIA	2.41	2.39	2.44	2.45	2.65	2.63
Mali i Zi	2.59	2.60	2.64	2.67	2.78	2.66
Serbia	2.45	2.40	2.39	2.41	2.59	2.61
MESATARJA E EJL	2.35	2.36	2.44	2.44	2.55	2.50



bashkimet të shoqërive tregtare është karakteristikë se bëhet fjalë për procedura të ndryshme të cilat gjykatat nuk i zbatojnë çdoherë.

Aktualisht, në Republikën e Maqedonisë nuk mund të sigurohet informacion zyrtar për zbatimin e ndonjë ekzekutimi ndërkufitar meqë bëhet fjalë për iniciimin dhe zbatimin e procedurës e cila bën pjesë në kuadër të së drejtës private. Aq më shumë që ekzekutimin e aktvendimeve të huaja gjyqësore e zbatojnë përmbaruesit të cilët janë persona që kryejnë autorizime publike të emëruar nga Ministria e Drejtësisë. Nëse ndonjë kreditor posedon vendim të një gjykate të huaj, ai mund të zbatohet në Republikën e Maqedonisë nëse vendimi i plotëson parakushtet për njohje të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. Sipas kësaj, burimi i vetëm i informacionit, në rast të ekzekutimit ndërkufitar në territorin e Republikës së Maqedonisë është Dhoma e Përmbaruesve e Republikës së Maqedonisë e cila do të duhej t'i ndjek rastet e këtilla, para së gjithash nga aspekti i efikasitetit të ekzekutimit dhe shpalljes publike të informacioneve. Nëse ndonjë subjekt juridik kërkon ekzekutimin e dokumentit ekzekutiv jashtë vendit, qasja deri te informacionet do të varet nga e drejta e shtetit në të cilin zbatohet ekzekutimi, ndërkaq si pasojë e sistemeve të ndryshme të ekzekutimit të cilat ekzistojnë në shtete të treta.<sup>13</sup>

Situata është pak më ndryshe me qasjen e lirë deri te informacionet dhe me bashkëpunimin gjyqësor për zbatimin e procedurës së falimentimit me elementë të huaj. Edhe në këtë rast, bëhet fjalë për zbatimin e procedurës në kuadër të të drejtës private, megjithatë procedura e falimentimit, veçanërisht procedurat sekondare, të cilat hapen në shtetet e huaja i zbaton gjykata në vendin ku gjendet prona dhe vendoset një lloj i caktuar i bashkëpunimit midis drejtorëve të falimentimit. Sipas rregullit, informacionet për këto konteste duhet të publikohen në ueb faqen e Regjistrat Qendror, gjykatës kompetente dhe në buletinin përkatës zyrtar të shtetit.

Republika e Maqedonisë ka nënshkruar disa marrëveshje me disa shtete, duke i ndjekur konventat evropiane nga fusha e ndihmës juridike ndërkombëtare kryesisht në materien penale, por edhe në lëndët civile, në mesin e të cilëve shumica janë vende të EJT: Shqipëria<sup>14</sup> Bosnja e Hercegovina,<sup>15</sup> Bullgaria,<sup>16</sup> Mali i Zi,<sup>17</sup> Kroacia,<sup>18</sup> Kosova,<sup>19</sup> Rumania,<sup>20</sup> Ukraina,<sup>21</sup> Sllovenia,<sup>22</sup> Serbia<sup>23</sup> dhe Turqia<sup>24</sup>.

Republika e Maqedonisë është nënshkruese e shumë konventave ndërkombëtare dhe dokumenteve të tjerë për të drejtat e njeriut në lidhje me liritë dhe të drejtat, por edhe për një sërë çështje të karakterit penal dhe civil. Pritet të fillojnë negociatat për firmosjen e marrëveshjeve për ndihmë juridike të përbashkët me Republikën Çeke, Republikën e Sllovakisë dhe Federatën Ruse.

Në Progres Raportin për Republikën e Maqedonisë të vitit 2016, është konstatuar se ekziston marrëveshja për bashkëpunim me Eurojust, por se në praktikë bashkëpunimi është në nivel të ulët.

Janë të pamjaftueshme informacionet për bashkëpunimin gjyqësor në Maqedoni me gjykatat e tjera të rajonit. Sa i përket legjislacionit i njëjti, në masë të madhe, ofron bazë për një trajtim të ndershëm dhe të drejtë të të gjithë pjesëmarrësve gjatë transferimit, bashkimit të firmave por edhe gjatë falimentimit dhe likuidimit. Për fat të keq, nuk ka shumë raste prej të cilave mund të nxjerrim konkluzione për atë se si zbatohen ligjet.

<sup>13</sup>Rregullorja (KE) nr. 44/2011 nga data 22 dhjetor të vitit 2000 për kompetencën gjyqësore, njohjen dhe ekzekutimin e aktgjykimeve për çështje të të drejtës civile dhe ndërkombëtare ("Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian nr. L 12 od 16.1.2001

<sup>14</sup>Marrëveshje midis qeverisë maqedonase dhe qeverisë shqiptare për ndihmë juridike në lëndët civile dhe penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.16/98); ka hyrë në fuqi 02. 10. 1998; Marrëveshja midis qeverisë maqedonase dhe midis qeverisë shqiptare për ekstradim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.16/98); ka hyrë në fuqi 02. 10. 1998; Marrëveshje midis qeverisë maqedonase dhe qeverisë shqiptare për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore për lëndët penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/98); ka hyrë në fuqi 02. 10. 1998

Në kuadër të Projektit, janë vendosur indikatorë sipas të cilëve mund të monitorohet zhvillimi i kësaj fushe (Aneksi 1). Në mënyrë që të fitohen të dhëna për këta indikatorë, janë paraqitur kërkesa për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik pranë Ministrisë së Drejtësisë. Këto informacione akoma nuk janë publikuar.

---

<sup>15</sup> Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Bosnjë e Hercegovinës për ndihmë juridike në lëndët civile dhe penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.10/06); ka hyrë në fuqi 06. 01. 2006; Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Bosnjë e Hercegovinës për ekstradim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.59/06); Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Bosnjë e Hercegovinës për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në materien penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.59/06)

<sup>16</sup> Marrëveshje për ndihmë juridike në lëndët civile midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Bullgarisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/02); ka hyrë në fuqi 07. 04. 2002

<sup>17</sup> Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Serbisë dhe Malit të Zi për ndihmë juridike në lëndët civile dhe penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.77/04); Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Malit të Zi për ekstradim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.40/2012); ka hyrë në fuqi 17.07.2012

<sup>18</sup> Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kroacisë për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në materien penale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/95); ka hyrë në fuqi 26. 05. 1995; Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kroacisë për ndihmë juridike në lëndët civile dhe penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.19/95); ka hyrë në fuqi 26.05. 1995; Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kroacisë për ekstradim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.57/2012); ka hyrë në fuqi 22.11.2012

<sup>19</sup> Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë juridike në lëndët penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.178/2011); ka hyrë në fuqi 24. 06. 2012; Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ekstradim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.178/2011); ka hyrë në fuqi 24. 06. 2012; Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për transferimin e personave të dënuar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.178/2011) ka hyrë në fuqi 24. 06. 2012

<sup>20</sup> Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Rumanisë për ndihmë të ndërsjellë juridike në lëndët civile ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.41/04) ka hyrë në fuqi 10. 03. 2007

<sup>21</sup> Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Ukrainës për ndihmë juridike në lëndët civile ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.48/00) ka hyrë në fuqi 20.06.2003

<sup>22</sup> Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Sllovenisë në lëndët civile dhe penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.24/96); ka hyrë në fuqi 05. 09. 1997; Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Sllovenisë për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në lëndët penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.24/96); ka hyrë në fuqi 05. 09. 1997; Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Sllovenisë për ekstradim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.24/96); ka hyrë në fuqi 05. 09. 1997

<sup>23</sup> Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Sllovenisë për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në lëndët penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.24/96); ka hyrë në fuqi 05. 09. 1997; Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Serbisë për ndihmë juridike në lëndët civile dhe penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 15/13), ka hyrë në fuqi 05. 02. 2013; Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Serbisë për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në lëndët penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/13) ka hyrë në fuqi më datë 23.02.2013

<sup>24</sup> Marrëveshje për bashkëpunim juridik në lëndët civile dhe penale midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Turqisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/97), ka hyrë në fuqi 28. 07. 2000

## 5\* Ngjarjet më të rëndësishme në këtë fushë në disa muaj të kaluar

Në Republikën e Maqedonisë, kohëve të fundit, njihet vetëm një rast i procedurës së hapur të falimentimit mbi filialin e një kompanie të huaj të themeluar në Republikën e Maqedonisë, ndërsa bëhet fjalë për Kompaninë Alpine Bau GMBH nga Austria, e njohur në botë si korporatë ndërtimore e dyta për nga madhësia në Austri. Me fjalë të tjera, më datë 19.06.2013 gjykata kompetente në Austri, sipas propozimit të paraqitur nga organet e administrimit të kompanisë, hapi procedurë falimentimi. Si pasojë e procedurës së falimentimit të hapur në Austri, drejtori i falimentimit të Alpine Bau GMBH kërkoi të hapet procedurë falimentimi sipas legjislacionit në Republikën e Maqedonisë. Sipas propozimit të drejtorit të huaj të falimentimit, fillimisht është miratuar vendimi i huaj për hapjen e procedurës së falimentimit, ndërsa pastaj u hap procedura e falimentimit ndaj filialit të kompanisë Alpine GMBH në Republikën e Maqedonisë.<sup>25</sup>

Duke filluar nga muaji qershor i vitit 2016 u aktualizua rasti i tentativës për transferimin e SHA Makpetroll nga ana e Balkan Petroleum Holding Limited – Kompani qipriote e cila përmes një konkursi në media e shpalli qëllimin për transferimin e Makpetrollit. Mediat, në mënyrë aktive, i ndiqnin ndodhitë në lidhje me këtë gjendje dhe raportuan se kompania është themeluar para jo më shumë se 12 ditë në Londër, me seli në Qipro. Mes tjerash, u raportua se ajo ka dy të punësuar dhe është themeluar me kapital themeltar prej 1.000 (një mijë) euro. Sa u përket aksioneve të Makpetrollit, të cilat në bursë shiten me çmim prej 17.000 denarë, kompania ofroi 25.908 denarë. Bordi drejtues i Makpetrollit e shqyrtoi shkresën e Balkan Petroleum Limited dhe vendosi se për të njëjtën nuk mund të veprohet. Qëndrim të ngjashëm kishte edhe Bursa Maqedonase, të cilët theksojnë se edhe tek ata është dërguar shkresë me përmbajtje të njëjtë. Shkresës së Balkan Petroleum nuk i është bashkëngjitur autorizimi përkatës në bazë të të cilit do të konstatohet legjitimiteti i personit të autorizuar që të paraqitet në emër të shoqërisë, dhe për këtë shkak Bursa Maqedonase nuk e shqyrtoi këtë lëndë. Përndryshe, vlera kontabël e një aksioni të SHA Makpetroll është 30.250 denarë. Sipas çmimit të ofruar prej 25.908 denarë, kjo do të thotë se “Balkan Petroleum” duhet të sigurojë garanci prej rreth 47 milionë euro.

Gjatë muajit shtator vazhdoi interesimi i publikut për transferimin e mundshëm të “Makpetroll” SHA Shkup nga ana nga “Balkan Petroleum Holding Limited”. Komisioni për letra me vlerë i Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e 98 të mbajtur më datë 19 shtator të vitit 2016, miratoi Konkluzion për ndërprerjen e procedurës së ngritur sipas kërkesës për lëshimin e lejes për ofertën e transferimit të “Makpetroll” SHA Shkup të paraqitur nga “Balkan Petroleum Holding Limited”. Siç njoftoi Komisioni, procedura është ndërprerë për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake tek një organ tjetër kompetent shtetëror, dhe pas kësaj procedura do të vazhdoj.

Më datë 3 tetor të vitit 2016 partia politike “Levica” organizoi pres konferencë në lidhje me funksionimin e BEG, operatori për ngrohje termike në Republikën e Maqedonisë. “Levica” bën përpjekje që ta zbuloj strukturën pronësore të BEG si një faktor i cili në mënyrë plotësuese e rëndon faktin, sipas tyre, të abuzimit të padrejtë të një numri të madh të konsumatorëve të BEG.

Ky është edhe një shembull i monitorimit të sjelljes së një shoqërie e cila është formuar në Maqedoni si rezultat i transaksionit afarist ndërkufitar. Ashtu siç është konstatuar edhe deri më tani, monitorimi është në kontekst të mbrojtjes së interesave specifike të një grupi të caktuar të palëve të interesuara, në këtë rast të konsumatorëve të Shoqërisë.<sup>26</sup>

<sup>25</sup> Si shkak për hapjen e procedurës së falimentimit theksohet ekspansioni i shpejtë në vendet e Ballkanit, Gjermani dhe Poloni. Në shtet kjo kompani, përmes filialeve ka pasur nja dhjetë projekte në vlerë prej mbi 30 milion euro.

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, më datë 24 dhe 25 nëntor të viti 2016, bashkë me Fondin e Hapur Rajonal për Evropën Juglindore – reforma juridike (GIZ) organizoi konferencë rajonale në temë: “Përforcimi i bashkëpunimit midis institucioneve të jurisprudencës nga vendet e Ballkanit Perëndimor”. Qëllimi i kësaj konference rajonale është t’i bashkojnë drejtorët e institucioneve për trajnimin e jurisprudencës nga Ballkani Perëndimor dhe përmes prezantimeve të të arriturave të shkëmbehen ide për përforcimin e mëturjes të bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve.

Më datë 15.11.2016, në kuadër të Projektit IPA 2010 për mbështetjen e mëturjes të gjyqësorit të pavarur, të përgjegjshëm, profesional dhe efikas dhe avancimin e shërbimit të provës dhe të masave alternative, në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë u organizua prezantim dhe tryezë e rumbullakët me temën: “Si të shndërrohen të dhënat në njohuri të aplikueshme dhe efektive.”<sup>27</sup> U konstatua se për shkak të implementimit të suksesshëm të mënyrave të prezantuara të matjes së rezultateve në drejtim të monitorimit të performancave gjyqësore dhe përmirësimit të tyre nevojitet sistemi i AKMIS (sistem i automatizuar për trajtimin e lëndëve në gjykata) në Republikën e Maqedonisë të mbindërtohet me aplikacione përkatëse softuerike.

Në organizim të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev”, ndërsa në bashkëpunim me Fondin e Hapur Rajonal për Evropën Juglindore – reforma juridike (GIZ) Shkup, më datë 24 nëntor të vitit 2016 u organizua konferencë dyditore rajonale “Përforcimi i bashkëpunimit midis institucioneve të jurisprudencës nga vendet e Ballkanit Perëndimor”, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe përmirësimit të efikasitetit dhe cilësisë së trajnimeve. Në këtë konferencë u mbajt edhe takimi i Këshillit Rajonal për Bashkëpunim. Në konferencë morën pjesë tetë drejtorë të akademive të jurisprudencës nga Evropa Juglindore dhe Turqia, përfaqësues nga Akademia për të Drejtën Evropiane (EPA) dhe nga Programi HELP pranë Këshillit të Evropës dhe Sekretari i Përgjithshëm i Rrjetit Evropian për Trajnime të Jurisprudencës (EJTH).

Kjo ishte konferenca e 18 rajonale e Akademisë, përndryshe deri më tani Akademia ka përfunduar 64 projekte me ambasada dhe organizata të huaja në të cilat kanë marrë pjesë mbi 660 ligjërues.

Më datë 28 nëntor të vitit 2016 u organizua debat për politikën publike të bashkëpunimit gjyqësor për qasjen e lirë deri te informacionet, ekzekutimin ndërkufitar dhe procedurat ndërkufitare të falimentimit, transferimit dhe bashkimit. Konstatimi kryesor nga analizat, sa u përket gjendjeve të bashkëpunimit gjyqësor për qasjen e lirë deri te informacionet, ekzekutimin ndërkufitar dhe për procedurat ndërkufitare të falimentimit, transferimit dhe bashkimit, është se ka pak informacione, të njëjtat nuk janë të strukturuar tek një bartës i informacioneve dhe nuk ka mënyrë të strukturuar të monitorimit të tyre. Këto raste, të cilat janë paraqitur në mënyrë incidentale dhe janë trajtuar në këtë Raport, vetëm konfirmojnë se shfaqja e tyre është ndjekur pa ndonjë interesim të madh dhe vetëm nga ndonjë aspekt specifik, dhe jo nga aspekti i asaj se këto raste janë shprehje të qeverisjes së mirë për rritje ose sigurojnë qeverisje të mirë për rritje.

Gjithashtu, u diskutua se bashkëpunimi ndërkombëtar më së miri realizohet kur aktivitetet përcaktohen me ligj dhe i njëjti parashikon mposhtjen e pengesave në mesin e të cilave edhe ato gjuhësore. U theksua rasti i Sllovenisë, ku lejohet përdorimi i gjuhës angleze në një pjesë bukur të madhe të komunikimit gjyqësor nëse ekziston nevoja. Bashkëpunimi në bazë ditore krijon situata për të cilat nuk mund të pritet çdoherë procedura e rregullt diplomatike dhe prandaj është mundësia e komunikimit në gjuhë të kuptueshme të përbashkët. Megjithatë, problemi është se shumë profesionistë në fushën e

<sup>26</sup> <http://www.brif.mk/parite-od-beg-odat-na-privatni-smetki-na-vmro-dpmne-vo-kipar-obvini-levitsa/>

<sup>27</sup> Prezantimi është mbajtur nga Adis Hoxhiq – ekspert i Projektit për përmirësimin e performancave gjyqësore në temat: grumbullimi burokratik i të dhënave, korniza normative, ndërtimi i kapaciteteve, monitorimi dhe evaluimi dhe përgjegjësia dhe veprimi. Është theksuar se çdo vend në fushën e gjyqësorit duhet të synojë ai të jetë objektiv, i pavarur, i paanshëm dhe kompetent dhe në mënyrë që të arrijë progres duhet t’i masë rezultatet, nga e cila do të rezultojë edhe nevoja që të ndërmerren masa përkatëse për arritjen e qëllimit. Në këtë drejtim janë prezantuar përvojat e shteteve evropiane Holandës dhe Austrisë. Në bazë të të dhënave të fituara nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë u hartua Raporti sipas indikatorëve “shkalla e zgjidhjes së lëndëve dhe kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve” në vitin 2013, 2014 dhe 2015.

jurisprudencës nuk e flasin anglishten. I këtillë është rasti me shumicën e drejtorëve të falimentimit.

Metoda e dytë e bashkëpunimit e rregulluar mirë janë marrëveshjet e nënshkuara për bashkëpunim midis dy shteteve ose në nivel ndërkombëtar. Shkëmbimi i informacioneve mund të bëhet përmes shumicës së regjistrave evropian të cilët janë formuar me më shumë dedikime. Për shembull, të këtillë janë regjistrat për bashkëngjitje dhe bashkim si dhe për transferim.

Numri më i madh i ligjeve në Republikën e Maqedonisë, të cilët e rregullojnë materien e bashkëpunimit ndërkombëtar, në esencën e tyre janë të mirë. Më së shpeshti problemet kanë të bëjnë me implementimin. Falimentimi nxitë interesim më të madh. Shkalla e kompensimit të kërkesave të falimentimit është e ulët, rreth 47,5%, ndërsa në vendet e OECD kjo përqindje është rreth 75%. Së këtejmi, bëhet fjalë për kërkesa të siguruara, ndërsa mbulimi i kërkesave të pasiguruara është akoma më i ulët. Ka baza të të dhënave të mangëta nga procedurat e falimentimit, e që e pamundëson analizën e mirë dhe ndryshimin eventual të disa elementeve të sistemit, me të cilët mund të përmirësohet efektiviteti i procedurave të falimentimit.

Fitimi i informacioneve cilësore nevojitet për biznesin e rajonit, ndërsa dhomat mund të jenë qendra të një numri të madh të informacioneve të këtilla. Ato hartojnë edhe studime të ndryshme, analiza, aktivitete B2B dhe anëtarëve të tyre mund t'ju sigurojnë informacione për çështje ndërkufitare dhe për partnerë potencial. Gjithashtu, ato kanë mundësi që anëtarëve të dhomave të huaja t'u ndihmojnë gjatë paraqitjes në tregjet vendorë dhe ato një gjë të këtillë e bëjnë brenda mundësive të tyre.

Në Ministrinë e Drejtësisë zhvillohet një projekt i ri për ndihmë juridike ndërkombëtare, për sigurimin e informacioneve të mira të proceseve ndërkombëtare, siç janë: koha e zhvillimit, sa kohë kanë zgjatur proceset dhe disa specifika të tyre. Përgatitet edhe softueri i cili do ta lehtësoj evidentimin dhe monitorimin. Ai duhet të fillojë në muajin maj të vitit 2017.

Bashkëpunimi në proceset gjyqësore lehtësohet me bashkëpunimin përmes marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale. Me të njëjtat përcaktohet se si njihen vendimet e huaja gjyqësore në të drejtën vendore. Me fjalë të tjera, shumë probleme me të cilat ballafaqohen subjektet lokale ose subjektet e huaja kur duhet të ekzekutojnë një vendim të huaj në një vend të tretë. Komunikimi rrjedh përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme, ndërsa në këtë drejtim ndihmë të madhe ofron Ministria e Drejtësisë.

Subjektet e ekzekutimit ndërkufitar, po ashtu, ishin objekt i diskutimit dhe interesimit. Një problem të veçantë gjatë ekzekutimit paraqet dërgesa e dokumenteve deri te qytetarët maqedonas të cilët kanë vendqëndrim jashtë vendit, për shkak të afateve të shkurtra të cilat janë përcaktuar në Ligjin për përmbarim. Në ato raste në të cilat ka marrëveshje ndërkombëtare bashkëpunimi mund të shkojë përmes gjykatave, ndërsa rezultatet janë shumë më të mira prej atyre vendeve në të cilat shfrytëzohen përfaqësitë konsullore. Ministria e Drejtësisë ofron ndihmë të shkëlqyeshme në rastet kur paraqiten probleme.

Bashkëpunimi bilateral dhe multilateral i shoqërive afariste, dhomave, organeve rregullatore (Komisioni për Letra me Vlerë përmes IOSCO) dhe asociacionet profesionale, (Dhoma e Përmbaruesve përmes Asociacionit Evropian dhe dhomave nga fqinjësia) Dhoma e Drejtorëve të Falimentimit përmes dhomave ndërkufitare po ashtu ndihmon për një shkëmbim më të thjeshtë të informacioneve dhe për realizimin më të lehtë të proceseve të bashkëngjitjes, bashkimit, transferimit, falimentimit dhe ekzekutimit.

Nga diskutimi rezultuan rekomandime të rëndësishme të cilat janë marrë parasysh gjatë formulimit të rekomandimeve të këtij dokumenti.

## 6) REKOMANDIME

Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor lidhur me qasjen e lirë deri te informacionet, zbatimin e ekzekutimit ndërkufitar dhe procedurën ndërkufitare të falimentimit, transferimit dhe bashkimit ka nevojë nga shumica e institucioneve në Republikën e Maqedonisë të vazhdojnë me aktivitetet e tyre në këtë fushë ose të ndërmarrin aktivitete të reja:

- Negocime të mëtutjeshme dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për bashkëpunimin gjyqësor, përkatësisht për ndihmën juridike ndërkombëtare si dhe të lidhen protokolle për bashkëpunim ndërkufitar midis institucioneve të instancave të njëjta;

- Të rishikohen procedurat që kanë të bëjnë me realizimin e ndihmës juridike ndërkombëtare, dhe në këtë drejtim të thjeshtëzohen instrumentet për bashkëpunim ndërkufitar; Njëherësh, të analizohet se a mundet gjuha angleze të përdoret gjatë ndihmës juridike ndërkombëtare;

- Të bëhet trajnim i rregullt i përfaqësuesve diplomatikë për një sërë çështje që kanë të bëjnë me ndihmën dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, si për shembull, dërgesa e dokumenteve, ndërsa në këtë drejtim të parashikohen protokolle në të cilët në mënyrë të saktë do të përpunohen veprimet e procedimit të institucioneve kompetente;

- Është i domosdoshëm aktiviteti më i madh i Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë në temat e bashkëpunimit në organet e jurisprudence për çështje civile dhe penale;

- Të inkorporohet trajnimi për kompjuter dhe gjuhë angleze si të detyrueshëm për gjyqtarët dhe nëpunësit gjyqësorë, si dhe kriteret për zgjedhjen e drejtorëve të falimentimit të jenë më të rrepta me insistimin e njohjes së kompjuterëve dhe gjuhës angleze;

- Nevojitet instalimi i softueri dhe bazës së të dhënave dhe i statistikës për monitorimin e rasteve të ndihmës juridike ndërkombëtare nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe/ose të Ministrisë së Punëve të Jashtme;

- Të vendosen kontakte institucionale me institucionet kompetente të BE të cilat e mbajnë regjistrin e insolvencës, bashkimit dhe transferimit me qëllim të shkëmbimit të informacioneve;

- Të mundësohet akses më i madh i informacioneve për rastet e ekzekutimit, falimentimit, bashkëngjijtes, bashkimit dhe transferimit;

- Të stimulohet bashkëpunimi ndërkufitar midis dhomave, me qëllim të shkëmbimit të informacioneve;

- Të sigurohen informacione edhe për realizimin e indikatorëve kualitativ për matjen e progresit;

- T'i përkushtohet vëmendje sigurisë juridike, duke i pasur parasysh ndryshimet e shpeshta ligjore, përkatësisht të stimulohet monitorimi dhe analiza e zgjidhjeve ligjore, me qëllim të detektimit të problemeve esenciale dhe evitimin e mangësive;

Nga ana tjetër, nevojitet të sensibilizohet edhe opinioni publik në lidhje me rëndësinë e kësaj materie si dhe të stimulohen shoqatat qytetare, fillimisht asociacionet afariste ta ndjekin aktivitetin e bashkëpunimit të organeve të jurisprudence, veçanërisht në fushën e çështjeve ekonomike, siç janë ekzekutimet, bashkimet, falimentimet dhe transferimet ndërkufitare.


## ANEKSI 1:

Indikatorë të përcaktuar për monitorimin e progresit në prioritetin: *Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor lidhur me qasjen e lirë deri te informacionet, zbatimin e procedurave ndërkufitare dhe të procedurës ndërkufitare të falimentimit, transferimit dhe bashkimit*

Indikator	Të dhëna	Metoda e grumbullimit të informacioneve	Rreziqet
Rritja e nivelit të indeksit të Efektivitetit të qeverisë deri në 2.9, në bazë të Indikatorëve të Bankës Botërore për qeverisje deri në vitin 2020.	Indikatorët e Bankës Botërore për qeverisje	Monitorimi i indikatorëve	Indeksi ndiqet një herë në vit
Numri i marrëveshjeve të lidhura bilaterale për bashkëpunim gjyqësor	Ministria e Drejtësisë	Pasqyra e informacioneve	Njoftimi i vonuar
Raste të veçanta të cilat japin indikacione për sjellje të mirë ose për sjellje jo aq të mirë të institucioneve gjatë procedurave të falimentimit, transferimit ose bashkimit ndërkombëtar	Portalet e informacioneve	Pasqyra e informacioneve	Burime jorelevante ose arbitrare
Qasja e informacioneve publike për çështjet nga kompetenca gjyqësore	Gjykatat dhe Ministria e Drejtësisë	Pasqyra e ueb faqeve, pyetësorëve të administratës gjyqësore	Mospasje qasje në informacionet relevante
Numri i personave të parashikuar dhe të punësuar në Sektorin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë dhe kompetenca e tyre	Ministria e Drejtësisë	Pasqyra e dokumentacionit	
Numri dhe lloji i lëndëve në të cilat është kërkuar nga RM bashkëpunim ndërkombëtar gjyqësor dhe lloji i përgjigjes	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme	Pasqyra e dokumentacionit	Publikimi i vonuar, mosekzistimi i të dhënave relevante

Indicator	Data	Data collection method	Risks
Kohëzgjatja mesatare e veprimit ndaj kërkesës nga organet e huaja	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme	Pasqyra e dokumentacionit	Publikimi i vonuar, mosekzistimi i të dhënave relevante
Number and type of cases for which the Republic of Macedonia asked for international judicial cooperation and type of reply	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme	Pasqyra e dokumentacionit	Publikimi i vonuar, mosekzistimi i të dhënave relevante
Kohëzgjatja mesatare e veprimit ndaj kërkesës nga RM	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme	Pasqyra e dokumentacionit	Publikimi i vonuar, mosekzistimi i të dhënave relevante
Numri i ekzekutimeve ndërkuftare, me ç'rast është kërkuar nga RM bashkëpunim ndërkombëtar gjyqësor dhe nëse i njëjti është ofruar	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme	Pasqyra e dokumentacionit	Publikimi i vonuar, mosekzistimi i të dhënave relevante
Numri i ekzekutimeve ndërkuftare, me ç'rast RM ka kërkuar bashkëpunim ndërkuftar gjyqësor dhe nëse i njëjti është ofruar	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme	Pasqyra e dokumentacionit	Publikimi i vonuar, mosekzistimi i të dhënave relevante
Numri i procedurave ndërkuftare të falimentimit, transferimit dhe bashkimit për të cilat nga RM është kërkuar bashkëpunim ndërkuftar gjyqësor dhe numri i lëndëve për të cilat është ofruar	Ministria e Drejtësisë, Regjistri Qendror, gjykatat	Pasqyra e dokumentacionit	Publikimi i vonuar, mosekzistimi i të dhënave relevante
Numri i procedurave ndërkuftare të falimentimit, transferimit dhe bashkimit për të cilat RM ka kërkuar bashkëpunim gjyqësor dhe numrin e lëndëve për të cilat është ofruar	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme	Pasqyra e dokumentacionit	Publikimi i vonuar, mosekzistimi i të dhënave relevante





Instituti  
për  
politikë  
evropiane.  
Shkup

Raporti tematik i Projektit  
„Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë (JUDGMeNT)“

# MBËSHTETJA E ZAK: PËRMIRËSIMI I KORNIZËS LIGJORE PËR ZGJIDHJEN ALTERNATIVE TË KONTESTEVE DHE MUNDËSIMI I BASHKËPUNIMIT JURIDIK E INSTITUCIONAL ME SISTEMIN GJYQËSOR DHE SISTEMIN E EKZEKUTIMIT

Shkup, Dhjetor 2016

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Pikëpamjet e shprehura ktu në asnjë mënyrë nuk pasqyrojnë mendimin zyrtar të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal.

Përmbajtje:

- 03.** 1.Shënime hyrëse
- 05.** 2.Subjekte të ZAK të përfshira me monitorimin
- 05.** 1.1.Ndërmjetësues të licencuar
- 09.** 1.2.Gjykatat në Republikën e Maqedonisë
- 12.** 1.3.Ministria e Drejtësisë
- 12.** 1.4. Këshilli për sigurimin, monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së punëve të ndërmjetësimit
- 13.** 1.5. Pajtuesit dhe arbitrat në kontestet e punës
- 14.** 1.6. Arbitra pranë trupit të përhershëm të zgjedhur gjykues – Arbitrazi pranë Dhomës
- 16.** KONKLuzion
- 19.** ANEKSI 1

Strategjia e EJM 2020 është përqendruar në 4 (katër) shtylla të zhvillimit të ndërlidhura midis tyre, prej të cilave **Qeverisja për rritje** ka tre dimensione: Shërbime efektive publike, Parandalimi i korrupsionit dhe Drejtësia. Në fushën e *Drejtësisë* janë identifikuar tre prioritete, në mesin e të cilëve edhe **“Mbështetja e ZAK: Përmirësimi i kornizës ligjore për zgjidhjen alternative të kontesteve dhe mundësimi i bashkëpunimit juridik dhe institucional me sistemin gjyqësor dhe sistemin e ekzekutimit”**.

Strategjia e EJM 2020 thekson se shkaqet fillestare të përdorimit të ZAK nga ana e bizneseve “të mençur” janë: të kursehet kohë dhe para, të mundësohen procese më të kënaqshme, t'u lejohet palëve që ata vet ta zgjidhin kontestin, të arrihen zgjidhje më të kënaqshme të kontesteve, të ruhen biznes relacionet e mira midis palëve, të shfrytëzohet profesionalizmi i ndërmjetësuesit dhe të ruhet besueshmëria. Edhe pse vendet e EJM e inkorporuan ZAK, megjithatë kërkesat për të njëjtin janë modeste. Të gjitha vendet e rajonit ballafaqohen me probleme të njëjta: shkallë e ulët e kërkesave për ZAK, kapacitete të dobëta institucionale për ndërmjetësim (qendra ndërmjetësimi), korniza rregullatore e cila në mënyrë të pamjaftueshme e stimulon ndërmjetësimin (ose pa sanksione efikase për braktisjen e idesë), lidhje të dobëta midis gjykatave dhe qendrave të ndërmjetësimit në aspektin e referimit, si dhe kërkesa jopërkatese për sistemin e qëndrueshëm të trajnimit midis ndërmjetësuesve, gjyqtarëve dhe juristëve.

Nuk kontestohet ndërlidhja e objektivave të këtij dimensionimi me Kapitujt negociues 23 dhe 24 dhe avancimi në këtë pjesë padyshim se do të merret parasysh gjatë vlerësimit të progresit të vendit në procesin e anëtarësimit në BE. Megjithatë, duhet të theksohet se bashkëpunimi ndërkufitar, përkatësisht rajonal, para së gjithash, është në interes të vendeve të rajonit në drejtim të krijimit të biznes klimës më të mirë, rritjes së vendeve të punës dhe përgjithësisht rritjes së prosperitetit të shoqërive tona.

Zbatimi i metodave të ZAK në Maqedoni, para së gjithash, ndërmjetësimi dhe arbitrazhi, përmes zbatimit të dispozitave të kornizës ligjore në fuqi, e cila e rregullon këtë materie, janë me rëndësi të jashtëzakonshme për instalimin e sistemit të qeverisjes së drejtësisë në të cilin ekziston e drejta e zgjedhjes së mënyrës së zgjidhjes së kontesteve. Pavarësisht nivelit të zbatimit të mënyrave alternative të zgjidhjes së kontesteve dhe nivelit të perceptimit të ndërmjetësimit dhe arbitrazhit në shtetin tonë është e domosdoshme të zbatohet monitorimi i punës së institucioneve dhe personave të cilët i trajtojnë dhe i mbështesin këto metoda për zgjidhjen e kontesteve, në mënyrë që të perceptohet gjendja momentale në këtë fushë.

Monitorimi në drejtim të promovimit dhe zhvillimit të ZAK, para së gjithash, e përfshin praktikimin e ndërmjetësimit nga ana e ndërmjetësuesve të licencuar, veprimin e gjykatave në pjesën e zbatimit të dispozitave të Ligjit për ndërmjetësim, Ligjit për procedurë kontestimore dhe Ligjit për marrëdhënie detyimore, veprimin e pajtuesve gjatë zgjidhjes së kontesteve të punës, veprimin e arbitrave në procedurat e arbitrazhit dhe në përgjithësi veprimin e të gjitha palëve të prekura të cilat kanë marrë pjesë në zgjidhjen e kontesteve përmes aplikimit të metodave alternative.

Rezultatet e fituara nga monitorimi i zbatuar kanë të bëjnë me periudhën kohore korrik – dhjetor 2016 me një vështrim të shkurtër dhe në korrelacion me përfitimet paraprakisht të fituara pozitive nga zbatimi i zgjidhjeve ligjore që kanë të bëjnë me ZAK.

Qëllimi i Monitorimit është përmes ndjekjes dhe vlerësimit të dinamikës, vëllimit dhe cilësisë së punës të të involvuarve me monitorimin, të vlerësohet gjendja e deritanishme lidhur me përfitimet e detektuar

dhe pozitive dhe aspektet negative në fushën e aplikimit të Mënyrave alternative të zgjidhjes së kontesteve, si dhe të mundësohet vendosja e bashkëpunimit më të mirë dhe më të suksesshëm institucional i të gjitha palëve të prekura në fushën e ZAK.

### 1.1.\* Ndërmjetësues të licencuar

Me miratimin e Ligjit të ri për ndërmjetësim dhe ndryshimet e plotësimet e tij<sup>1</sup> (në tekstin në vijim: LN) është parashikuar që procedura e ndërmjetësimit në RM të zbatohet ekskluzivisht nga ndërmjetësuesi i licencuar, person të cilit i është lëshuar licencë për ushtrimin e punëve të ndërmjetësimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë – Këshilli për Sigurimin, Monitorimin dhe Vlerësimin e Cilësisë së Punëve të Ndërmjetësimit.<sup>2</sup> Ndërmjetësuesi i zbaton procedurat për zgjidhjen e të gjitha llojeve të kontesteve ndërmjetësuese për të cilat palët e kundërshtuara, të cilat kanë kontest, kanë shprehur vullnet për qasje vullnetare dhe zgjidhje të kontestit përmes ndërmjetësimit.

Në organizim të Ministrisë së Drejtësisë, në fillim të vitit 2016, filluan të zbatohen sesionet e provimeve për dhënien e provimit për ndërmjetësues (gjithsej katër sesione të provimeve), si parakusht për fitimin e licencës për ndërmjetësues. Në Regjistrin e evidencës të procedurave për ndërmjetësim në Ministrinë e Drejtësisë janë regjistruar gjithsej 80 procedura të ndërmjetësimit (pas hyrjes në fuqi të Ligjit në vitin 2013). Gjithsej janë arritur 20 ujdë të ndërmjetësimit, përfundimisht me 29 nëntor të vitit 2016.

Në periudhën kohore, nga muaji mars deri në muajin korrik të vitit 2016, janë arritur vetëm 3 ujdë, ndërsa në periudhën, nga muaji korrik deri në muajin nëntor të vitit 2016, janë arritur 17 ujdë. Gjendja e këtyllë në mënyrë të qartë flet për rritjen e ujdive të arritura.

Sa u përket procedurave të regjistruara të ndërmjetësimit, dinamika është thuaja se e njëjtë. Në periudhën kohore mars-korrik janë regjistruar 41 procedura të ndërmjetësimit, ndërsa në periudhën kohore korrik-nëntor, 29 nëntor të vitit 2016 janë regjistruar edhe 39 procedura të ndërmjetësimit.

Në periudhën korrik-nëntor 2016 në rastet kur nuk është arritur ujdë për ndërmjetësim, procedura ka përfunduar me deklaratë të ndërmjetësuesit, konform LN, se procedura nuk e jep efektin e duhur për t'u zhvilluar më tutje.

Në periudhën kohore të zbatimit të monitorimit, gjithsej 10 kandidatë e kanë kaluar me sukses procedurën e licencimit, ndërsa 9 janë regjistruar në Listën e ndërmjetësuesve të licencuar e cila është shpallur publikisht në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë. Dy kandidatë të paraqitur në provim i kanë kaluar me sukses të tria pjesët, megjithatë u janë lëshuar vetëm vërtetime dhe jo licenca, për shkak të pamundësisë krahas veprimtarisë kryesore (noter dhe përmbaues) të ushtrojnë edhe veprimtari plotësuese si ndërmjetësues. Në sesionin e nëntorit deri te pjesa e tretë e provimit (intervista) procedurën e kanë kaluar 9 kandidatë.

<sup>1</sup>"Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 188/13, 148/15 dhe 55/16

<sup>2</sup>Ligji për ndërmjetësim ka për synim krijimin e parakushteve për funksionimin e suksesshëm të ndërmjetësimit me inkuorporimin e qasjeve, metodave dhe formave bashkëkohore, për zbatimin e tij të suksesshëm, si për shembull:

- Subvencionimi i ndërmjetësimit, në – katër orët e para të ndërmjetësimit krijohet një model i ri i ndërmjetësuesit,
- dhënia e provimit për ndërmjetësues (i cili përbëhet nga dy pjesë, pjesa teorike dhe studimi i rastit)
- inkuorporimi i testit psikologjik dhe testit të integritetit
- lëshimi i licencës për ndërmjetësues, me çka krijohet një profil i ri i ndërmjetësuesve,
- inkuorporimi i ndërmjetësimit të detyrueshëm në sfera të caktuara,
- sigurimi, monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së ndërmjetësimit është domosdoshmëri për zbatimin e suksesshëm dhe cilësor të konceptit të ndërmjetësimit në RM,
- miratimi i Programit për zhvillimin e ndërmjetësimit, në të cilin përcaktohen masat dhe mjetet me të cilat sigurohet mbështetja e ndërmjetësimit (programet e veçanta për mbështetjen e ndërmjetësimit i miraton Këshilli Gjyqësor dhe Gjykata Supreme e RM).

Secili person i interesuar i cili dëshiron të inicioj tek pala kundërshtare që kontesti të zgjidhet përmes aplikimit të ndërmjetësimit, si metodë e parashikuar të zgjidhjes alternative të kontesteve, ka mundësi të bëjë përzgjedhje nga nëntë ndërmjetësuesit e licencuar që të ndërmjetësoj në zgjidhjen e kontestit konkret. Çdo praktikim ndryshe i ndërmjetësimit, nga ana e personave të cilët nuk e kanë kaluar procedurën e licencimit dhe nuk posedojnë licencë, konsiderohet si i kundërligjshëm dhe i pavlefshëm, veçanërisht lidhur me zbatimin e ndërmjetësimit për të cilin është parashikuar përpjekje e detyrueshme konform nenit 461 të LPK.<sup>3</sup>

Në përputhje me zgjidhjet e parashikuara në LPK, gjyqtarët kompetentë të veprojnë në kontestet ekonomike, që nga pranimi i padisë duhet të vlerësojnë nëse procedua do të vazhdojë më tutje sipas Ligjit për procedurë kontestimore (nëse është parashtruar provë nga ndërmjetësuesi të licencuar se përpjekja për ndërmjetësim ka përfunduar pa sukses) ose padia do të hidhet poshtë si e palejueshme (nëse është bashkëngjitur provë e përpiluar nga ndërmjetësuesi i pa licencuar ose nga person tjetër ose nëse padisë nuk i është bashkëngjitur provë se është bërë përpjekje për zgjidhjen e kontestit përmes ndërmjetësimit).

Ndërmjetësuesit e licencuar janë persona me profile të ndryshme të profesioneve, megjithatë të gjithë me afinitete të cilat duhet t'i posedojë një ndërmjetësues, të dijë t'i shfrytëzojë aftësitë dhe teknikat gjatë ndërmjetësimit që në mënyrë të drejtë t'i orientoj palët e kontestit që të arrijnë ujdi të ndërsjellë. Së këtejmi, tre nga ndërmjetësuesit janë juristë të diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës, një ndërmjetësues është nga fusha e mbrojtjes, paqes dhe sigurisë, pastaj në listë janë edhe ndërmjetësues sociologë, një ndërmjetësues është asistent në Fakultetin Juridik në Shkup, një ndërmjetësues është inxhinier i informatikës, dy ndërmjetësues janë ekonomistë.

Nga gjithsej nëntë ndërmjetësuesit e licencuar të listës së ndërmjetësuesve në anketën e zbatuar për mënyrën se si ndërmjetësuesit e zbatojnë procedurën dhe se cilat janë rezultatet fillestare të punës së tyre fill pas licencimit, tre nga ndërmjetësuesit nuk morën pjesë pa dhënë ndonjë arsye të qëndrueshme për mostransparencën e tyre gjatë anketimit.

Nga përgjigjet e fituara të ndërmjetësuesve të anketuar këndshëm befason fakti se rezultate pozitive gjatë punës ka që në muajt e parë të aktivitetit të tyre. Kjo nënkupton se, përgjithësisht në shtet, ndryshon perceptimi për ndërmjetësim jo vetëm për shkak të inkorporimit të detyrimit për përpjekje të ndërmjetësimit në kontestet ekonomike sipas nenit 461 të LPK, por edhe për shkak të faktit që ekziston interesimi për ndërmjetësim i cili bazohet kryesisht mbi parimin e vullnetarizimit, Me fjalë të tjera, palët e kanë marrë guximin, në vend që t'i drejtohen gjykatës, të kërkojnë opsion për zgjidhjen e kontestit me ndërmjetësimin e ndërmjetësuesit, kështu që tanimë janë regjistruar rastet e para të ujdive të arritura të ndërmjetësuesve të licencuar sipas dispozitave të Ligjit të ri për ndërmjetësim, përveç kontesteve midis personave juridikë, edhe në konteste në të cilat të dyja palët pjesëmarrëse janë ose persona fizikë ose preson fizik dhe juridik.

Numri i lëndëve të ndërmjetësimit në të cilat ndërmjetësuesit e anketuar kanë vepruar sipas nenit 461 të LPK (ku është parashikuar përpjekja e detyrueshme për ndërmjetësim) tanimë është mbi 80. Ky numër i lëndëve rezulton nga të dhënat e gjashtë regjistrave të ndërmjetësuesve të anketuar të cilët i mbajnë për shkak të evidencës personale të punës së tyre. Megjithatë, numri i lëndëve të paraqitura dhe të regjistruara në Regjistrin e evidencës së procedurave të ndërmjetësimit të cilin e mban Ministria e Drejtësisë nuk përputhet me numrin e lëndëve të regjistruara në regjistrat e veçantë të ndërmjetësuesve

<sup>3</sup>Neni 461 i LPK parashikon: "Në kontestet ekonomike për kërkesa monetare, vlera e të cilave nuk i tejkalon 1.000.000 denarë, ndërsa sipas të cilave procedura hapet me padi para gjykatës, palët e kanë për detyrë, para se ta paraqesin padinë, të përpiqen që kontestin ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit. Gjatë paraqitjes së padisë, paditësi e ka për detyrë të bashkëngjis provë të lëshuar nga ndërmjetësuesi, se përpjekja për zgjidhjen e kontestit përmes ndërmjetësimit nuk ka pasur sukses. Padinë ndaj të cilës nuk është bashkëngjitur provë nga paragrafi (2) i këtij neni, gjykata do ta hedhë poshtë". Kjo dispozitë e LPK ka hyrë në fuqi në muajin shkurt të vitit 2016.

meqë ka mosharmonizim në pjesën e veprimit, përkatësisht numri i lëndëve të shënuara-regjistruara të ndërmjetësimit në Regjistrin e MD është shumë më i vogël nga lëndët realisht të përfunduara të ndërmjetësimit.

Së këtejmi, në dispozitën e nenit 21 paragrafin 2 të LN është përcaktuar se ndërmjetësuesi në Ministrinë e Drejtësisë e paraqet ujdinë e arritur të ndërmjetësimit për shkak të regjistrimit në regjistër, meqë nuk është përcaktuar detyrimi i paraqitjes së çdo lënde të ndërmjetësuesve edhe në Regjistrin të cilin e mban Ministria, pavarësisht se si ka përfunduar procedura tek ndërmjetësuesi i licencuar, disa nga ndërmjetësuesit e anketuar kanë deklaruar se i paraqesin vetëm ujdinë, disa të tjerë janë të mendimit se duhet të paraqiten të gjitha lëndët të cilat i kanë trajtuar, pa marrë parasysh rezultatet e ndërmjetësimit, ndërsa disa nga ndërmjetësuesit mendojnë se meqë nuk ka ardhur deri në ndërmjetësim aktiv dhe e njëjta ka përfunduar me përpjekje, paraqitja e lëndëve të këtyra në MD të bëhet në mënyrë periodike. Sa i përket kësaj çështjeje duhet të theksohet edhe ajo se në LN nuk është parashikuar afati i paraqitjes së lëndëve, përkatësisht të ujdive të arritura gjatë ndërmjetësimit, kështu që vijmë në situatë që të dhënat e shënuara në Regjistër, të cilin e mban MD, të mos korrespondojnë me numrin e vërtetë të lëndëve dhe të mos e pasqyrojnë gjendjen e vërtetë lidhur me praktikimin e ndërmjetësimit. Në mënyrë që të tejkalohet kjo gjendje duhet të intervenohet për ndryshimin e ligjit sa i përket detyrimit të paraqitjes së çdo lënde të shënuar të ndërmjetësimit pa marrë parasysh rezultatit e kontestit për shkak të inkorporimit të përpjekjes së detyrueshme të ndërmjetësimit në kontestet ekonomike.

Në punën disamujore të ndërmjetësuesve të licencuar të njëjtit u përballën me problemin e mungesës së Dhomës së Ndërmjetësuesve dhe me nevojën e konstituimit emergjent meqë Dhoma e vjetër e Ndërmjetësuesve, e cila akoma ka fuqi juridike, nuk është përfaqësuese dhe nuk i përfaqëson të drejtat dhe interesat e ndërmjetësuesve të licencuar. Në Dhomën e cila akoma ekziston janë anëtarë vetëm ndërmjetësues të cilët posedojnë certifikatë për trajnimin e kryer për ndërmjetësues, ndërsa nuk e kanë dhënë provimin për ndërmjetësues e që realisht krijon huti tek palët e interesuara për ndërmjetësim gjatë zgjedhjes së ndërmjetësuesit meqë nuk janë raste të izoluar kur angazhohen ndërmjetësuesit të cilët nuk posedojnë licencë, ndërsa kjo situatë, nga ana tjetër, shpie në pavlefshmërinë e çdo rezultati të ndërmjetësimit të zbatuar në këtë mënyrë nga ndërmjetësues të palicencuar në dëm të palëve pjesëmarrëse në ndërmjetësim.

Ky problem sensitiv dhe informatat jozyrtare të ndërmjetësuesve të licencuar, sa i përket praktikimit të licencimit në mënyrë të paligjshme, ishin shkaqe për adresimin e disa shkresave nga ana e tyre deri te Ministria e Drejtësisë dhe Këshillit për Ndërmjetësim me kërkesë që të tejkalohet tendenca e keqe e mos-organizimit dhe mos-transparencës. Veçanërisht duhet të merret parasysh fakti që licenca e fituar vlen 5 vjet, secili nga ndërmjetësuesit ka investuar mjete por edhe punë intelektuale që të punoj, ndërsa është pamundësuar të punoj për shkaqe të natyrës objektive dhe nuk varen nga vet ndërmjetësuesit, por nga kapaciteti dhe angazhimi i ministrisë kompetente e cila duhet t'i siguroj kushtet e nevojshme për punën e ndërmjetësuesve dhe për promovimin dinjitoz të ndërmjetësuesve të licencuar si kompetent të vetëm për zbatimin e procedurës së ndërmjetësimit.

Në kontekst të kësaj që u tha më lartë, konform dispozitave të LN, LPK dhe Plan Veprimit të Qeverisë së RM për zhvillimin dhe mbështetjen e ndërmjetësimit, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të RM deri te të gjitha gjykatat, përmes Këshillit përpiloi njoftime me shkrim me shënim se gjykatat e kanë për detyrë ta publikojnë në tabelën e shpalljeve të gjykatës Listën e ndërmjetësuesve të licencuar të cilët kanë legjitimitet të vetëm për ta zbatuar procedurën e ndërmjetësimit, me ç'rast i informojnë kryetarët e gjykatave themelore që të sigurojnë zyrë për ndërmjetësues, konform mundësive hapësimore të gjykatave, me qëllim që t'u mundësohet ndërmjetësuesve të licencuar kompetenca e të

cilëve është në gjithë territorin e shtetit të jenë më të aksesshëm për palët të cilat kanë nevojë për ndërmjetësim. Zyra të këtilla, plotësisht të përshtatura për nevojat e procedurës së ndërmjetësimit, tanimë janë në funksion të plotë në Gjykatën Themelore të Kavadarit, Gjykatën Themelore të Vinicës dhe Gjykatën Themelore Shkup 2 Shkup.

Gjatë muajit gusht është lëshuar në përdorim ueb faqe e re e Qendrës Maqedonase për Ndërmjetësim: [www.mcm.org.mk](http://www.mcm.org.mk) me qëllim të informimit në kohë për ndërmjetësimin dhe për aktivitetet e Qendrës. Qendra Maqedonase e Ndërmjetësimit është organizatë joqeveritare, qëllimi dhe misioni kryesor i së cilës është promovimi dhe praktikimi i ndërmjetësimit në Maqedonisë, sigurimi i informacioneve për palët e interesuara në procedurën e ndërmjetësimit, organizimi i trajnimeve dhe punëtorive për t'u njohur me procedurën e ndërmjetësimit dhe ngjashëm.

Sa u përket aktiviteteve të tjera gjatë muajve të kaluar, mund ta shënojmë pjesëmarrjen e disa ndërmjetësuesve të licencuar nga Maqedonia në Konferencën e Parë Ndërkombëtare të Ndërmjetësuesve nga Evropa Juglindore “Ndërmjetësimi dhe zhvillimi i komunikimit” që u mbajt më datë 22.10.2016 në Zagreb.<sup>4</sup> Në këtë Konferencë morën pjesë ndërmjetësues nga Kroacia, Republika e Maqedonisë, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia.<sup>5</sup> Pjesëmarrësit e Konferencës nga shtete të ndryshme arritën pajtim të ndërsjellë për formimin dhe regjistrimin e Shoqatës së Ndërmjetësuesve të Evropës Juglindore, selia e së cilës do të jetë në Zagreb, Republika e Kroacisë.

---

<sup>4</sup>[www.medijator.com](http://www.medijator.com)

<sup>5</sup><http://medijator.com/program-1-konferencije-medijatora-jie-zagreb-2016/>



## 1.2.\* Gjykatat në Republikën e Maqedonisë

Në pjesën e kompetencës së gjykatave themelore lidhur me praktikimin e ndërmjetësimit në kontestet civile dhe ekonomike, veprimi i gjyqtarëve është në kuadër të asaj që është përcaktuar në dispozitat e LPK dhe LMD.

Bashkëpunimi institucional i gjyqtarëve dhe ndërmjetësuesve është parashikuar me ligj dhe buron nga neni 272 të LPK.<sup>6</sup> Me fjalë të tjera, kur gjyqtari, pas shqyrtimit paraprak të padisë, do të vlerësoj se një kontest është i ndërmjetësueshëm hapet mundësia për praktikimin e ndërmjetësimit kur bëhet fjalë për ndërmjetësim të bazuar ekskluzivisht mbi parimin e vullnetarizmit. Në një rast të këtyre, gjykata deri te palët e kontestit, bashkë me thirrjen për seancën përgatitore e ka për detyrë t'u dërgojë sugjerim me shkrim për mundësinë e zgjidhjes së kontestit jashtë procedurës gjyqësore, përkatësisht me ndërmjetësimin e ndërmjetësuesit. Palët kanë të drejtë të prononcohen në lidhje me këtë sugjerim në seancën përgatitore në procesverbal para trupit gjykues ose me shpresë të shkruar, megjithatë nuk përjashtohet mundësia të kërkojnë të udhëzohen në ndërmjetësim edhe gjatë seancës kryesore.

Sistemi i monitorimit të lëndëve gjyqësore (sistemi AKMIS) akoma nuk është i përsosur deri në atë masë që përmes tij të sublimohen rezultatet e veprimit të gjyqtarëve kryesisht që ka të bëjë me zbatimin e dispozitave të LPK për ndërmjetësim dhe së këtejmi ekipi i ekspertëve zbatoi anketë për gjyqtarët e gjykatave themelore me kompetencë të zgjeruar dhe themelore të cilët veprojnë në materien civile dhe në lëndët ekonomike, në mënyrë që të fitohen të dhëna relevante dhe të sakta për gjendjen në këtë fushë.

Nga përgjigjet e fituara të gjyqtarëve të anketuar të cilët vullnetarisht morën pjesë në anketë, lirisht mund të konstatohet se gjyqtarët të cilët veprojnë në shkallë të parë në mënyrë konsekuente i zbatojnë dispozitat e LPK dhe rregullisht paditësit dhe të paditurit i dërgojnë njoftim me shkrim për ndërmjetësimin. Megjithatë, në pyetjen nëse palët janë të njoftuara për mundësinë se kontesti mund të zgjidhet përmes ndërmjetësimit, pjesa më e madhe e të anketuarve janë të mendimit se palët nuk janë të njoftuara për ndërmjetësimin si mundësi dhe nuk e dinë se e kanë të drejtën e zgjedhjes të mënyrës se si do ta zgjidhin kontestin në të cilin janë gjetur. Së këtejmi, në disa fletë-anketuese theksohet se palët nuk janë të njoftuara me këtë mundësi meqë gjatë inicimit të procedurës gjyqësore, përkatësisht me paraqitjen e padisë në një përqindje të madhe e shfrytëzojnë ndihmën juridike nga personi i autorizuar – avokati i cili shkresat e gjykatës i pranon në emër të tyre, kështu që mendojnë se avokatët nuk i informojnë dhe nuk i njoftojnë palët se e kanë të drejtën e zgjedhjes që kontestin ta zgjidhin në mënyrë alternative, ndërsa në seancën përgatitore përgjigjen në emër të tyre para gjykatës se pala nuk është e interesuar për ndërmjetësim, përkatësisht se pala dëshiron kontestin ta zgjidh në procedurë gjyqësore. Së këtejmi, nuk theksohet shkaku se kujt i referohet qëndrimi i gjyqtarëve, kështu që supozohet se mbase praktika e ka ndërtuar qëndrimin e tyre meqë në pyetjen: A ju ka ndodhur deri tani që palët të kërkojnë informacione apo sqarime për ndërmjetësim? Pjesa më e madhe e gjyqtarëve të anketuar deklaruan se shumë rrallë, palët, në mënyrë të drejtpërdrejtë u janë drejtuar atyre që të kërkojnë informacione për ndërmjetësimin.

<sup>6</sup>Neni 272 paragrafët 2, 3 dhe 4 të LPK përcaktojnë: "Gjykata e ka për detyrë në kontestet në të cilat lejohet ndërmjetësimi, bashkë me thirrjen për seancën përgatitore të paraqes njoftim me shkrim se kontesti mund të zgjidhet në procedurë ndërmjetësimi. Në thirrjen për seancën përgatitore palëve do t'u urdhërohet në seancë t'i paraqesin të gjitha shkresat të cilat u shërbejnë si provë, si dhe të gjitha lëndët të cilat duhet të shqyrtohen në gjykatë. Në thirrjen për seancën përgatitore gjykata do t'ua vë në dukje palëve pasojat e mosprezencës në seancën përgatitore, si dhe atë se e kanë për detyrë më së voni, në këtë seancë t'i prezantojnë faktet mbi të cilat bazohen pretendimet e tyre, t'i bashkëngjisin të gjitha provat me të cilat dëshirohen faktet, t'i bashkëngjisin të gjitha shkresat dhe sendet të cilat kanë për qëllim të ndërmarrin dhe përdorin si provë dhe të deklarohen se a dakordohen që kontestin ta zgjidhin në procedurë ndërmjetësimi."

Neni 273 i LPK përcakton: "Nëse palët janë dakord që kontestin ta zgjidhin përmes procedurës së ndërmjetësimit, gjykata do të miratojë aktvendim, në përputhje me nenin 200 paragrafin (1) pikën 6 të këtij Ligji dhe do ta ndërpres procedurën. Nëse palët nuk janë dakorduar që kontesti të zgjidhet në procedurë ndërmjetësimi, seanca përgatitore fillon me paraqitjen e padisë, ndërsa më pas i padituri e paraqet përgjigjen ndaj padisë."

Neni 200 paragrafi 1 pika 6 nga LPK parashikon: "Procedura ndërpritet kur të dyja palët do ta kërkojnë këtë me qëllim të zgjidhjes së kontestit përmes ndërmjetësimit ose në mënyrë tjetër."

Neni 203 paragrafi 3 i LPK parashikon: "Nëse gjykata e ka ndërprerë procedurën, në përputhje me nenin 200 pikën 6 të këtij Ligji, procedura do të vazhdojë me kërkesë të njërit palë ndërsa, nëse nuk ka kërkesë të këtyre, procedura do të vazhdojë pasi të kalojnë 45 ditë nga dita e ndërprerjes."

Nga ana tjetër, në disa fletë anketuese gjyqtarët nuk e theksojnë shkakun e mos njohjes së të drejtave të palëve, por drejtpërdrejt deklarojnë se duhet të gjendet mënyrë më e sigurt, në mënyrë që palët të informohen për metodat e zgjidhjes alternative të kontesteve dhe të kenë mundësi personalisht të prononcohen se a dëshirojnë ta zgjidhin kontestin përmes ndërmjetësimit para se të futen në procedurën gjyqësore.

Duke e pasur parasysh ndryshimin e LPK për dërgesën e njoftimeve me shkrim për ndërmjetësim deri te palët daton dhe zbatohet nga viti 2009, dhe që atëherë është shumë i vogël numri i lëndëve (sipas rezultateve të gjyqtarëve të anketuar) në të cilat është kërkuar të praktikohet ndërmjetësimi pas fillimit të procedurës gjyqësore, rezulton se inkorporimi i obligimit për dërgesën e detyrueshme të njoftimeve me shkrim deri te palët nga ana e gjykatës nuk i jep rezultatet e pritshme, bashkëpunimi institucional nuk është në nivelin e kënaqshëm ndërsa mendimi i shumicës së të anketuarve është se e mbështesin bashkëpunimin e këtyllë në zbatimin e së drejtës.

Si një shkak tjetër kryesor, përveç mos-vendosjes së linkut të drejtpërdrejt midis gjykatës dhe palëve në lidhje me njoftimet me shkrim të cilat gjykata e ka për detyrë t'i dërgojë, shumica e gjyqtarëve të anketuar janë të mendimit se ndërmjetësimi në shtetin tonë nuk është promovuar fare ose është promovuar shumë pak si opsion për zgjidhjen e kontesteve, ndërsa janë të mendimit se nevojitet promovim "aktiv" i ndërmjetësimit dhe mes tjerash theksuan se e mbështesin promovimin e ndërmjetësimit.

Nga ana tjetër, ia vlen të theksohet se gjyqtarët e anketuar kishin edhe mendim krejtësisht tjetër nga ajo që u theksua, përkatësisht deklaruan se nuk e mbështesin ndërmjetësimin dhe se gjyqtarët janë ata të cilët duhet t'i zgjidhin kontestet si mënyrë më e sigurt që të fitohet zgjidhje më e mirë e kontestit, përmes vendimit gjyqësor, me ç'rast kishte edhe deklarata nga lloji "pushteti gjyqësor është pushtet i veçantë dhe nuk i nevojitet bashkëpunim institucional për zbatimin e të drejtës përmes aplikimit të ZAK". Gjithashtu, kishte edhe deklarata të llojit se barazimi gjyqësor është zgjidhje për ujdin dhe se nuk ka nevojë për mbështetjen e ndërmjetësimit, ndërsa kjo flet për faktin se edhe pse Republika e Maqedonisë e ka implementuar Direktivën evropiane për ndërmjetësim në kontestet civile dhe ekonomike nga viti 2008 në legjislacionin kombëtar, mbështetja nga të involvuarit në këtë fushë në një pjesë është akoma vetëm deklarative. Pikërisht mos-transparenca e procedurës së ndërmjetësimit dhe mundësia e zgjidhjes së kontesteve në mënyrë më të shpejtë dhe jashtë procedurës së përcaktuar formale gjyqësore e dallon ndërmjetësimin nga procedura gjyqësore, përkatësisht ujdin e ndërmjetësimit nga barazia gjyqësore në gjykatë, kështu që në mënyrë të pabazuar identifikohet barazimi me ujdin në ndërmjetësim.

Në të vërtetë, qëllimi përfundimtar i ekzistimit të mundësisë që kontestet të zgjidhen përmes ndërmjetësimit është e drejta e inkorporuar e zgjedhjes së palëve se si t'i mbrojnë interesat e tyre, palët e kontestit të vendosin vet nëse kontestin do ta zgjidhin në procedurë gjyqësore ose në procedurë ndërmjetësimi. Nga ana tjetër, mundësia e gjyqtarëve që ta inkorporojnë ujdin ndërmjetësues në procesverbal si barazim gjyqësor deri më tani e ka shfrytëzuar vetëm një gjyqtar nga gjyqtarët e anketuar, i cili ka theksuar se nuk e ka aprovuar përmbajtjen e ujdisë dhe se nuk është përpiluar barazim gjyqësor në procesverbal, por në mungesë të shkaqeve të theksuara për rastin konkret, rezulton se kjo është një temë për diskutim tjetër.

Pikërisht gjendja e pasqyruar në këtë mënyrë, nga njëra anë, dhe rezultatet e manifestuara pozitive nga ana tjetër plotësisht e arsyetojnë inkorporimin e përpjekjes së detyrueshme gjatë zgjidhjes së kontesteve ekonomike deri në 1.000.000,00 denarë. Republika e Maqedonisë nuk është e vetme sa i përket kësaj zgjidhje ligjore duke e pasur parasysh se pas evaluimit të kryer fillestar mbi zbatimin e Direktivës së BE për ndërmjetësim në vitin 2013, në më shumë se 10 shtete anëtare të BE është

inkorporuar përpjekja e detyrueshme e ndërmjetësimit për një lloj të caktuar të kontesteve në drejtim të promovimit të drejtë dhe praktikimit të ndërmjetësimit, i cili madje në të kaluarën është konsideruar si zgjidhje futuristike, por tani është më se reale dhe zgjidhje adekuate për zgjidhjen e kontesteve i cili në mënyrë të vetme i avancon të drejtat demokratike të qytetarëve, pa e cenuar pavarësinë dhe mëvetësinë e gjyqësorit. Ekipi i ekspertëve mendon se është e domosdoshme nevoja e thellimit dhe intensifikimit të bashkëpunimit dhe koordinimit të gjykatave në raport me ndërmjetësimin..

Ekipi i ekspertëve është i mendimit se Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë është pasive lidhur me çështjen e organizimit të seminareve dhe punëtorive në temën ZAK, veçanërisht sa i përket ndërmjetësimit dhe arbitrazhit meqë gjatë kohës së përfshirë me monitorimin nuk është organizuar asnjë seminar në këtë teme, edhe pse mjaft aktuale, ndërkaq tanimë zbatohet ndryshimi i LPK-së në lidhje me inkorporimin e përpjekjes së detyrueshme. Deri më tani në organizim të Akademisë janë organizuar shumë pak seminare dhe ngjarje që përgjithësisht kanë të bëjnë me ZAK, ndërsa seminari i vetëm njëditor për ndërmjetësim u mbajt në prill të vitit 2016, megjithatë periodikisht në faqen e internetit të Akademisë publikohen tekste të ndërmjetësuesit të huaj Dilberto në gjuhën angleze pa sqarime nëse Akademia e mbështet atë që është deklaruar ose thjeshtë është e mendimit se mund të nxisë interesim tek vizitorët e faqes së internetit të Akademisë, si dhe tek ata që e njohin gjuhën angleze. Aktualisht asnjëri nga ndërmjetësuesit e licencuar ose personat të cilët kanë kryer trajnim për trajnues në fushën e ndërmjetësimit nuk është paraqitur si ligjërues në Akademinë për këtë fushë.

## 1.3.\* Ministria e Drejtësisë

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për ndërmjetësim, punët profesionale dhe administrative për nevojat e Këshillit i kryen Ministria e Drejtësisë. Në masë të konsiderueshme, suksesi dhe promovimi i mëtutjeshëm i ndërmjetësimit varet nga gatishmëria e Ministrisë së Drejtësisë që të jetë lehtësuese e mirëfilltë e Këshillit. Ministria e Drejtësisë është faktor institucional i cili duhet realisht dhe pa paragjykime ta perceptoj gjendjen aktuale të ndërmjetësimit dhe të vendos bazë reale për trajtimin dhe promovimin e ndërmjetësimit. Në praktikë, sa i përket ndërmjetësimit, Ministria vepron përmes Seksionit për ndërmjetësim, personit përgjegjës për veprim, sa i përket realizimit të provimit për ndërmjetësim dhe sekretarit i cili merr pjesë në punën e Këshillit.

## 1.4.\* Këshilli për sigurimin, monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së punëve të ndërmjetësimit

Më datë 12.09.2014 në Ministrinë e Drejtësisë së RM u mbajt takim konstituiv të dhjetë anëtarëve të Këshillit për Sigurimin, Monitorimin dhe Vlerësimin e Cilësisë së Punëve të Ndërmjetësimit, të emëruar nga Qeveria e RM. Këshilli që nga fillimi i përmbush plotësisht aktivitetet e parashikuara konform Plan Veprimit për implementimin e LN dhe vepron sipas dispozitave të të njëjtit, duke i përfshirë edhe aktet nënligjore dhe Rregulloren e punës së Këshillit.<sup>7</sup> Synimi kryesor i Këshillit është implementimi i LN.

Gjatë punës së vet të rregullt, Këshilli i verifikoi më shumë se 1720 pyetje të provimit dhe 53 studime të rastit të së drejtës dhe përfundimisht me sesionin e provimeve të qershorit lëshoi 10 licenca për ndërmjetësues të cilët plotësisht i plotësuan kushtet e përcaktuara në LN. Për fat të keq, që nga dita e parë e konstituimit, Këshilli ballafaqohet me parregullsinë e anëtarëve.

Për funksionimin pa pengesa dhe zhvillimin e ndërmjetësimit në Republikën e Maqedonisë edhe të ndërmjetësuesve, të cilët tanimë e posedojnë licencën e ndërmjetësuesit, nevojitet urgjentisht të formohet Dhoma e re e Ndërmjetësuesve. Puna e ndërmjetësuesve të licencuar është e rrezikuar dhe zhvillohet në kushte jashtëzakonisht të rënda për punë, duke i pasur parasysh reagimet e deritanishme verbale dhe të shkruara, ndërsa për shkak të mungesës së formës organizative, përmes së cilës do të prezantoheshin në sistemin e jurisprudencës së shtetit. Ajo që është akoma më simptomatike, funksionon edhe më tutje Dhoma e vjetër e Ndërmjetësuesve e cila duke i injoruar angazhimet dhe punën e ndërmjetësuesve të cilët e morën guximin dhe kaluan procedurën e licencimit, ndërmjetësuesve të licencuar nuk iu dërgon kurrfarë informatash në domenin e ndërmjetësimit, siç është organizimi i seminareve, punëtorive dhe ngjarjeve të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndërmjetësimin, meqë të njëjtëve nuk u dërgon ftesa, ndërsa të njëjtat ua dërgojnë personave ndërmjetësues të tjerë të cilët kanë kaluar vetëm trajnim, ndërkohë që nuk e kanë dhënë provimin për ndërmjetësues.

Formimi i Dhomës së Ndërmjetësuesve të licencuar duhet të ketë prioritet më të lartë, përmes caktimit dhe mbajtjes së mbledhjes konstituive për themelimin e Dhomës së Ndërmjetësuesve, me çka do të plotësohet vakumi juridik dhe funksionimi i Dhomës aktuale.

<sup>7</sup>Puna e Këshillit filloi të funksionojë në bazë të kornizës përkatëse juridike, mbi të cilën zbatohen aktivitetet e parashikuara konform Ligjit për ndërmjetësim: Ligji për ndërmjetësim ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 188/13), Plan Veprimi për implementimin e Ligjit për ndërmjetësim, Programi për dhënien e provimit për ndërmjetësues nr.09-2800/1 nga data 26.08.2014 i miratuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Konkluzioni i Qeverisë së RM nr. 42-744/1 nga data 10.02.2014 nga Mbledhja e njëqind e tetëdhjetë e shtatë e Qeverisë së RM e mbajtur më datë 10.02.2014.

## 1.5.\* Pajturesit dhe arbitrat në kontestet e punës

Pajtimi dhe arbitrazhi në kontestet e punës në Republikën e Maqedonisë është rregulluar me Ligjin për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës.<sup>8</sup> Ndryshimi kryesor i këtij Ligji është inkorporimi i mundësisë për zgjidhjen e kontesteve të punës përmes ndërmjetësimit. Së këtejmi, palët të cilat kanë kontest individual kanë në dispozicion dy mekanizma për zgjidhjen e kontestit, përmes ndërmjetësimit në përputhje me LN, ose përmes arbitrazhit në përputhje me Ligjin për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës. Punëtori mund të bëjë përpjekje që ta zgjidh kontestin përmes ndërmjetësimit, ndërkaq nëse kjo procedurë nuk ka sukses, atëherë e ka mundësinë që të bëjë përpjekje edhe me arbitrazhin. Duke e pasur parasysh faktin se vendimi në procedurën e arbitrazhit është përfundimtar dhe ekzekutiv, kështu që pas procedurës së arbitrazhit nuk ka mundësi që për kontestin e njëjtë të zhvilloj procedurë tjetër jashtëgjyqësore - ndërmjetësim apo procedurë gjyqësore.

Është me rëndësi të theksohet se me ndryshimet e Ligjit rregullohet dhe përcaktohet domethënia e nocionit arbitrazh dhe pajtim. Sipas kësaj, në ndryshimet përcaktohet se: *“Pajtimi është pjesëmarrja e personit të tretë neutral në ndërmjetësim midis dy palëve të kundërshtuara, me qëllim të arritjes së ujdisë për zgjidhje paqësore të kontestit kolektiv.”*<sup>9</sup> Ndërkaq, sa i përket arbitrazhit konsiderohet se: *“Arbitrazh është pjesëmarrje e palës së tretë të pavarur në zgjidhjen e kontestit individual, me qëllim të arritjes së zgjidhjes detyrimore të objektit të kontestit.”*<sup>10</sup> Në këtë mënyrë evitohet mundësia e konfuzionit me nocionin ndërmjetësim, i cili është rregulluar me Ligjin për ndërmjetësim.

Përndryshe, deri më tani janë trajnuar gjithsej më shumë se 90 persona, megjithatë dokumente për licencim dhe licencë posedojnë vetëm 41 pajtues dhe arbitra për konteste pune.

Në fushën e zgjidhjes paqësore të kontesteve të punës, gjatë muajit tetor të vitit 2016, u organizuan tri konferenca në Republikën e Maqedonisë, prej të cilave dy ndërkombëtare dhe një kombëtare. Me fjalë të tjera, në Ohër, nga data 18 deri më 19 tetor të vitit 2016 u mbajt Konferenca ndërkombëtare me titull: *“Konferencë Sub-rajonale e nivelit të lartë lidhur me mekanizmat efektivë për zgjidhjen e kontesteve të punës”*, në organizim të Organizatës Ndërkombëtare të Punës pranë KB, Projekt i financuar nga BE. Në këtë konferencë morën pjesë drejtorë, pajtues dhe arbitra nga Maqedonia, Bullgaria, Serbia, Mali i Zi, Republika Serbska, Kosova, Shqipëria dhe Hungaria. Mes tjerash, u konstatua se në Republikën e Maqedonisë janë licencuar 41 persona për arbitra dhe pajtues.

Më datë 19 tetor në vitin 2016, u mbajt Konferenca e parë kombëtare e arbitrave dhe pajtuesve për konteste pune në Republikën e Maqedonisë. Konferenca u organizua me këtë titull: *“Çështje aktuale nga fusha e pajtimit dhe arbitrazhit në Republikën e Maqedonisë”*.<sup>11</sup> Në konferencë u theksua nevoja e harmonizimit më të madh midis Ligjit për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës, Ligjit për ndërmjetësim në RM, si dhe të Ligjit për marrëdhënie pune.

Më datë 20.10.2016 në Ohër u organizua Konferencë ndërkombëtare me titull: *“Takimi i parë vjetor i Rrjetit Sub-Rajonal të agjencive për zgjidhjen miqësore të kontesteve të punës.”* Vëmendjeju përkushtua më shumë temave që kanë të bëjnë me kontestet e punës, ndërkaq u prezantua edhe një pasqyrë e kornizës së akteve normative rajonale për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës në rajon ose thënë më saktësisht në Maqedoni, Serbi, Republika Serbska, Mal të Zi dhe Bullgari. Në kuadër të kësajkonference u prezantua edhe sistemi i platformës virtuale “ESAP” që duhet të shërbej si bazë e të dhënave të rajonit lidhur me zgjidhjen e suksesshme të kontesteve të punës.

<sup>8</sup>Gazeta Zyrtare e RM nr. 87/07 nga data 12.07.2007. Ky Ligj është ndryshuar me Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës, “Gazeta Zyrtare e RM nr. 27 nga data 05.02.2014.

<sup>9</sup>Neni 3 paragrafi 1 i Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës, “Gazeta Zyrtare e RM nr.27 nga data 05.02.2014

<sup>10</sup>Neni 3 paragrafi 2 i Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës, “Gazeta Zyrtare e RM nr. 27 nga data 05.02.2014

<sup>11</sup>Raport i Asociacionit të Pajturesve dhe Arbitrave për Kontestet e Punës në Republikën e Maqedonisë

Të tri konferencat u mbuluan nga mediat, me informacione për ngjarjen, si dhe me transmetimin e intervistave të shkurtra të të pranishmëve nëpër televizione me koncesion kombëtar dhe në televizionin rajonal të Ohrit.

Gjatë muajit nëntor u përpilua ueb faqja e Asociacionit të Pajturesve dhe Arbitrave në Konteste Pune në Republikën e Maqedonisë. Domeni i këtij Asociacioni është [www.apars.mk](http://www.apars.mk), ndërsa në këtë ueb faqe janë prezantuar informacionet kryesore për të interesuarit në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënies kontestuese të punës përmes pajtimit ose arbitrazhit, si dhe informacione kryesore për APAKP, misionin dhe objektivat e organizatës.<sup>12</sup>

## 1.6.\* Arbitra pranë trupit të përhershëm të zgjedhur gjyqësor – Arbitrazhi pranë Dhomës

Nga aspekti i kornizës ligjore në Republikën e Maqedonisë, gjykata e përhershme e zgjedhur – arbitrazhi pranë Dhomës është rregulluar me Ligjin për dhomat ekonomike.<sup>13</sup> Është parashikuar që gjykata e përhershme e zgjedhur – arbitrazhi pranë dhomës, të formohet si organ i pavarur, i cili vendos përmes ndërmjetësimit ose përmes vendimmarrjes së kontesteve të ndërsjella afariste të cilat shfaqen midis anëtarëve të Dhomës dhe personave të tretë, si dhe midis personave të tjerë juridikë nga vendi dhe jashtë vendit, nëse palët pajtohen për kompetencën e këtij trupi gjyqësor të dhomës.

Vendimmarrja dhe rregullimi i kompetencës, si dhe përbërja dhe organizimi i trupit të përhershëm të zgjedhur gjyqësor, si dhe mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit të anëtarëve të tij dhe procedura e lëndëve për të cilat është kompetent përcaktohen me akt të cilin e miraton Asambleja e Dhomës.

Sa i përket statusit të vendimit të arbitrazhit, vendimet e këtij trupi gjyqësor të zgjedhur janë përfundimtare dhe e kanë fuqinë e aktgjykimit të plotfuqishëm. Kjo karakteristikë e vendimeve të trupit të përhershëm të zgjedhur gjyqësor – arbitrazhit pranë dhomës do të duhej t'i inkurajojë palët në konteste që të vendosin t'i qasen arbitrazhit duke e pasur parasysh se procedura është përfundimtare e cila shprehet përmes plotfuqishmërisë dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, për dallim nga procedura gjyqësore e cila zgjatë dukshëm më shumë deri në miratimin e aktgjykimit gjyqësor, i cili është i plotfuqishëm. Përveç kësaj, duhet të theksohet se palët duhet ta shfrytëzojnë këtë mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve të tyre për shkak të procedurës më të thjeshtë të arbitrazhit, për dallim nga procedura gjyqësore e cila është në disa shkallë.

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë dy trupa të përhershëm të zgjedhur gjyqësor – arbitrazhi pranë Dhomës edhe atë: Trupi i Përhershëm i Zgjedhur Gjyqësor – Arbitrazhi pranë Dhomës Ekonomike të Maqedonisë i formuar në vitin 1993 dhe Trupi i Përhershëm i Zgjedhur Gjyqësor – Arbitrazhi pranë Lidhjes së Dhomave Ekonomike të Republikës së Maqedonisë, i formuar në vitin 2015.

Të dyja dhomat ekonomike, në faqet e tyre të internetit, kanë publikuar informacione themelore për Trupin e Përhershëm të Zgjedhur Gjyqësor – Arbitrazhin pranë Dhomës. Dhoma Ekonomike e Republikës së Maqedonisë në ueb faqen e saj ka një banerë të veçantë të dedikuar për Trupin e Përhershëm Gjyqësor – Arbitrazhin pranë Dhomës.<sup>14</sup>

<sup>12</sup> [www.apars.mk](http://www.apars.mk)

<sup>13</sup> Ligji për dhoma ekonomike, "Gazeta Zyrtare e RM nr. 17 nga data 11.2.2011.

<http://arbitraza.mchamber.mk/> Këtu janë përmbledhur informacione në katër tema: informacione, kompetenca, organizimi dhe përparësitë. Në pjesën e organizimit nga e gjithë kryesia e këtij organi është përmendur vetëm emri i kryetarit dhe sekretarit të Trupit të Përhershëm Gjyqësor – Arbitrazhit pranë Dhomës. Në pjesën "përparësi" janë vendosur në formë elektronike disa akte edhe atë: Rregullorja për Trupin e Zgjedhur të Përhershëm Gjyqësor (Arbitrazhi), Rregullat për shpenzimet në procedurën para Arbitrazhit, Listat e arbitrave të Trupit të Përhershëm Gjyqësor – Arbitrazhit, si dhe marrëveshjet e lidhura për bashkëpunim me Arbitrazhin pranë dhomave në: Slloveni, Kroaci, Bullgari, Ukrainë, Federata Ruse, Serbia dhe Kosova.

Për arbitra në kontestet pa element ndërkombëtar të cilat zhvillohen para Trupit të Përhershëm të Zgjedhur Gjykses – Arbitrazhit pranë Dhomës Ekonomike të Maqedonisë, janë emëruar 27 arbitra.<sup>15</sup> Për arbitra në kontestet me element ndërkombëtar të cilat zhvillohen para Trupit të Përhershëm të Zgjedhur Gjykses – Arbitrazhit pranë Dhomës Ekonomike të Maqedonisë, janë emëruar 59 arbitra.<sup>16</sup>

Trupi i Përhershëm i Zgjedhur Gjykses – Arbitrazhi pranë Dhomës Ekonomike të Maqedonisë ka lidhur marrëveshje për bashkëpunim me arbitrazhet pranë dhomave të: Sllovenisë, Kroacisë, Bullgarisë, Ukrainës, Federatës Ruse, Serbisë dhe Kosovës.

Procedura para Trupit të Përhershëm të Zgjedhur Gjykses – Arbitrazhit pranë Dhomës Ekonomike të Maqedonisë është rregulluar me rregullore,<sup>17</sup> ndërkaq ky Arbitrazh ka lidhur më shumë marrëveshje për bashkëpunim me arbitrazhe të tjerë nga rajoni dhe më gjerë.<sup>18</sup>

Akte të tjera të Trupit të Përhershëm të Zgjedhur Gjykses – Arbitrazhit pranë Lidhjes së Dhomave Ekonomike të Republikës së Maqedonisë nuk janë të aksesshme në këtë ueb faqe, siç nuk është e aksesshme as lista e arbitrave, përveç emrave të katër arbitrave të cilët janë pjesë të kryesisë së këtij Trupi të Zgjedhur Gjykses – Arbitrazhit pranë Lidhjes së Dhomave Ekonomike të Republikës së Maqedonisë.

Në periudhën e hulumtimit, që është objekt i këtij Raporti, nuk është vërejtur organizimi i ndonjë seminari me temë: “Arbitrazhi” në organizim të të dyja dhomave të cilat posedojnë trup të përhershëm gjykses - Arbitrazh.

Gjatë analizës së periudhës, e cila është objekt i këtij Raporti, nuk është vërejtur ndonjë aktivitet në lidhje me arbitrazhin dhe as me punën e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

---

<sup>15</sup> Prej tyre, shkallë shkencore Doktor shkencash janë 13 arbitra, të zgjedhur në titull shkencor arsimor 12 arbitra, me shkallë shkencore Magjistër është 1 arbitër, punojnë si avokatë 9 arbitër si dhe si përbarues punon 1 arbitër. Shih: VENDIMI për verifikimin e Listave të arbitrave të Trupit të Përhershëm të Zgjedhur Gjykses – Arbitrazhi pranë Dhomës Ekonomike të Maqedonisë nga data 30.11.2011.

<sup>16</sup> Prej tyre, titull shkencor Doktor i shkencave kanë 45 arbitra, të zgjedhur në shkenca – titull arsimor janë 38 arbitra, ndërsa 8 arbitra punojnë si avokatë, dhe 1 arbitër është Akademik. Shih: VENDIMI për verifikimin e Listave të arbitrave të Trupit të Përhershëm të Zgjedhur Gjykses – Arbitrazhi pranë Dhomës Ekonomike të Maqedonisë nga data 30.11.2011

<sup>17</sup> Rregullorja e Trupit të Përhershëm të Zgjedhur Gjykses (Arbitrazhi), ndërsa shpenzimet e procedurës janë rregulluar me Rregullat për shpenzime në procesin para Arbitrazhit.

<sup>18</sup> Marrëveshja për bashkëpunim me Arbitrazhin e Sllovenisë më datë 16.09.1997; Marrëveshja për Bashkëpunim me Arbitrazhin e Kroacisë më datë 14.04.1997; Marrëveshja për Bashkëpunim me Arbitrazhin e Bullgarisë; Marrëveshja për Bashkëpunim me Arbitrazhin e Kosovës më datë 23.12.2003; Marrëveshja për Bashkëpunim me Arbitrazhin e Ukrainës, nuk është theksuar kur është lidhur; Marrëveshja për Bashkëpunim me Arbitrazhin e Federatës Ruse më datë 28.04.1999 dhe Marrëveshja për Bashkëpunim me Arbitrazhin e Serbisë më datë 15.11.1999.

# KONKLUZION

Si rezultat i hulumtimit të zbatuar të monitorimit dhe perceptimit të gjendjeve aktuale në fushën e ZAK, ekipi i ekspertëve i cili e trajtoi prioritetin e tretë, konsideron se që të praktikohet ndërmjetësimi dhe arbitrazhi në mënyrë adekuate dhe si alternativë e procedurës gjyqësore, duhet të ndërmerren disa hapa dhe masa të guximshme, si dhe realisht të sigurohet:

1.Promovim më i fuqishëm i ndërmjetësimit nga institucionet kompetente, me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit institucional me gjykatat në RM dhe me institucione të tjera shtetërore;

2.Këshilli Gjyqësor i RM dhe Gjykata Supreme e RM sa më shpejtë të miratojnë Programe për mbështetjen e ndërmjetësimit, njëkohësisht rekomandohet të ndryshohen kriteret dhe metodologjia e vlerësimit të cilësisë së gjyqtarëve, përkatësisht të gjyqtarëve të cilët me sukses e kanë promovuar ndërmjetësimin pas procedurës së hapur gjyqësore, të kenë nota më të larta për cilësinë e tyre;

3.Është e domosdoshme të ndryshohet korniza ligjore në drejtim të inkorporimit të përpjekjes së detyrueshme për zgjidhjen e të gjitha llojeve të kontesteve që janë përfshirë si të ndërmjetësueshme në Ligjin për ndërmjetësim;

4.Ndërmjetësimi si institut juridik detyrimisht duhet të përfshihet në të gjitha tekstet shkollore të shoqërisë qytetare që në arsimin fillor, si dhe në arsimin e mesëm, por edhe në tekstet në të cilat mësohet e drejta civile dhe penale në institucionet e arsimit të lartë;

5.Nga aspekti i punës së gjykatave dhe thellimit të bashkëpunimit institucional është e domosdoshme të përmirësohet, përsoset sistemi AKMIS nëpër gjykata, në mënyrë që të monitorohet praktikimi i ndërmjetësimit nga ana e gjyqtarëve;

6.Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë të angazhohet për organizimin e seminareve të përkushtuara për mësimin e ndërmjetësimit dhe arbitrazhit dhe thellimit të njohurive për këto lloje të ZAK, me ç'rast si target grupe të përfshihen gjyqtarët, prokurorët publikë, avokatët, shërbimi gjyqësorë, noterët dhe përmbaruesit;

7.Të organizohen seminare, trajnime dhe punëtori për metodat e ZAK me ndihmën dhe ndërmjetësimin e organizatave ndërkombëtare, të cilat financojnë ligjërata të kësaj natyre për të gjitha palët e interesuara, dhe para së gjithash për sektorin e biznesit, bankat dhe kompanitë e sigurimeve;

8.Shkëmbim të përvojave me shtete në të cilat me sukses implementohet dhe me sukses praktikohet ndërmjetësimi dhe arbitrazhi;

9.Ndryshimi i kornizës ligjore, e cila e rregullon fushën e të drejtës familjare me qëllim të inkorporimit të mundësisë së ndërmjetësimit në kontestet e divorcimit dhe në llojet e tjera të kontesteve familjare;

10.Ministria e Drejtësisë të impenjohet për promovimin aktiv, publik dhe transparent të ndërmjetësimit;

11.Konstituimi i Dhomës së Ndërmjetësuesve, e cila do t'i mbrojë interesat e ndërmjetësuesve të licencuar, ndërsa në vitet e para të konstituimit edhe nga aspekti financiar do ta mbështes në interes të promovimit të ndërmjetësimit;

12.Sa i përket procedurës së pajtimit dhe arbitrazhit në kontestet e punës duhet të bëhet promovim më i madh i kësaj forme përmes sindikatave në Republikën e Maqedonisë;



13. Të nënshkruhen memorandume bashkëpunimi midis Asociacionit të Pajturesve dhe Arbitrave për Konteste Pune në Republikën e Maqedonisë me të gjitha sindikatat në Republikën e Maqedonisë;

14. Të nënshkruhen memorandume për bashkëpunim midis Asociacionit të Pajturesve dhe Arbitrave për Konteste Pune në Republikën e Maqedonisë me Organizatën e Punëdhënësve të Republikës së Maqedonisë;

15. Të bëhen përpjekje për mbështetje logjistike nga ana e dhomave ekonomike dhe zyrave të tyre rajonale në Republikën e Maqedonisë për ndërmjetësuesit e licencuar, përmes mundësimit të shfrytëzimit të hapësirave përkatëse;

16. Të afirmohet mundësia dhe dobia e praktikimit të dispozitave të marrëveshjeve detyrimore për procedurën e ndërmjetësimit ose arbitrazhit;

17. Sa i përket Trupit të Përhershëm të Zgjedhur Gjykues – Arbitrazhit pranë Dhomës Ekonomike të Maqedonisë, të rishikohet mundësia për punën e personit i cili është zgjedhur për arbitër, ndërkaq njëkohësisht punon si përmbaues, në bazë të Ndalimit për ushtrimin veprimtarive dhe funksioneve të tjera në lidhje me nenin 39 të Ligjit për përmbaues;

18. Të mundësohet transparencë më e madhe lidhur me informacionet që kanë të bëjnë me Trupin e Përhershëm të Zgjedhur Gjykues – Arbitrazhin pranë Lidhjes së Dhomave Ekonomike të Republikës së Maqedonisë;

19. Të shqyrtohet mundësia e formave të kombinuara hibride të ndërmjetësimit – arbitrazhit, me qëllim që palëve t'u mundësohet përdorimi i kombinuar i të dyja procedurave në interes të zgjidhjes efikase, ekonomike dhe të shpejtë të kontestit në fjalë;

## ANEKSI 1:

: Përkufizimi i indikatorëve për monitorimin e progresit në prioritetin: “Mbështetja e ZAK: përmirësimi i kornizës ligjore për zgjidhjen alternative të kontesteve dhe mundësimin e bashkëpunimit juridik dhe institucional me sistemin gjyqësor dhe sistemin e ekzekutimit”

Indikatorë	Të dhëna	Metoda e grumbullimit të informacioneve
Numri dhe lloji i ujdive të regjistruara për ndërmjetësim	MD, Regjistri për evidentimin e procedurave të ndërmjetësimi	Grumbullimi i të dhënave nga MD dhe ndërmjetësuesit përmes telefonit, me shkresë dhe ngjashëm.
Numri i ndërmjetësimeve të përfunduara pa arritjen e ujdisë	Regjistri i MD dhe Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i të dhënave nga MD dhe ndërmjetësuesit përmes telefonit, me shkresë dhe ngjashëm.
Numri i procedurave të iniciuara për ndërmjetësim sipas paraqitjes së padisë para gjykatës	Sistemi AKMIS në gjyqësor, Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i të dhënave nga gjykatat me kompetencë të zgjeruar dhe nga ndërmjetësuesit e licencuar
Numri i procedurave të iniciuara për ndërmjetësim në procedurë gjyqësore gjatë seancës gjyqësore	Sistemi AKMIS në gjyqësor, Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i të dhënave nga gjykatat me kompetencë të zgjeruar dhe nga ndërmjetësuesit e licencuar
Numri i procedurave të iniciuara për ndërmjetësim në procedurë gjyqësore gjatë seancës	Sistemi AKMIS në gjyqësor, Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i të dhënave nga gjykatat me kompetencë të zgjeruar dhe nga ndërmjetësuesit e licencuar
Numri i procedurave të iniciuara për ndërmjetësim në përputhje me ndryshimet në LPK për përpjekje të detyrueshme të kontesteve ekonomike	Regjistri i MD, Sistemi AKMIS në gjyqësor, Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i të dhënave nga gjykatat me kompetencë të zgjeruar dhe nga ndërmjetësuesit e licencuar dhe nga MD
Numri dhe lloji i ndërmjetësimeve vullnetare sipas procedurës për ndërmjetësim përmes njoftimit me shkrim të gjykatës	Regjistri i MD, Sistemi AKMIS në gjyqësor, Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i të dhënave nga gjykatat me kompetencë të zgjeruar dhe nga ndërmjetësuesit e licencuar dhe nga MD

Indikatorë	Të dhëna	Metoda e grumbullimit të informacioneve
Numri dhe lloji i ndërmjetësimeve të iniciuara vullnetare para fillimit të procedurës gjyqësore (paraqitja e padisë)	Regjistri i MD, Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i informacioneve përmes telefonit ose me shkresë
Numri dhe lloji i procedurave të iniciuara për ndërmjetësim sipas njoftimit të gjyqtarit dhe inkorporimit në procesverbal të seancës përgatitore	Regjistri i MD, Sistemi AKMIS në gjyqësor, Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i të dhënave nga gjykatat me kompetencë të zgjeruar dhe nga ndërmjetësuesit e licencuar dhe nga MD
Numri dhe lloji i procedurave të iniciuara për ndërmjetësim sipas njoftimit të gjyqtarit dhe inkorporimit në procesverbal gjatë gjithë seancës gjyqësore	Regjistri i MD, Sistemi AKMIS në gjyqësor, Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i të dhënave nga gjykatat me kompetencë të zgjeruar dhe nga ndërmjetësuesit e licencuar dhe nga MD
Numri dhe lloji i barazimeve gjyqësore të arritura në procedurën e ndërmjetësimit	Regjistri i MD, Sistemi AKMIS në gjyqësor, Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i të dhënave nga gjykatat me kompetencë të zgjeruar dhe nga ndërmjetësuesit e licencuar dhe nga MD
Numri dhe lloji i procedurave të ndërmjetësimit me të cilat nuk është arritur barazimi gjyqësor	Regjistri i MD, Sistemi AKMIS në gjyqësor, Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i të dhënave nga gjykatat me kompetencë të zgjeruar dhe nga ndërmjetësuesit e licencuar dhe nga MD
Numri dhe lloji i ujdive të arritura për ndërmjetësim në procedurë ndërmjetësimi të aprovuara nga gjyqtari	Regjistri i MD, Sistemi AKMIS në gjyqësor, Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i të dhënave nga gjykatat me kompetencë të zgjeruar dhe nga ndërmjetësuesit e licencuar dhe nga MD
Numri dhe lloji i ujdive të arritura për ndërmjetësim në procedurë ndërmjetësimi të pa aprovuara nga gjyqtari	Regjistri i MD, Sistemi AKMIS në gjyqësor, Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i të dhënave nga gjykatat me kompetencë të zgjeruar dhe nga ndërmjetësuesit e licencuar dhe nga MD
Numri dhe lloji i ujdive të arritura në procedurë ndërmjetësimi të pa solemnizuara në noter	Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i informacioneve nga ndërmjetësuesit e licencuar

<b>Indikatorë</b>	<b>Të dhëna</b>	<b>Metoda e grumbullimit të informacioneve</b>
Numri dhe lloji i ujdive të arritura në procedurë ndërmjetësimi të solemnizuara në noter	Regjistri i ndërmjetësuesve	Grumbullimi i informacioneve nga ndërmjetësuesit e licencuar dhe nga Dhoma e Noterisë
Numri dhe lloji i kërkesave të paraqitura deri te përmbaruesi në bazë të ujdisë së ndërmjetësimi	Libra afaristë të përmbaruesve	Grumbullimi i informacioneve nga Dhoma e Përmbaruesve
Numri i sesioneve të realizuara të provimeve në organizim të MD për dhënien e provimit për ndërmjetësues sipas ndryshimeve të LPK	MD	Grumbullimi i informacioneve nga MD
Lloji i profesionit të ndërmjetësuesve të licencuar	Ndërmjetësues të licencuar	Grumbullimi i informacioneve nga ndërmjetësuesit e licencuar
Numri i seminareve të mbajtura për ZAK në organizim të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë	Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë	Grumbullimi i informacioneve nga Akademia
Numri i seminareve të realizuara për ZAK në organizim të OJQ dhe organizatave ndërkombëtare	OJQ/MD/Organizata ndërkombëtare	Grumbullimi i informacioneve përmes telefonit ose me shkresë
Lloji i profesionit të pajtuesve dhe arbitrave të licencuar për konteste të punës	MPPS	Grumbullimi i informacioneve përmes telefonit ose me shkresë
Numri dhe lloji i procedurave të ngritura për kontest individual në përputhje me Ligjin për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës	MPPS	Grumbullimi i informacioneve përmes telefonit ose me shkresë
Numri dhe lloji i procedurave të ngritura për kontest kolektiv në përputhje me Ligjin për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës	MPPS	Grumbullimi i informacioneve përmes telefonit ose me shkresë
Numri i pajtuesve dhe arbitrave të trajnuar për konteste pune	MPPS; Projekt për dialog social	Grumbullimi i informacioneve përmes telefonit ose me shkresë

<b>Indikatorë</b>	<b>Të dhëna</b>	<b>Metoda e grumbullimit të informacioneve</b>
Numri i arbitrave dhe pajtuesve të licencuar për konteste pune	MPPS	Grumbullimi i informacioneve përmes telefonit ose me shkresë
Numri i procedurave të revokuara për zgjidhjen e kontestit individual të punës në procedurë arbitrazhi	MPPS	Grumbullimi i informacioneve përmes telefonit ose me shkresë
Numri i aktvendimeve të miratuara në procedurë për arbitrazh në kontest individual të punës	MPPS	Grumbullimi i informacioneve përmes telefonit ose me shkresë
Numri dhe lloji i procedurave të ngritura para Trupit të Përhershëm Gjykses – Arbitrazhit pranë Dhomës Ekonomike të RM	Dhoma Ekonomike e RM; Lidhja e Dhomave Ekonomike	Grumbullimi i informacioneve përmes telefonit ose me shkresë
Numri dhe lloji i procedurave të ngritura para Trupit të Përhershëm Gjykses – Arbitrazhit pranë Lidhjes së Dhomave	Dhoma Ekonomike e RM	Grumbullimi i informacioneve përmes telefonit ose me shkresë
Numri i aktiviteteve të realizuara të jashtme me subjekte nga fusha e ndërmjetësimit	MD dhe asociacionet, shoqatat	Të dhëna nga burime direkte, ueb portale, komunikime të ndërsjella
Numri i prezencës në Konferenca/seminare/punëtori dhe në forma të ndryshme për iniciativa të shoqërimit dhe bashkimit të ndërmjetësuesve në nivel rajonal	MD dhe asociacionet, shoqatat	Të dhëna nga burime direkte, ueb portale, komunikime të ndërsjella

